



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 2 DHJETOR 2021, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**  
(Seanca filloi në orën 10:00)

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.11.2021 (neni 44, pika 2, i Rregullores)

2. Njoftime (neni 44, pika 3, i Rregullores)

3. Interpelancë me Kryeministrin, zotin Edi Rama, kërkuar nga deputeti Tritan Shehu (neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores së Kuvendit)

4. Akti normativ nr. 32, datë 05.11.2021, "Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga/dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021, të Këshillit

të Ministrave" (neni 78 dhe 101 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

5. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar" (neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

6. Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit” *(nenet 55 dhe 117 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim: absolute)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’)

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

*(Pasi lexon rendin e ditës.)*

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare. Procesverbalin e keni marrë në rrugë elektronike. A ka ndonjë pyetje ose vërejtje?

Miratohet.

Njoftime

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave është depozituar një projektligj dhe një akt normativ me fuqinë e ligjit. Nga Presidenti i Republikës është depozituar dekreti për rishqyrtimin e ligjit “Për bashkëqeverisjen”.

Materialet, si gjithmonë, i gjeni në faqen e Kuvendit, në internet dhe në sistemin *e-Parlament*.

Ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila miratoi me mirëkuptim kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim.

Bazuar në nenin 27, pika 3, të Rregullores, kalendarin i miratuar me mirëkuptim në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve i njoftohet seancës plenare më të parë.

Vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: interpelancë me Kryeministrin, zotin Edi Rama, kërkuar nga deputeti zoti Tritan Shehu, për të dhënë shpjegime lidhur me platformën politike të tij dhe masat e ndërmarra “Për Ballkanin e hapur”. Interpelanca bazohet në nenin 80 të Kushtetutës dhe në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit.

Zoti Shehu, keni të drejtën për të parashtruar interpelancën. Koha në dispozicion është 7 minuta.

Faleminderit!

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar deputetë!

Zoti Kryeministër,

Së pari, ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë interpelancë, që e konsideroj të rëndësishme, sepse ka të bëjë me çështje e strategji që lidhen me marrëdhëniet rajonale, shkëmbimet ekonomike, rolin tonë në to dhe vizionin europian. Si e tillë, përfshin një gamë të gjerë çështjesh thelbësore për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë e të tjera, me interesa edhe të partnerëve tanë, që, përveç të tjerave, janë përfshirë në rajon

në një sërë iniciativash zhvilluese, integruese dhe gjithëpërfshirëse, si: IPA, CEFTA deri te Procesi i Berlinit. Pra, këtu kërkohet një diskutim i gjerë që, realisht, duhej bërë përpara shpalljes së nismës “Minishengen” në Novi Sad, që në të vërtetë tenton kështu t’i sfumojë iniciativat komunitare në rajon, akoma me keq që kërkonte dhe kërkon zëvendësimin e tyre me një iniciativë të tillë me protagonist, drejtues e garant Vuçiqin, iniciativë për të cilën ju u bëtë mbështetës, zoti Kryeministër. Nuk ka mënyrë më të mirë se kjo për të shkatërruar nismat komunitare, të vetmet thelbësore për zhvillimin, bashkëpunimin dhe integrimin europian të rajonit tonë. Aq shumë u involvuar në këtë projekt “vuçiqian”, duke u bërë njësh me të, sa para pak ditësh parlamenti i Serbisë jua shpërbleu me duartrokitje të gjata! Kjo është e kundërta e asaj që mund të ndodhte në Kuvendin e Kosovës, të Malit të Zi, të Bosnjës dhe, së fundi, pas votës ku Zaev mori një përgjigje të qartë, edhe të atij të Maqedonisë së Veriut.

Disa dite më parë zonja ministre e Jashtme, juaja, këtu në Kuvend tha se kjo iniciativë nuk është përgatitur në zyrat e PS-së. Po, jam dakord me të se kjo iniciativë nuk është përgatitur në zyrat e PS-së dhe as në Ministrinë tonë të Jashtme. Ajo nuk u përgatit as në një dialog politik brenda vendit; ajo nuk u diskutua as me vendet e rajonit; ajo nuk u përgatit as në koordinim me partnerët tanë, me Brukselin, Uashingtonin, as me ato vende të rëndësishme dhe aktive për rajonin dhe ne vetë, si: Gjermania, Italia, Greqia, Franca, Austria e të tjera. Mund të jetë përgatitur së bashku me disa qarqe okulte, me interesa shumë të dyshimta. Në fakt, ajo u ideua nga zyrat e Vuçiqit, e bazuar mbi reminishencat, ëndrrat e Serbisë për “Jugosllavinë e re”, pas shpërbërjes së asaj të vjetër. Pra, u ndërtua mbi një bazë politike, nacionalizmi, për interesa ekonomike dhe dominimi. Ajo u ndërtua në përputhje me vizionin gjeopolitik të Serbisë, si firmëtare e Unionit Euroazian të Rusisë, diametralisht i kundërt ky me BE-në. Në fakt, kjo është montuar si një ngrehinë e përbashkët me një tjetër ide serbe, e cila ka jetuar që përpara pavarësisë së Kosovës, për një rindarje të saj brenda Jugosllavisë atëherë, apo përmes krijimit të Serbisë së madhe me anë të “shkëmbimit” të territoreve Kosovë-Serbi pas pavarësisë. Pra,

këtu kemi një mbivendosje të të dyja projekteve. Me atë të krijimit të Serbisë së madhe në një Jugosllavi të re, u tentua të zbehet sovraniteti i Kosovës, “mbeturinat” e së cilës edhe mund të bashkoheshin me Shqipërinë. Ju, zoti Kryeministër, u bëtë mbështetës i saj. Në fakt, gishti juaj ishte që në projektin e parë, të shkëmbimit të territoreve, por, si pasojë e ndërhyrjes së partnerëve tanë të BE-së, më tej edhe të vetë Uashingtonit, u hodh poshtë. Koha i dha asaj ngjyrat që kishte, të një aventure të rrezikshme, jo vetëm për Prishtinën, por edhe për stabilitetin e rajonit, si pasojë e hapjes së “kutisë” së ribërjes së kufijve me “tretjen” e Kosovës.

Sot lexohet qartë se ajo iniciativë serbe ishte një prelud i asaj çfarë po rrezikon të ndodhë në Bosnje, i problemeve të krijuara artificialisht nën petkun fetar në Malin e Zi apo çfarë ndodhi në kufirin Kosovë-Serbi, ku u dislokuan armatimet ruse. Në fakt, kjo është edhe më gjerë, ka të bëjë me situatën sot në Europë, në Ukrainë dhe në vende të tjera.

Pra, kështu, zoti Kryeministër, ju u përfshitë në një projekt të rrezikshëm, por edhe të dështuar që ditën e nisjes së tij në Novi Sad, në praninë tuaj, sepse ai projekt jo vetëm ishte përjashtues ndaj shumë vendeve, antieuropian, por, në radhë të parë, bazohej në mekanizmin e funksionimit të tij nën kontrollin serb, me një Kosovë të pabarabartë, me pavarësi të “thyer”, për më tepër që kurrë nuk i erdhi një ftesë zyrtare dhe një platformë si shtet sovran.

Ky projekt kështu nuk mund të kishte dhe nuk mund as të marrë miratimin e Kosovës dhe të vendeve të tjera në rajon. Pra, çfarë është?! Unë gjykoj se një cilësim të mirë për këtë nismë e ka bërë ministri i Jashtëm i Malit të Zi, duke e përcaktuar: “Një nismë të panevojshme, të padobishme dhe jo të duhur”, megjithëse, për mendimin tim, dëmet e saj janë shumë më të mëdha, sepse gjithçka propozon ky “Minishengen” është krejt e arritshme nëpërmjet institucioneve dhe nismave ekzistuese, si “Tregu i përbashkët rajonal”, që vjen nga Procesi i Berlinit, të cilit ai i kundërvihet. “Ballkani i hapur” shpenzon para vetëm për samite, tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca. TPR-ja jo vetëm që është gjithëpërfshirëse dhe konsensuale brenda saj dhe nën drejtimin e Brukselit, por gëzon edhe përkrahjen politike, si dhe

mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, duke përshpejtuar integrimin europian të rajonit. Ndërsa ajo që ju thatë në Ohër se gjithmonë kishte 1 nga të 6 shtetet që vinte veton, prandaj u krijua “Minishengeni”, është surealizëm edhe për faktin se vetot më së shumti aty i vendoste Serbia kundër Kosovës dhe tani Serbia vendoset në krye. Po kështu, në aspektin e përmbajtjes sociale e benefiteve, TPR-ja është një mekanizëm i avancuar për realizimin e katër lirive europiane. Gjithashtu, ai projekt zhvillimi e integrimi ka edhe përkrahjen amerikane. Prandaj pyetja pse hyn në punë “Minishengeni” përballë TPR-së i lidhur me Procesin e Berlinit, kërkon një përgjigje më të gjerë se sa “Vetëm promovimin propagandistik të autorëve dhe mbështetësve të tij”. Ajo lë shumë pika të errëta për stabilitetin rajonal, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e barabartë të vendeve tona, integrimin, të pamundura këto jashtë nismave komunitare, pa drejtimin, financimin e garancinë e Brukselit. Prandaj, kjo nismë nuk mund të kishte fund tjetër, përveç se asaj që ka, dështimin e saj, ashtu siç u pa edhe nga rezultati i zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut, nga takimi në Novi Sad, si dhe nga braktisja së fundi që i bëri edhe Vuçiq konferencës suaj, duke ju lënë në vetmi. Ai, si pjesë e Unionit Eurozian, preferoi Moskën dhe Putinin, nga u kthye me garanci kundër interesave të Kosovës e rajonit, si dhe me premtime të mëdha ushtarake dhe në inteligjencë. Kjo është e vërteta që ne duhet të kemi parasysh për këtë nismë që bie ndesh në mënyrë thelbësore me interesat tona, me perspektivën tonë europiane.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për Kryeministrin.

**Edi Rama** - Zoti Shehu, edhe unë ju falënderoj për këtë mundësi, sepse, besoj që nuk është asnjëherë e tepërt të diskutojmë për temat e interesit të përbashkët publik apo kombëtar dhe, mbi të gjitha, bashkërisht kemi detyrën, të gjitha forcat politike, të bëjmë më shumë për të dëgjuar njëri-tjetrin.

“Ballkani i hapur” nuk është as zëvendësim, as tjetërsim, as transformim në diçka tjetër të Procesit të Berlinit apo i vetë procesit të integritimit europian të Shqipërisë. “Ballkani i hapur” është një mekanizëm për të jetësuar Procesin e Berlinit dhe për të përshpejtuar procesin e integritimit, ku adresohet,

në mënyrë praktike, domosdoshmëria që piketat e mbetura në letër të Procesit të Berlinit të transformohen në kilometra të bëra bashkërisht drejt realizimit të vizionit të këtij procesi. Po ashtu adresohen edhe nevojat e drejtpërdrejta të qytetarëve, të prodhuesve, të përpunuesve apo të tregtuesve të këtij vendi.

A e dini ju, zoti Shehu, apo cilido qoftë që merr pjesë në këtë debat, se sa janë kompanitë eksportuese shqiptare në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi? Konkretisht, Shqipëria ka 371 eksportues në Maqedoninë e Veriut dhe 165 eksportues në Serbi. Duke qenë se thelbi i këtij debati është Serbia, po ju jap dhe një të dhënë tjetër, që mbase ndihmon në shtjellimin e idesë dhe ilustron nevojën e këtij mekanizmi. Nga 165 eksportues shqiptarë në Serbi, 57 prej tyre janë eksportues frutash dhe perimesh, të cilët aktualisht dhe prej vitesh janë në aktivitet, pavarësisht se çfarë diskutojmë ne apo pavarësisht se cila është panorama politike mbi të cilën shpesh ngrihen në mënyrë të nxituar, por jo rrallë dhe të gabuar, hipotezat për të kundërshtuar zgjerimin e bashkëpunimit rajonal.

Ideja dhe vizioni i Procesit të Berlinit besoj janë të qarta për të gjithë. Ndërsa për sa i takon mekanizmit të Ballkanit të Hapur, unë dua t’ju informoj se ne, Shqipëria, jemi të parët që kemi nisur me marrëveshjet kuadër për të jetësuar Procesin e Berlinit. Faktikisht, në kuadër të atij procesi ne kemi dy marrëveshje të nënshkruara më parë me Kosovën dhe me Malin e Zi për *one stop shop* apo njëndalimet në kufijtë tanë, por edhe me Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë, ne jemi gati, siç parashikohet në marrëveshjen dypalëshe të nënshkruar në kuadër të samitit rajonal në Tiranë.

Është fakt që ne jetojmë në një gjeografi, që nuk e kemi zgjedhur, dhe në këtë hapësirë gjeografike ku jetojmë, jemi në kushtet kur duhet të bëjmë çmos të stimulojmë prodhimin, të stimulojmë eksportet, të stimulojmë ndërveprimet. Ndërkohë, këta stimuj kanë të bëjnë me një treg të fragmentarizuar, që ka bërë që për shumë vjet vendet të qëndrojnë të mbyllura në hapësira, të cilat nuk e stimulojnë në tërësi rritjen e prodhimit, rritjen e eksporteve, rritjen e investimeve direkte, siç e stimulon hapësira e përbashkët e ndërveprimeve.

Faktikisht, sipas të dhënave të komunitetit të transportit dhe të RCC-së, kamionët e eksport-

importit shpenzojnë 28 milionë orë në kufijtë e këtij rajoni për shkak të atyre pengesave të shumëfishta administrative, burokratike dhe në mungesë të një kuadri të përbashkët rregulator midis këtyre vendeve.

Çfarë është ky kuadër i përbashkët rregulator mes këtyre vendeve, mungesa e të cilit, sipas institucioneve ndërkombëtare, vetëm në orët e pritjes u kushton vendeve 1% të prodhimit të përgjithshëm kombëtar? Ky kuadër i përbashkët rregulator nuk është as më shumë e as më pak sesa kuadri i përbashkët rregulator i Bashkimit Europian, një kuadër i ndërtuar mbi 4 liritë e Bashkimit Europian; liria e lëvizjes së njerëzve, liria e lëvizjes së mallrave, liria e lëvizjes së kapitaleve dhe liria e lëvizjes së shërbimeve. Pra, kuadri rregulator është neutral ndaj të gjitha arsyeve të mosarsyes politike të një vendi apo një vendi tjetër.

Po ju jap një shembull, meqë ju cituat ministrin e jashtëm të Malit të Zi. Për të kaluar tranzit në Malin e Zi, sipas të dhënave të kompanive tona, vetëm kostoja për kontrollin veterinar është 80 euro, flas në kosto financiare, plus 20 euro për agjencinë doganore, pra 100 euro për çdo kalim. Nuk flas për koston e kohës së pritjes. Duke thënë këto, dua të shtoj se mekanizmi i Ballkanit të Hapur dhe të gjitha këto marrëveshje që ne po bëjmë dhe i kemi futur në rrugën e zbatimit, disa prej të cilave do të firmosen pak javë më vonë, para festave, këtu në Tiranë, do bëjnë që lehtësia, që do t'u krijohet të gjitha kompanive që përmenda, që shkojnë rreth 500 kompani shqiptare, të jetë eksponenciale në raport me vështirësitë që kanë sot.

Unë do t'ju sugjeroja t'i kontaktoni e t'i pyesni këto subjekte shqiptare, të cilat prodhojnë në territoret e vendit tonë dhe, siç thashë, 57 prej tyre janë subjekte eksporti të frutave dhe të perimeve, një mall shumë vulnerabël në raport me kohën e transportit.

Tani ju pyesni pse unë mendoj se një nismë e tillë e iniciuar nga Vuçiq mund të jetë e dobishme në procesin tonë të bashkëpunimit rajonal, me kryefjalë integrimin europian?

Së pari, e kam thënë edhe më parë e mbase mund t'u referoheni arkivave, kjo është një çështje e ngritur qysh në vitin 2015, në mos gabohem, në Samitin e Procesit të Berlinit në Paris, ku unë së bashku me Presidentin e Serbisë, pavarësisht nga njëri-tjetri, kemi ngritur çështjen

e rrezikut me të cilin përballëj Procesi i Berlinit, që ishte mbetja në letër e të gjitha dokumenteve të miratuara bashkërisht nga samiti në samit. E ashtu ndodhi faktikisht.

Ndërkohë, unë do t'ju citoja një pjesë të raportit të fundit të Komisionit Europian për Shqipërinë, te kriteri politik, ku flitet për raportin mes Shqipërisë dhe vendeve fqinje e ku shkruhet qartësisht se, për sa u përket angazhimeve në kuadër të tregut të përbashkët rajonal, të cilit ju apo kundërshtarët e Ballkanit të Hapur i referoheni, Shqipëria ka luajtur një rol proaktiv në proces e po ashtu, mund t'ju them se Shqipëria është një ndër vendet e gjashtëshes, që i ka respektuar dhe i ka çuar përpara të gjitha marrëveshjet e mbetura pezull të tregut të përbashkët rajonal.

Pse mbesin pezull marrëveshjet e tregut të përbashkët rajonal? Kjo është një pyetje së cilës Ballkani i Hapur i jep një përgjigje konkrete, sepse është e pamundur, zoti Shehu, që punët tona, punët e shteteve tona për interesat tona, në këtë rajon tonin, të na i bëjnë me rekomandë të tjerët që i kemi aleatë, i kemi partnerë, i kemi miq të çmuar, por që kanë shumë punë të tjera në vendet e tyre e nuk mund të merren me menaxhimin e vendeve tona apo të rajonit tonë. Ajo që ndodh faktikisht është se po të shihni kalendarin e samiteve të Procesit të Berlinit, nuk e di sa janë bërë deri më tani, se kam humbur dhe numërimin, se u bë një kohë e gjatë që nga viti 2014, nga një samit në tjetrin, çfarë kemi? Kemi boshllëk, sepse çfarë diskutohet në samit dhe çfarë firmoset në parim, mbetet pa u jetësuar.

I njëjti raport, meqë ju i referoheni CEFTA-s, nënvizon se në vitin 2019 Shqipëria mbajti me sukses kryesinë e CEFTA-s, në fund të të cilit u miratua mes të tjerave edhe protokollin shtesë, Protokollin 6, i marrëveshjes, që synon lehtësimin e lëvizjes së lirë të shërbimeve në hapësirën e CEFTA-s. Po ashtu, ishte pikërisht nën Presidencën e Shqipërisë që mes palëve u dakordësua dhe procedura e validimit për njohjen e ndërsjelltë të operatorëve të autorizuar ekonomikë. Ndërkohë që Shqipëria vetë e ratifikoi Protokollin 6, që në prill të 2020-s dhe sot e kësaj dite, dy vite nga nënshkrimi i protokollit, Protokollin 6 nuk është ratifikuar në shumë parlamente të Ballkanit Perëndimor.

Atëherë çfarë duhet të bëjë Shqipëria dhe cila është përgjigja që ne duhet t'u japim qoftë halleve të atyre që ndërveprojnë në këtë rajon si subjekte shqiptare, qoftë edhe nevojës së tyre, por edhe nevojës së vendit, për të rritur kapacitetet, për të zgjeruar tregjet, për të zgjeruar hapësirën, ku prodhuesit, përpunuesit, tregtuesit tanë, të mund të ndërveprojnë e, natyrisht, të rrisin të ardhurat e tyre, duke rritur për pasojë ekonominë tonë kombëtare, punësimin e kështu me radhë?

Ju flisni për marrjen e rolit lider nga Serbia, e cila akoma nuk ka kërkuar ndjesë për krimet e pak viteve më parë, si dhe vendosjen e hegjemonisë serbe si në planin politik, ashtu dhe atë ekonomik, nuk është e qartë cila është pyetja, por, gjithsesi, unë ju them se, jo sipas meje, jo sipas qeverisë së Shqipërisë, por sipas institucioneve ndërkombëtare financiare, bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe krijimi i një tregu të përbashkët rajonal (sepse nuk kemi mendime të ndryshme, as për Procesin e Berlinit, as për tregun e përbashkët rajonal, as për CEFTA-n, e vetmja gjë ku ne dallojmë është "si", jo "çfarë", ku "çfarë" është shumë e qartë), ne duam pikërisht këtë: një treg të përbashkët rajonal, ku të zbatohen katër liritë e Bashkimit Europian. Por bëhen shtatë vjet sot që ne nuk e kemi tregun e përbashkët rajonal dhe ka një "pse" kjo, mbase të tjerë mund të kontribuojnë për të gjetur "pse"-në ose për të gjetur elemente të tjera të "pse"-së, por kryesor është implementimi, pra nuk kemi një proces implementimi të ndjekur në kohë reale nga shtetet, nga qeveritë, nga agjencitë, gjë që Ballkani i Hapur e mundëson, dhe kjo me fakte, jo me fjalë.

Atëherë, nga ky bashkëpunim mund të arrijmë, thonë institucionet financiare ndërkombëtare, në 6,7% rritje të prodhimit të përgjithshëm kombëtar. Pra, si mundet ta privojmë ne veten nga ky potencial, ndërkohë që çfarë jemi duke bërë të gjithë? Jemi duke synuar të gjejmë burime të reja rritjeje ekonomike e të mos bazohemi vetëm te burimet e njohura ekzistuese.

Njëri nga burimet e reja të rritjes ekonomike ose burimi më i rëndësishëm, i pashfrytëzuar, është pikërisht bashkëpunimi rajonal dhe përsëri unë do t'ju ftoja që ju të bëni një dëgjese me komunitetin e biznesit shqiptar,

që është i përfshirë në tregun rajonal sot që flasim, ku ka disa që janë prej shumë vitesh, ka disa që janë më të rinj si aktorë në këtë treg, dhe t'i dëgjoni ata, për interesat e tyre, që janë rrjedhimisht interesat e ekonomisë shqiptare e të vendit tonë.

Ju thoni: a nuk e shikon Kryeministri lidhjen mes kësaj nisme me idetë e disa viteve më parë të Serbisë për Jugosllavinë e Re? Se ku hyn këtu Jugosllavia e Re, unë nuk e gjej dot, kur ju them se këtu bëhet fjalë për një hapësirë që nuk është asgjë tjetër veçse një hapësirë ku ne duam e unë synoj zbatimin e katër lirive të Bashkimit Europian. Nëse qarkullimi i lirë i qytetarëve, i mallrave, i kapitaleve dhe i shërbimeve ishte diçka e siguruar në Jugosllavi, atëherë i bie që Bashkimi Europian na qenka Jugosllavia ndërkohë.

Ky është një krahasim absurd, i panevojshëm, i pakuptimtë, është thjesht një lojë fjalësh për të cenuar pikërisht nismën, që për mua është interes kombëtar, është interes publik, e meqë koha ime po mbaron e nuk dua të abuzoj me të, po shtoj dhe një gjë tjetër dhe në rast se pastaj jo të gjitha pyetjet tuaja morën përgjigje, ju mund të më kërkonit më shumë në ndërhyrjen më pas.

Po ju them këtë, sepse janë disa pyetje që lidhen me gjeopolitikën, jo Rusia, jo Kina, jo dreqi e shejtani. Se si mund të jetë një vizion rus apo kinez vizioni i Procesit të Berlinit, unë nuk e di. Unë di që Ballkani i Hapur është një njësi zbatimi e shteteve të Procesit të Berlinit dhe unë di që ne i kemi ftuar të gjitha vendet të bëhen pjesë, unë di që Kosova humbet një shans edhe për atë çka përbën problemin më të madh që ne kemi me Serbinë si dy shtete, duke munguar në atë tryezë dhe unë di që historia e tregon, pa bërë këtu historinë e shumë konflikteve, se ndërtimi i marrëdhënieve ekonomike dhe nxitja e ndërveprimeve ekonomike është përdorur në histori si një katalizator për të zgjidhur çështje politike.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Shehu. Koha në dispozicion 15 minuta.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Kryeministër,

Ju ndoqa me vëmendje gjatë fjalës suaj. Nuk mund të them që kam ngelur i zhgënjyer, sepse nuk prisja diçka ndryshe.

Pra, me keqardhje ju them se ju thatë pikërisht atë që unë kisha parashikuar: asgjë. Bëtë vetëm demagogji, përmes së cilës u përpoqët të justifikoni të pajustificueshmen.

Zoti Kryeministër, ju me veprimet tuaja, me rolin tuaj në krah të Vuçiçit, po u bëni një dëm të madh vendit, shqiptarëve, rajonit, qoftë në drejtim të bashkëpunimit rajonal, të sigurisë, zhvillimit linear të ekonomisë, qoftë edhe për procesin e integritimit europian.

Duke ju dëgjuar ju, jam i detyruar të shpjegoj më qartë pse ajo çfarë thoni nuk qëndron, gjë që lidhet edhe me origjinën e nismës së “Ballkanit të hapur” apo edhe me pozicionet tuaja ndaj saj.

Ideja dhe nisma për krijimin e Jugosllavisë së re, me Shqipërinë brenda saj, minus Slloveninë dhe Kroacinë, ka lindur që para një dekade. Në Serbi këtë ide e ringjalli presidenti i saj, Vuçiç, kur ai tha se do të punonte për këtë projekt nën modelin e Titos. E gjitha ishte në funksion të promovimit të politikave për rikrijimin e Jugosllavisë.

Pikërisht, gjatë përpjekjeve për ta krijuar Jugosllavinë e re lindi ideja e ndryshimit të kufijve në rajon, ide për të cilën foli më sipër. Beogradit ju ringjallen “orekset” ndaj Kosovës, duke kërkuar shkëmbimin e territoreve midis saj dhe Serbisë.

Prej këtij momenti qeveria dhe presidenti i Serbisë u përqendruan në zgjidhjen e konfliktit me Kosovën sipas konceptit: “Nuk mundet që njëra palë të fitojë gjithçka dhe pala tjetër të humbë çdo gjë.”.

Siç e shpjegova, opsioni i ndarjes së Kosovës ra për shkak të qëndrimit të partnerëve, por edhe të alarmit që dhanë shumë faktorë shqiptarë kundër tij. A ishit ju përkrahës i këtij projekti?! Ju thoni jo. Por për këtë janë shprehur edhe ish-ministri i Jashtëm i Suedisë, Karl Bildit, gazetaret më të mëdha të Britanisë së Madhe, SHBA-së, Francës e Gjermanisë. Këtë fakt e kanë deklaruar studiues të politikave në vete Beograd, si dhe shumë autoritete ndërkombëtare.

Ju sa herë jeni pyetur, kur çështja e kufijve ishte në tavolinë, thoshit se do ta shihni ju, Kosova dhe Shqipëria do të bashkohen. Pa asnjë dyshim prapa kësaj ishte projekti që, pas ndarjes,

me lejen e Beogradit, pjesa e mbetur e Kosovës të bashkohej me Shqipërinë.

Dështimi i politikave të ndryshimit të kufijve nxori në plan të parë, si më të pranueshme e të kamufluar, vetëm idenë e krijimit të Jugosllavisë së re, kësaj radhe në formën e një “Minishengeni ballkanik”, që më pas u quajt “Open Balkan”. “Minishengeni ballkanik” u tha se u konsolidua si ide në shtator 2019 gjatë takimeve në pallatin e OKB-së në Nju Jork midis jush, Aleksandër Vuçiçit dhe Zoran Zaevit. Në tetor menjëherë u organizua takimi i parë në Novi Sad të Vojvodinës e kështu me radhë. Ju, së bashku me presidentin e Serbisë dhe kryeministrin në largim të Maqedonisë së Veriut, u bashkuat në këtë nismë, por nuk u bashkuan Kosova, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina. Kjo do të thotë se “Ballkani i hapur” u paraqit dhe është një iniciativë përçarëse për rajonin. Kjo do të thotë se kjo iniciativë është e njëanshme, e pakonsultuar, e pamiratur edhe nga tri vende të rajonit tonë. Si i tillë, “Open Balkan”, siç tha diplomati amerikan *Gabriel Escobar* para pak ditësh, nuk mund të funksionojë pa pjesëmarrjen e të gjitha vendeve të rajonit.

Përveç këtyre çështjeve, se ka shumë për të renditur, në fakt, ju me veprimet tuaja në mbështetje të projekteve të Vuçiçit, po dëmtoni rëndë integrimin tonë. Ju po ia lini peng integrimin e Shqipërisë Serbisë.

Kjo është qindra herë më keq se ajo që bëtë duke përzier integrimin tonë me problemet e Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë, derisa u detyrua vetë Bullgaria të reagojë e të kërkojë ndarjen e procesit për vendin tonë nga Maqedonia e Veriut. Atë e bëtë për të fshehur të vërtetën e dështimit të hapjes së negociatave prej vitit 2014 nga mosplotësimi i standardeve, sepse procesi i integritimit europian është një proces individual i çdo vendi, jo kolektiv, në bazë të realizimeve të tij. Prandaj ne vetë duhet të punojmë për këtë objektiv, pa e lidhur procesin tonë me askënd dhe aq me pak me Serbinë.

Ndërsa ju, për arsyt që përmenda më lart, por edhe për të vazhduar së fshehuri dështimet tuaja në atë proces, u bëtë pjesë me Vuçiçin në projektin e tij të “Ballkanit të hapur”.

Ju kështu po e fusni integrimin tonë në spiralen e Serbisë. Ju kështu harroni se Serbia është pjesë e Unionit Euroaziatik të Rusisë. Pra, duhet të jeni i qartë se Serbia një këmbë e

gjysmë e ka në Moskë, gjysmën tjetër e ka “*pending*”. Prandaj, sot përsëri vihet në dyshim vullneti juaj për të shtyrë integrimin europian. Kjo është e lidhur edhe me deformimet e thella të qëllimshme të demokracisë në vendin tonë. Autokracitë, si ajo që ju keni ndërtuar këtu, janë të papranueshme për Europën e bashkuar dhe Perëndimin. Strofulla e tyre është në Lindje, në atë hapësirë ku të çon edhe Unioni Euroaziatik, që po e përdor këtë “Ballkan të hapur” si një zinxhir për t’i tërhequr vendet tona drejt Lindjes.

Zoti Kryeministër,

Vërtet mendoni se projektet serbe do të na çojnë neve drejt Brukselit, kur ajo ka fytyrën, interesat, armët, gjithçka nga Rusia? Ju vërtet mendoni se ka hequr dorë nga pretendimet e saj, jo vetëm ndaj Kosovës, ndërkohë që Vuçiq betohet ditë e natë se kurrë nuk do ta njohin atë? Ndërsa ju veçse bëni presion mbi Kosovën, duke e akuzuar atë përse nuk ulet si “sovrane” apo e “barabartë” në atë tryezë të organizuar e garantuar nga Vuçiq! Shumë iluzive kjo, zoti Kryeministër!

Ju fajësoni Kosovën për atë refuzim të drejte që ju bën, duke e anatemuar edhe në krah të Vuçiqit. Nuk ka mënyrë me të mirë për të zhvlerësuar pavarësinë e Kosovës dhe rolin e saj. Prandaj, zoti Kryeministër, ju duartroktoj parlamentin e Serbisë.

Po kështu, ky projekt cenon edhe çështjet e sigurisë rajonale, zoti Kryeministër! Ne, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, jemi anëtarë të NATO-s. Serbia jo vetëm që është pjesë e Unionit Euroaziatik, por është e lidhur me Rusinë nga ana ushtarake dhe ajo e inteligjencës. Ju mund të thoni se kjo është një logjike arkaike. Do të ishte kështu në qoftë se Serbia nuk do të vazhdonte me një politikë arkaike e nacionaliste të bazuar në lidhjet me Moskën dhe këtë Serbia e bën hapur, ka interesat e saj. Por të mos harrojmë se edhe ne kemi tonat, ato të një demokracie perëndimore, për të qenë anëtare e Bashkimit Europian, që janë jetike për ne e për rajonin.

Qeveria dhe presidenti serb, ndërsa propagandojnë “Ballkanin e hapur”, kanë miratuar para pak ditësh dokumentin strategjik të shtetit dhe kanë përcaktuar si shtete “armike” Kosovën, Shqipërinë, Kroacinë dhe Bosnjën. Në dokument thuhet se sot fuqia mbrojtëse e Serbisë është afërsisht 80 për qind e këtyre shteteve, dhe kjo fuqi duhet të shkojë në 110 për qind, me

qëllim që Serbia të jetë e garantuar nga rreziku i katër shteteve të përmendura më lart, pra nga rreziku ynë. Pa dyshim, kjo bëhet e do të bëhet nëpërmjet Rusisë dhe askujt tjetër. Ndërkaq, ju u servirni shqiptarëve “Open Balkan”-in e Vuçiqit si alternativë, aq më shumë si një formë partneriteti strategjik me Serbinë; partneriteti strategjik me Serbinë, e theksoj këtë gjë.

Zoti Kryeministër, kam një pyetje për ju, përpara se të bëheshit pjesë e kësaj nisme, që e vendos Serbinë në krye të asaj tavoline, a keni kërkuar që ai vend të kërkojë falje për gjenocidet në rajon, veçanërisht ato ndaj shqiptarëve? Këtë gjë e kërkojnë institucionet e Kosovës? Për më shumë, janë edhe institucionet ndërkombëtare ato që mbështesin këtë qëndrim, sipas të cilit, pa pranuar atë gjenocid dhe ato gjenocide, vështirë se mund të ndërtohet një e ardhme e sigurt në rajonin tonë.

Po kështu, në vend që të kërkonte duartrokitjet e parlamentit serb për “Jugosllavinë e re”, a keni ndonjë projekt të dobishëm për Kosovën dhe rajonin pas janarit, kur Shqipëria do të ulet në Këshillin e Sigurimit? Në vend që të humbisni kaq energji me atë projekt “vuçiqian”, ku zhvlerësohet Kosova, duhej, për shembull, të paraqisnit një platformë për ta ndihmuar çështjen e Kosovës, sidomos kur Serbia bashkëpunon ngushtë me Rusinë, për të deligjitimuar njohjen e saj. Për shembull, a nuk duhej menduar një plan veprimi për t’i dhënë fund rezolutës 1244 të vitit 1999, tek e cila Serbia e Rusia janë kapur fort, për trajtimin e Kosovës si një protektorat?!

Unë mendoj se për këto e të tjera duhet të impenjohen institucionet tona dhe diplomacia jonë.

Unë, zoti Kryeministër, jam për marrëdhënie shtetërore normale me Serbinë, por që nuk mund të jenë jashtë disa kornizave të lidhura me Kosovën dhe rolin serb në Ballkan nëpër vite. Ju keni përmendur vazhdimisht si kundërarargument marrëdhëniet e Francës me Gjermaninë, të Europës në tërësi. Jam dakord me ju. Por ju bëni sikur harroni faktin se Gjermania i ka pranuar krimet e nazizmit, ndërsa Vuçiqi nuk i ka pranuar kurrë ato të Millosheviçit, ministër i të cilit ai ka qenë. Përkundrazi, ai etiketon si kriminale bombardimet dhe ndërhyrjen e NATO-s. Gjermania ka kërkuar zyrtarisht falje për ato krime, ndërsa Vuçiq asnjëherë. Për më tepër, thotë se nuk do ta njohë kurrë Kosovën. Ndërsa



ju sulmoni Kosovën dhe cilindo që deklaron se duhet të përfshihemi vetëm në ato projekte rajonale, që kanë vulën e Brukselit. Ky projekt nuk e ka vulën e Brukselit, siç thatë ju, zoti Kryeministër, por u kundërvihet projekteve të Brukselit. Unë jam i idesë që të shohim përpara, por pa harruar të kaluarën dhe pa cenuar interesat tona, të cilat bartin aspiratat europiane e perëndimore.

Kontributi për rrugën tonë perëndimore e të drejtat tona realizohen me vepra, jo nga njëra anë duke u kthyer në dishepull të projekteve “vuçiçiane”, e nga ana tjetër duke bërë deklarata pseudopatriotike, që unë do të votoj pro në një referendum për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Ne fakt, të tilla deklarata, siç theksova edhe më lart, ju i keni dhënë edhe vite më parë, kur çështja e “shkëmbimit të territoreve” u hap, dëmtojnë Kosovën, Shqipërinë dhe rajonin. Këto armatosin Vuçiçin për të penguar Kosovën në rrugën e saj të konsolidimit si shtet i pavarur.

Zoti Kryeministër,

Ju thatë se keni përkrahjen ndërkombëtare për këtë projekt të “Ballkanit të hapur”. Në qoftë se e keni fjalën për Putinin apo dikë tjetër në Lindje, kjo qëndron, se mbi rajonin tonë ka faktorë të paneglizhueshëm, që për interesat e tyre kërkojnë të na kthejnë sa më larg perëndimit dhe integritetit. Ne kemi interesat tona jetike për t’u bërë sa më shpejt pjesë e Bashkimit Europian, prandaj rëndësi kanë projektet e Bashkimit Europian. Ndërsa në lidhje me opinionet e rëndësishme të partnerëve perëndimorë, ju i keqinterpretoni ato.

Në këtë kontekst dëshiroj t’ju them se askush nga Brukseli apo vendet e anëtare të BE-së nuk e kanë mbështetur projektin “vuçiçian”. Përkundrazi, kur është artikuluar edhe nga ju, në prezencë të tyre, ata ose e kanë kritikuar direkt, ose nuk e kanë përmendur, por u janë referuar projekteve komunitare si ai i Berlinit. Është e qarte se midis Procesit të Berlinit dhe Minishengenit nuk ka asgjë të përbashkët, siç thoni ju, sepse i dyti është ndërtuar për t’ju kundërvënë të parit.

Edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka sinjale me një konfirmim të drejtë: asnjë projekt rajonal nuk mund të jetë i suksesshëm pa pjesëmarrjen e gjashtë vendeve të rajonit. Pra, qartësisht deduktohet se ky “Ballkan i hapur” për më shumë tani, mbas humbjes së Zajevit, kur

keni mbetur vetëm dy e gjysmë, është një projekt i dështuar. Pra, mos u fshihni mbas partnerëve.

Megjithatë për këtë çështje dëshiroj t’ju jap një këshillë: mos prisni në pasivitet opinionet e partnerëve. Ne duhet t’u argumentojmë atyre opsionet tona e të qëndrojmë fort kur jemi të bindur për dobinë e tyre. Ballkani Perëndimor është rajoni ku jetojmë dhe ku ne duhet të kemi një rol thelbësor. Këtë rol duhet ta luajmë ashtu siç e kemi luajtur që prej vitit 1992, për stabilitetin e rajonit, bashkëpunimin midis nesh, përsheptimin e procesit të integritetit. Ne kemi realizuar marrëveshje të rëndësishme në rajon, me ose pa ombrellën e Brukselit, për lëvizjet, shkëmbimet, informacionet, kulturën dhe teknologjinë. Pra, bota, zoti Kryeministër, nuk fillon me “Ballkanin e hapur”, që e vendos kokëposhtë atë, atë që është bërë dhe atë që duhet bërë.

Zoti Kryeministër, ju e dini dhe e shprehët se politika dhe ekonomia janë të lidhura. Ju folët për benefite ekonomike, u ulët në nivele teknike. Pikërisht, ajo hegjemoni politike serbe, që Serbia synon të vendosë me këtë nismë, ka në vetvete edhe forcimin e hegjemonisë së saj ekonomike, që ju e harruat.

Minishengeni po prezantohet nga Vuçiçi dhe ju, se kaq keni mbetur tashmë, si një zonë e tregtisë së lirë, si një zonë me tarifa zero komunikimi e të tjera detaje që ju i shprehët.

Aktualisht, një drejtim i tillë i intereson Serbisë, e cila ka trashëguar dhe ruajtur një bazë industriale nga ish-Jugosllavia, në një masë më të vogël i intereson Maqedonisë së Veriut, kurse Shqipërisë nuk i intereson. Pa folur këtu për prodhimet bujqësore që në Serbi, siç thatë ju, rezultojnë konkurruese, sepse subvencionohen fortë, kurse te ne subvencioni nuk është as në nivelin e Kosovës. Kështu raporti eksport-import për ne do të arrijë në 1 me 10 në disfavor, gjë që do të ulë prodhimin dhe do të keqësojë gjendjen tonë ekonomike.

Rritja e turizmit, që ju keni përmendur, është e papërfillshme ndaj asaj çfarë thashë dhe mund të arrijë edhe në nivele më të mira pozitive me politika të tjera drejt vendeve të Europës, pjesëve qendrore dhe veriore të saj. Ndërsa tregu i përbashkët rajonal, që ju e përmendët shkarazi, përmes financimeve nga Bashkimi Europian, i jep mundësi Shqipërisë dhe shteteve të tjera të kompensojnë prapambetjen në infrastrukturë.

Fatkeqësisht, qeveria shqiptare dhe ju nuk flisni për tregun e përbashkët rajonal, e keni harruar atë, por as nuk shpjegoni prioritetet e Minishengenit: nuk keni paraqitur asnjë dokument apo platformë për këtë gjë, sepse nuk keni çfarë të paraqisni.

Zoti Kryeministër, realisht koha tregon se ai projekt tashmë është i dështuar. Treshja juaj, e cila ka ngelur dyshe, kërkon ta mbajë akoma në këmbë, por në të vërtetë gjërat nuk po shkojnë siç mendoni ju. Prandaj, unë ju kërkoj sot të bëni një hap të rëndësishëm pozitiv, në fakt, të vetmin që ju ka ngelur në këto kondita: deklaroni përfundimin e kësaj loje me “Ballkanin e hapur” apo Minishengenin, por që në realitet quhet “Jugosllavia e re”. Kështu do të bëni një veprim të dobishëm për vendin, shqiptarët, rajonin në tërësi. Por jo vetëm kaq, do të bëni një veprim të dobishëm edhe për elemente të Europës, edhe për atë që rrezikohet të ndodhë në Ukrainë, edhe për atë që rrezikohet të ndodhë në Bosnjë, ku realisht kemi një situatë të vështirë pikërisht nga ato elemente që filluan në Ballkan me ndryshimin e territoreve.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Kryeministër, keni edhe 3 minuta kohë për t’u shprehur!

**Edi Rama** - Zoti Shehu, ju thatë që më dëgjuat me vëmendje, por edhe fjalinë “Ju dëgjova me vëmendje” e kishit të shkruar, siç kishit të shkruar të gjithë përgjigjen, pavarësisht fjalës sime, që e lexuat me vëmendje nga fillimi deri në fund. Pra, ju nuk më dëgjuat, zoti Shehu, ndërkohë që unë ju dëgjova. Më vjen keq t’ju them që ju flisni me vete dhe flisni për vete, duke bërë, në fakt, po atë që keni bërë si parti, prej shumë vitesh tanimë, duke i marrë shqiptarët për budallenj. Edhe tani që flasim, në partinë tuaj flitet me vete dhe për vete dhe përsëri u thuhet shqiptarëve se flitet për ta. Por kjo është çështja juaj.

Zoti Shehu, askush, as në Bruksel, as në Uashington, as në Berlin, as në Paris dhe as në Hagë nuk është kundër “Ballkanit të hapur”. Është e vërtetë që gjithkush thotë se “Ballkani i hapur” duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrja në të edhe e tre vendeve të tjera është e mirëseardhur. Këtë e kam thënë edhe unë dhe e përsëris edhe unë qysh në ditën e parë. Por, unë nuk hyj në garë as me ju, as me askënd se me kë është Amerika e me kë është Europa,

sepse kjo është një garë si ato ndeshjet e futbollit me top leckë në filmat me fëmijë të realizmit socialist.

Të kujtohet, zoti Shehu, filmi ku ai i thoshte: “Guri, ata do të na rrahin”? E pra, ka shumë rëndësi çfarë mendojnë aleatët tanë, por më shumë rëndësi ka çfarë bëjmë ne të gjithë së bashku për vendin tonë dhe cilat janë interesat e Shqipërisë në këtë proces që quhet “Ballkan i hapur”.

*(Bie gongu)*

Tregu i përbashkët rajonal i mbron këto interesa, i fuqizon këto interesa. “Ballkani i hapur” është një mekanizëm për të realizuar tregun e përbashkët rajonal. Doni ju, zoti Shehu, nuk doni ju, zoti Shehu, dhe duan apo nuk duan ata që mendojnë si ju, zoti Shehu, “Ballkani i hapur” do të vazhdojë, sepse është në interes të Shqipërisë, është në interes të shqiptarëve dhe shqiptarët na e kanë besuar ne, Partisë Socialiste, mbrojtjen e interesave të tyre, jo juve.

Faleminderit shumë!

**Lindita Nikolla** – Zoti Shehu, nëse dëshironi, Rregullorja ju jep edhe 3 minuta kohë. Pastaj mbyllet interpelanca.

**Tritan Shehu** – Zoti Kryeministër, unë ju dëgjova edhe në këtë fjalë përmbyllëse. Ju jeni i vendosur të qëndroni në këtë pozicion të pashpresë. Fatkeqësisht, zoti Kryeministër, për sa kohë të jeni ju Kryeministër i këtij vendi, edhe Shqipëria është e pashpresë, por të jeni i bindur se kohët do të ndryshojnë shpejt.

Sidoqoftë, për ju aktualisht ka vetëm një rrugëdalje, që unë do t’ju kërkoja sinqerisht: dorëheqja juaj. Dorëheqja është një akt civil, i rëndësishëm, pas dështimeve politike dhe ju keni pësuar një dështim të madh politik me “Ballkanin e hapur”.

Unë ju kërkoj të bëni atë që bëri edhe Zaevi pak kohë më parë. Është dinjitoze dhe ia vlen ta bëni. Në shoqëritë demokratike kjo është thelbësore. Duhet t’i pranojmë gjërat.

Sidoqoftë, unë ju bëj thirrje të hiqni dorë nga mbështetja e projekteve të tilla, të cilat realisht shikojnë shumë në lindje.

Zoti Kryeministër, Vuçiçi është zëdhënës i zotërisë së tij. Ju lutem, mos u bëni zëdhënës i zëdhënësit dhe as i ndërvarur nga zotërinjtë autokratë të Lindjes, të cilët për interesat e tyre duan të përsërisin për Shqipërinë fatkeqësitë historike të largimit nga Europa dhe nga

Perëndimi, si gjatë pushtimit otoman, edhe atij komunist. Shqipëria ka vetëm një të ardhme, të ardhmen europiane, të cilën, ju realisht e vini në rrezik në këtë mënyrë, duke rrezikuar edhe tërë rajonin tonë. Kjo është një fatkeqësi, pra në këtë mënyrë krijoni një fatkeqësi historike për Shqipërinë. Nuk është nevoja të fshiheni pas termave ekonomike, pas disa lëvizjeve, sepse baza politike e këtij projekti dedukton edhe bazën ekonomike të tij.

Prandaj dua t'ju them diçka: është e vërtetë që hije të zeza vërtiten sot në rajonin tonë dhe janë ende aktive, por jo vetëm në rajonin tonë, edhe në pjesë të tjera të Europës ka projekte të rrezikshme copëtimesh që janë skutave, prandaj jua thashë edhe më përpara: kujdes me qëndrimet, me pseudonacionalizmin, me pseudoreferendumet, sepse shpeshherë këto mund të jenë veprime me elemente shkatërruese për vendin tonë. Ne duhet të jemi shumë të qartë dhe të vendosur që Shqipëria ka vetëm një të ardhme, atë perëndimore, atë të Bashkimit Europian. Kjo sanksionohet me projekte të Bashkimit Europian, me projekte të Brukselit, jo me projektet që mbajnë vulën e Vuçiqit, jo me projekte që janë hartuar, janë bërë dhe garantohen nga firmëtarët e Unionit Euroaziatik.

Kjo bie ndesh me interesat tona, zoti Kryeministër. Është shumë e thjeshtë, nuk është kaq e komplikuar, pra është linja politike që duhet të mbajmë ne, duke qenë ngushtë të lidhur me Perëndimin. Shikoni pak ç'po ndodh në Ukrainë këto ditë! Shikoni pak ç'po ndodh në Europë në tërësi! Shikoni agresionin që po kryhet ndaj Perëndimit! Ne duhet të jemi krejtësisht të rreshtuar me Perëndimin, me partnerët tanë të mëdhenj në mbrojtje të vlerave të tij dhe jo të lidhemi aganxhe me vendet e "Ballkanit të hapur", me euroazinë e Rusisë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Këtu mbyllet interpelanca.

Vijojmë me aktin normativ nr.32, datë 5.11.2021 "Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga/dhe ndërmjet Pfhizer Export B.V., dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave".

Hapim debatin.

Fjala për ministren Manastirliu.

**Ogerta Manastirliu** - E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në kushtet kur e gjithë bota është në alert të shtuar për shkak të variantit të ri të virusit, Omicron, për të cilin dihet shumë pak, por mjaftueshëm sa për të forcuar gatishmërinë në këto muaj të sezonit të dimrit që sapo ka nisur, lipset të jemi të gjithë bashkë, për ta përballuar edhe këtë sfidë të radhës. E teksa janë duke u vlerësuar masat që duhen marrë, si dhe forca goditëse e një vale të re potenciale për shkak të variantit Omicron, sigurisht në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të mos kaluar në kufizime drastike, të gjithë ekspertët kudo në botë flasin në unison kur rekomandojnë të vetmen mbrojtje që ka bota, vaksinën.

E ndërkohë që virusi ndryshon dhe shfaqet në formën e varianteve të ndryshme, në anën tjetër, nuk ka ndryshuar aspak gatishmëria që ne kemi treguar, që në krye të herës. Strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e kanë forcuar më tej vigjilencën, qoftë sa i përket survejancës në territor dhe identifikimit të hershëm, me qëllim këputjen e sa më shumë hallkave të zinxhirit të infektimit nga infeksioni Covid-19. Po kështu, shërbimi nga mjeku i familjes deri te strukturat spitalore është fuqizuar dhe është gati të përballojë skenarët, të cilët i kemi përlogaritur për situatën e dimrit.

Kudo në botë zien debati mes komunitetit shkencor, i cili mbështet vaksinën jetëshpëtuese dhe një mase njerëzish të keqinformuar, të manipuluar prej vërshimit të lajmeve të rreme. Siç ndodh gjithmonë, sidomos kur bëhet fjalë për shkencën, të vërtetat i gjejmë te shifrat. Një shifër na thotë se 94% e pacientëve të shtruar në spitalin infektiv janë të pavaksinuar. Një tjetër shifër e bërë publike nga Qendra e Kontrollit të Sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vlerëson se vaksinimi ul me 84% rrezikun e shtrimit në spital.

Unë e kuptoj shumë mirë ndikimin që ka mbi qytetarët faktori lodhje, lodhja nga pandemia. Ka më shumë se një vit, që ekspertët më të mirë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë paralajmërojnë për ndikimin e kësaj

lodhjeje te njerëzit në përgjithësi. Mund të jetë kjo arsyeja pse sot nuk është temë e pëlqyer të flasësh për pandeminë dhe të rekomandosh vaksinën, por detyra jonë është të mbrojmë jetën e qytetarëve, dhe për të mbrojtur shëndetin publik duhet të dëgjojmë vetëm shkencën. Shkenca na kërkon të ngrihemi në lartësinë e misionit që na imponon kjo kohë dhe të luftojmë pandeminë me një armë efikase, si vakcina.

Në Shqipëri mbulesa vakcinale është 47% me të paktën një dozë për popullatën me target mbi 16-vjeç. U referohem këtu shifra për grupin që kemi synim të vaksinojmë, sepse, dua, gjithashtu, të jap edhe një informacion tjetër, që është po kaq i rëndësishëm: nga sot, çdo qytetar +18 vjeç mund të bëjë dozën e tretë të vaksinës, nëse kanë kaluar 6 muaj nga aplikimi i dozës së dytë.

25 bashki e kanë mbulesën vakcinale mbi 50%, duke filluar nga Bashkia e Tiranës, e cila po tregon një ritëm të mirë vaksinimi gjatë kohëve të fundit, po ashtu Fieri, Lushnja, Gjirokastra, Puka, Tropoja dhe Mirdita. Por mbetet ende shumë për t'u bërë, ndaj po vijojmë me vaksinimin derë më derë, për të gjithë ata qytetarë, që jetojnë në zonat e thella të vendit dhe ende nuk janë vaksinuar.

Eksperienca që vjen nga shtete të ndryshme europiane, ku po flitet gjithnjë e më shumë për masa shtrënguese, tregon se nevojitet që një shumicë dërrmuese e qytetarëve të vaksinohen kundër pandemisë për t'iu rikthyer normalitetit, sidomos me variantet e reja, të cilat tashmë janë në shumë vende të botës. Sepse, sipas ekspertëve, nëse një pjesë domethënëse e qytetarëve zgjedhin të mos vaksinohen, nën pretendimin e respektimit të lirive personale, ata nuk janë duke vënë në rrezik vetëm veten e tyre.

E para, po dëmtojnë qytetarët e tjerë, duke u vënë atyre në rrezik shëndetin dhe vetë jetën e tyre.

E dyta, ekspertët thonë se sa më gjatë qytetarët do të zgjedhin të refuzojnë vaksinimin, aq më shumë kohë dhe shanse i jepet virusit të qarkullojë dhe të pësojë mutacione, duke e shtuar kështu rrezikshmërinë e tij.

Kur po bëhen gati 2 vjet nga fillimi i kësaj pandemie, është më se e qartë se argumenti "Vaksinimi nuk është puna ime" nuk vlen. "Vaksinimi nuk është puna ime", vaksinimi është edhe puna jote, edhe puna e prindit, edhe

puna e fqinjit në lagje, edhe puna e shokut, edhe puna e kolegut në zyrë. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi shumë më tepër për të bërë përballë skepticizmit dhe infodemisë, dy faktorë që po minojnë përpjekjet e mëdha të sistemeve shëndetësore.

Qeveria shqiptare ka garantuar vaksinat dhe ato janë të disponueshme dhe të rezervuara për çdo qytetar, për të gjithë popullatën target. Kanë mbërritur mbi 2 milionë e 660 mijë vakcina, ndërsa kemi siguruar kontratat e reja me Pfizer-in për vitin 2022. Po kështu, nëpërmjet instrumentit COVAX, kemi siguruar sasi të tjera vakcine, të cilat pritet të mbërrijnë, duke parashikuar kështu edhe skenarët e ndryshëm potencialë në javët dhe muajt që do të vijnë, duke i zbatuar gjithmonë dhe duke i bazuar gjithmonë këto vendime në rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve të Vaksinimit për dozën *booster*, zbritjen e grupmoshës apo të gjitha vendimet, të cilat bazohen në evidenca shkencore të miratuara.

Deri sot qeveria shqiptare ka financuar për blerjen e vaksinave anticovid 36 milionë dollarë. Kemi parashikuar edhe 27 milionë dollarë për vitin e ardhshëm, me qëllim vijimin e programit kombëtar të vaksinimit anticovid.

Marrëveshja që sjellim sot për miratim lehtëson procedurat për vaksinat Pfizer, të cilat dhurohen nga shtete që kanë disponibilitet vakcine dhe kjo marrëveshje ose ndryshimet në marrëveshje ndihmojnë në rritjen e disponibilitetit të vaksinave në një kohë shumë të shpejtë, por kemi nevojë, sot më shumë se kurrë, për mbështetjen dhe për kontributin e çdo qytetari, kemi nevojë që zinxhiri ynë i solidaritetit të jetë më i fortë për të përballuar kohën e vështirë që na pret.

Kjo luftë fitohet vetëm nëse qytetarët dhe autoritetet janë së bashku në të gjithë këtë betejë të përditshme kundër infeksionit të rrezikshëm SARS-COV2.

Dua ta shfrytëzoj sërish sot këtë moment për t'iu drejtuar qytetarëve: nuk ka kohë për të humbur në këtë betejë për jetën. Është e kuptueshme që të gjithë duan të festojnë, të gjithë duan t'u gëzohen festave, por për ta bërë këtë dhe, pa dyshim, për të vijuar në këtë normalitet të ri, kemi një armë të cilën duhet ta përdorim pa humbur kohë. Kjo është vakcina

dhe, sigurisht, e shoqëruar me respektimin e masave të shëndetit publik.

Vaksinimi është zgjidhja për të afruar sa më parë fundin e kësaj pandemie dhe për këtë jemi të vendosur të bëjmë gjithçka kemi në dorë për të përmbushur Planin Kombëtar të Vaksinimit në një fazë të re të tij. Sigurisht, koha dhe situata epidemiologjike do të diktojnë edhe masat në vijim, që, pa dyshim, do të rivlerësohen, do të rishikohen, duke u udhëhequr, ashtu sikurse kemi bërë që prej fillimit të kësaj pandemie, nga vetëm një interes, që është shëndeti dhe jeta e qytetarëve tanë.

Sikundër edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka rekomanduar, nuk janë zgjidhje vendimet ekstreme dhe ne në këtë qasje do të jemi shumë të kujdesshëm me vendimet që do të ndërmarim. Siç ka ndodhur deri më sot, do të jenë ekspertët ata që do të kolaudojnë dhe do të rivlerësojnë masat në këtë periudhë të vitit.

Por ajo që dua të theksoj, në mbyllje të kësaj fjale, është se vaksinimi, i kombinuar me masat e thjeshta të shëndetit publik, siç janë: distanca, higjiena dhe pa dyshim vendosja e maskës në ambientet e mbyllura, si dhe në ambientet e jashtme, ku nuk ruhet dot distancimi fizik, janë armët që ne kemi në dorë dhe që duhet t'i përdorim të gjithë për të frenuar përhapjen e pandemisë dhe për t'ia dalë me sa më pak humbje dhe risqe nga kjo situatë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Pampuri.

Të përgatitet zoti Erion Braçe.

**Orjola Pampuri** – Të nderuar qytetarë,

Sot diskutojmë për *Pfizer*-in, por ndërkohë zyrtarisht jemi në dimër dhe jemi përballë risqeve dhe vështirësive përsëri me pandeminë, me variantet e reja të virusit e të tjera me radhë si këto.

Në fakt, qytetarët sot, përveç virusit, kanë edhe vështirësi të tjera. Përballen me vështirësi në infrastrukturë në zonat periferike, në zonat rurale, përballen me papunësinë. Infrastruktura e shkollave është e rrënuar në zonat periferike, në zonat rurale, por edhe në qendër të Tiranës, edhe në zona urbane dhe, sigurisht, jemi përballë boshatisjes për shkak të emigracionit, boshatisjes së qyteteve, të periferive.

Sigurisht, përballë të gjitha këtyre vështirësive, kemi Covid-in, kemi vështirësitë

me të cilat na përball Covid-i dhe variantet e reja të tij.

Sot jemi përballë një situatë, ku kemi çeduar në ndërgjegjësimin e popullatës dhe këtë e tregon numri i ulët i personave të cilët vaksinohen, të paktën në muajin e fundit. Dhe, sigurisht, ndërkohë, vijoni me mungesë transparence për vaksinimin me dozën e tretë për stafet mjekësore dhe njëkohësisht po vijoni si gjithnjë me hapa shumë të ngadaltë, ndërkohë që koha nuk pret.

Nuk kemi dëgjuar që të paraqiten shifra, se sa mjekë, se sa staf shëndetësor është vaksinuar, se sa staf shëndetësor nga parësori, nga sekondari dhe nga terciari janë vaksinuar.

Një tjetër çështje e rëndësishme është fakti se keni hequr dorë nga vaksinimet. Shumë ekspertë të huaj dalin sot në media dhe artikulojnë se jemi përballë një varianti të ri, jemi përballë një vështirësie, do të marrim masa, nuk do të marrim masa, a varemi nga OBSH-ja? Sigurisht që varemi nga OBSH-ja dhe masat merren duke u bazuar edhe në rregullat e tyre, por ka një fakt tjetër: sa testimë po bëjmë? Atë që ata reflektojnë dhe referojnë është: “Bëni testimë, merrni masa!”, gjë që ju nuk po e bëni. Pra, testimë masive në popullatë për sa i përket variantit të ri të Covid-it nuk po bëhen, sepse nuk po shikojmë të bëhen. Duhet të kuptojmë se sa më shumë të riskohemi nga një virus, aq më vigjilentë duhet të jemi për ta mbajtur situatën në kontroll pikërisht me këto testimë. Rritja e numrit të testeve në një periudhë të tillë është emergjencë dhe jam e bindur se ekspertët e shëndetit publik e dinë mirë këtë, por ju nuk mund t’juja parashtrijnë si nevojë, pasi edhe ata vetë e kuptojnë që ju keni prioritete të tjera, të cilat nuk kanë lidhje me shëndetin dhe me nevojat e qytetarëve. E dini pse?!

Para dy ditësh raporti i fundit i KLSH-së auditori 120 institucione dhe i klasifikoi 50% të institucioneve më të rëndësishme në vend me risk të lartë në zbatimin e ligjit dhe përdorimin e fondeve publike. Lista kryesohet nga ministritë e linjës dhe nga institucionet në varësi të tyre. Lista e institucioneve më me rrezik u kryesua nga Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore “Nënë Tereza”. Pra, Partia Demokratike nuk i ka bërë kot denoncimet për menaxhimin e fondeve, për menaxhimin e pandemisë, për tenderet korruptivë, për koncesionet abuzive, me në krye

*check up-in*, të cilat janë faktuar edhe nga KLSH-ja. Ju pasuroheni, shqiptarët varfërohen; ju ndërtoni me oligarkët, ndërkohë që shqiptarëve iu ngushtohet gjithnjë e më shumë hapësira në vendin e tyre; ju i gënjeni, ata ju përbuzin. Këtë e tregon qartë ikja e të rinjve, e familjeve shqiptare, ku, sipas Eurostatit, rreth 52% e lejeve të qëndrimit në BE në vitin 2020 u dhanë për shqiptarët nën 19 vjeç.

Është për të ardhur keq se si u katandis ky vend, me kaq shumë burime natyrore, me një klimë të mrekullueshme e të favorshme për zhvillimin e shumë sektorëve. Ai ka mbetur në dorë të një grupi njerëzish që gdhihen e ngrysen me plane e projekte se si çdo burim të këtij vendi ta kthejnë në shërbim të interesave të tyre.

Si të mos mjaftonte kjo, del dikush (nuk po e shikoj këtu në sallë) e bëhet nostalgjik për diktatorin! Tani, si mbesë e një gjyshi të internuar, dhe e kam pasur këtë ndjeshmëri ditët e fundit, dhe si përfaqësuese e atyre mijëra familjeve, të cilat përfaqësojnë një shtresë të rëndësishme, më takon ta përmend. E thashë në fjalimin tim të fundit, madje kryetari i grupit tuaj parlamentar më ndërhyri, dhe do ta ritheksoj: kemi 30 vjet që nuk kemi bërë asgjë për këtë shtresë, dhe jo vetëm nuk kemi bërë asgjë, por sot marrin përsipër, nuk e di unë, të bëjnë protagonistin, të kthejnë ish-diktatorin, duke prekur shumë përfaqësues të atyre familjeve. Unë mendoj se ky është fundi. Besoj se ligji i dekriminalizimit hoqi një pjesë të personave të inkriminuar; pati suksesin e tij, por besoj se paketa e dekomunistizimit, që Partia Demokratike ka propozuar dhe do t'i shkojë deri në fund, do të arrijë që këto figura, këta përfaqësues të mos jenë më përfaqësues të qytetarëve; le të zënë një cep e të kujtojnë diktatorin nga mëngjesi deri në darkë, por jo me zë të lartë dhe, me thënë të drejtën, të prekin shpirtin e zemrat e atyre familjeve që janë prekur nga ai regjim.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Braçe.

Të përgatitet zoti Petrit Vasili.

**Erion Braçe** – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, mua më pëlqen optimizmi, sepse, ta trajtosh jetën me optimizëm, është e shëndetshme, por dje, pas gati 2 vjetësh pandemi, dëgjova një autoritet të shëndetësisë të

thoshte me gjysmëzëri se nuk jemi mirë për sa i përket pandemisë. Natyrisht, vendet e tjera në Europë, edhe pse kanë një numër të imunizuarish, që po shkon mbi 60%-65% dhe mbi 70%, një pjesë e tyre edhe mbi 80%, pa diskutim që janë në alert, në alarm, për shkak se duhet të përballen me virusin, tashmë, në forma të tjera. Një pjesë e tyre pa diskutim që e shikojnë pandeminë si rrezikun kryesor për ekonominë kombëtare dhe më pas një spirale të tërë që mund të na rikthejë 1 vit dhe 1 vit e gjysmë pas. Po ne?! Me thënë të drejtën, për të përballuar pandeminë në këtë vend, vetëm dy elemente duhen: masat dhe vaksinimi.

Dua të them disa gjëra për të dyja: së pari, dhe, mbi të gjitha, për situatën ku jemi. Natyrisht, numri i infektimeve herë është i qëndrueshëm dhe herë ka kolpo; dhe ka kolpo, pra shkon në kurbë më të lartë, thjesht e vetëm për shkak të shkeljes së masave, me dëshirë, me vullnet, apo edhe duke bërë sikur nuk shohin.

Përtej infektimeve, dua të referoj vetëm dy shifra. Sot që flasim të sëmurë aktivë të deklaruar me koronavirus kemi 6694, ndërkohë që në dhjetë ditët e fundit kemi 66 humbje jete, në 15 ditët e fundit kemi 104 humbje jete, në 20 ditët e fundit kemi 126 humbje jete, në 25 ditët e fundit kemi 157 humbje jete dhe në harkun e një muaji, nga dita e sotme, kemi humbje jete të 170 personave apo shtetasve të Republikës së Shqipërisë. Pa më të voglin diskutim, çdo humbje jete është e dhimbshme dhe çdo humbje jete duhet të shqetësojë; 170 jetë të humbura në harkun e një muaji duhet të shqetësojnë akoma më shumë; pa diskutim qeverinë të parën, Kuvendin bashkë me të, pa diskutim çdo autoritet tjetër, që duhet të jetë në krye të punëve për të përballuar pandeminë; pa diskutim që çdo qytetari, nga më i riu deri te më i vjetri, të cilit i është dhënë mundësia falas në mënyrën më të qartë që të imunizohet përmes vaksinimit, por, ose e neglizhon atë, ose e refuzon atë.

Unë thashë se dy janë elementet: masat dhe zbatimi i tyre, si dhe në krahun tjetër vaksinimi.

Çfarë mund të them për masat?! Sot, për nevojë të këtij diskutimi, bëra një kontroll në të gjitha uebsajtet e qeverisë për të konsultuar se cilat janë masat e fundit, ato që janë në fuqi, që duhet të zbatohen në respekt të rregullave të vendosura dhe, në fund fare, në respekt të jetës. Ka një kakofoni të të gjitha akteve që ndodhen

*online*, ndodhen në të gjitha uebsajtet zyrtare të qeverisë apo institucioneve të tjera, por ajo që është më e rënda është se masat në këtë vend nuk zbatohen më, duke filluar nga kjo sallë. Këtu jemi në parlamentin e Shqipërisë, institucioni më i lartë këtij vendi, dhe, sipas rregullave që janë në fuqi këtu brenda duhet të mbahet maskë. Me thënë të drejtën, qeparë pashë Kryeministrin dhe disa ministra në sallë, nuk bëhen as 5 deputetë bashkë, që mbajnë maskën për t'u mbrojtur e për të mbrojtur. Po të dalësh nga këtu dhe të shkosh në klubin e parlamentit do të shohësh që jo vetëm s'ka maskë, por dikush mendon se tymi i duhanit që konsumohet atje të mbron nga koronavirusi, dhe ky është një problem akoma më i madh. Kur zbatimi i rregullave dhe zbatimi i masave nuk rrezatohet këtu, në sallën e parlamentit, pa diskutim askush të mos kërkojë që masat të zbatohen në çdo cep të territorit të Republikës së Shqipërisë. Kemi vendosur një rregull këtu: të gjithë duhet të jemi të vaksinuar. Natyrisht, në këtë sallë ka deputetë të pavaksinuar, pak janë, por ka. A ia kërkoj kush sot në mëngjes testin gjithsecilit prej tyre për të hyrë në sallën e Kuvendit?! Natyrisht që jo. Atje matet vetëm temperatura dhe asgjë tjetër. Në qoftë se kjo masë nuk respektohet këtu, ku do të respektohet?!

Kemi masë për orën policore, 23:00-06:00, por nuk zbatohet kurrkund, zero. A e dini kush janë të penalizuarit?! Ata që janë të vaksinuar, të cilët kanë respektuar rregullat e këtij shteti, kanë vënë veten e tyre para çdo gjëje, janë vaksinuar, janë imunizuar dhe kufizohen në lirinë e tyre për të ushtruar të gjitha aktivitetet e tjera për shkak se virusi po qarkullon masivisht tek të pavaksinuarit dhe si ata, si të vaksinuarit trajtohen njësoj në këtë sallë apo jashtë kësaj salle.

Kemi vendosur masa për grumbullimet. Me thënë të drejtën, sot kërkova në Qendrën e Publikimeve Zyrtare për këtë masë dhe, pavarësisht se në ekran shikoja këtë vendim, kur e printoja më dilte ky vendimi tjetër, por ç'rëndësi ka kjo, aty thuhej se grumbullimet nuk lejohen më shumë se 10 veta dhe nuk lejohen as me më shumë se 50 veta. A zbatohet kjo masë?! Jo, nuk zbatohet kurrkund, nuk zbatohet në asnjë ambient të mbyllur, nuk zbatohet në autobusë, nuk zbatohet në qendrat tregtare, këtu afër e kemi njërën prej tyre, hajdeni të shkojmë, të

hyjmë atje dhe shohim që nuk zbatohet, askund nuk zbatohet, as në sheshin qendror të Tiranës para dy ditësh, as në panairin tregtar sot dhe nuk zbatohet as nëpër stadione.

Nuk iu referova kot pak më herët numrit të personave që kanë humbur jetën në harkun e këtij muaji. Në debatet televizive të ekspertëve, jo të miat, dëgjova që vdekjet e këtij muaji u dedikohen infektiveve që buruan nga një ndeshje, tek, një ndeshje, në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa". Të gjitha infektimet e ardhura prej asaj ndeshjeje u reflektuan në këtë numër vdekjesh. Rregulli që është në fuqi thotë: vetëm 30%, por atje kishte 26, 27 apo 28 mijë veta të bërë bashkë. Kush i lejoi?! Ne të gjithë bashkë, që nga qeveria dhe deri te më i fundit, që nuk zbaton rregullat në këtë sallë, jashtë kësaj salle, në çfarëdolloj aktiviteti të doni, të Partisë Socialiste, apo të Partisë Demokratike dhe në çdo shoqatë tjetër kudo në këtë vend.

Kalojmë te vaksinimi. Sot që flasim doza të injektuara në total kemi 2 103 351, doza të para 1 072 645, doza të dyta janë 961 013 dhe doza të treta janë 67 381, doza të mbërritura në Shqipëri e të administruara deri tani janë 2 663 100. Pra, tani që flasim, kemi një stok prej gati 550 mijë dozash dhe ndërkohë që virusi qarkullon masivisht te pjesa e pavaksinuar, ne vazhdojmë të kemi stok. Sot do të miratojmë një marrëveshje për të blerë vaksina të tjera, por ç'vlerë ka që ne e bëjmë këtë sakrificë nga paratë e buxhetit të shqiptarëve, nga paratë e taksave të tyre, për të blerë vaksina, kur në krahun tjetër nuk po vaksinohet në ato shifra që duhet dhe në ato shifra që bëjnë të mundur ndalimin e përhapjes së virusit mes të pavaksinuarve? Na duhet rienergizim total i gjithë procesit të vaksinimit dhe pa diskutim po humbasim kohë. Duhet të kushtëzojmë të gjithë aktivitetet me vaksinimin! Këtu po shkon e gjithë Europa dhe unë habitem pse ne vijmë dhe sorollatemi! Nga njëra anë blejmë vaksina dhe bëjmë thirrje për vaksinim dhe nga krahu tjetër nuk na përgjigjen njerëzit për të shkuar e për t'u vaksinuar, ndërkohë që virusi vazhdon të qarkullojë tek të pavaksinuarit. Vaksinimi duhet të jetë me detyrim për çdo lloj aktiviteti. Nëse do të mbash klubin apo restorantin hapur, vaksinoni punonjësit! Nëse do të punosh në klubin apo restorantin tënd, pa diskutim, prit vetëm klientët që janë të vaksinuar! Vaksinimi duhet të jetë me

detyrim duke filluar nga kjo sallë, duke vazhduar në çdo zyrë të shtetit, të administratës dhe duke përfunduar tek ata, që janë dhe pjesa dërmuese e atyre që po humbasin jetën sot, të moshuarit mbi 60 vjeç e sipër. Ua kemi borxh atyre, ua kemi borxh t'u shpëtojmë jetën. Na e kanë dhënë jetën, tani duhet t'ua kthejmë pas. Faleminderit!

**Lindita Nikolla**- Fjala për zotin Petrit Vasili.

Përgatitet në emër të grupeve zonja Spahiu dhe më pas zonja Doda.

**Petrit Vasili** - E nderuar Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë!

Sot jemi duke diskutuar një marrëveshje për të mbështetur një proces vaksinimi tashmë të filluar. Pa diskutim, mbështetja për këtë marrëveshje është një darkodësi, të cilën e bashkëndajmë të gjithë dhe është një ngjarje rutinë ndër mijëra ngjarje të tjera, që kemi pasur lidhur me këtë çështje. Problemi i madh është se kemi një pandemi, që ecën në dy shina. Në njërin shinë, për të cilën bërtitet shumë këtu, e mirë bëhet, dhe unë bashkohem me faktin që vaksinimi duhet të vazhdohet të thellohet, por, njerëz, kemi edhe një realitet të përditshëm. Për këtë nuk flet njeri. Sot është mundësia për të ndarë keqardhjen time të thellë, që 1 javë apo 10 ditë më parë, unanimisht maxhoranca rrëzoi amendamentin, që unë paraqita dhe që kishte të bënte me rimbursimin e barnave të të sëmurëve me Covid. Nuk e kam kuptuar dhe nuk e kuptoj dot se cili ishte ky qëndrim kaq monolit, grushtbashkuar rreth qeverisë, përfshirë dhe kolegët mjekë, që ndodhen në Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste, për të mos votuar një shtesë në buxhet për rimbursimin e barnave! Ju pyes sinqerisht, në emër të ndërgjegjes qytetare (edhe ata që janë mjekë profesionistë, nëse janë më të tillë): Si mund të refuzoj një amendament i tillë? Sepse ishte propozuar nga një përfaqësues i opozitës?! Çfarë ishte ky amendament?

Po jua shpjegoj. Janë ato qindra raste që janë përditë, për të cilët nuk flet askush. Ata duan ndihmë. Sigurisht, të gjitha masat të respektohen, por ata janë të sëmurë, ky është realiteti. Në më pak se 35 ditë, janë 18 mijë raste të reja. Kush paguan për ta? I keni llogaritë që shpenzohen çdo muaj, rreth 800 mijë euro, relativisht mbi 1 milion? Janë këto para? I

shpenzon njeri? Ç'bëhet me ta? Trajtohen? Si trajtohen? Raportohet përditë numri i të shëruarve. Por, si u shëruan, kur nuk i ndihmon askush, kur nuk paguan njeri për ta? Të gjithë keni njerëz, keni familjarë, keni të njohur, keni njerëz që bëjnë pjesë në elektoratin që ju ka zgjedhur. Si u thoni? Ne votuam kundër, që ju të mos ndihmoheni nga qeveria, që qeveria të mos japë treçerek kilometër rrugë, se aq ishte. Rrugët janë 23 milionë euro, 24, 26,18 ishin dhe jeni shumë të lumtur për këtë punë e do të dëgjojmë këtu 1 mijë fjalë propagande. Vaksinimin patjetër që duhet ta mbështesim, por 960 mijë doza janë dyfishe. Ky është fakt dhe ky në raport me popullatën 2 milionë e 800 mijë, është vetëm 38-39%. Këtë nuk e mohojmë dot, këto janë shifrat. Afërsisht 200 mijë është numri i të sëmurëve të diagnostikuar nga qeveria. Por cila është e vërteta? Jua them unë të vërtetën, nëse i doni këto të vërteta, nëse s'doni të gënjeni njerëzit. E vërteta është se nuk testoni, nuk thoni të vërtetën. Çfarë thonë të vërtetat? Më 1 dhjetor, jo më larg nga dje, ka pasur gjithsej 1500 testime dhe 228 raste të reja. Tani po u drejtohem atyre që janë mjekë, nëse nuk e kanë pështyrë zanatin e tyre. Dhe më tutje, 2-3 ditë më pas ishin 2800 testime, dolën 418 raste, pra dyfishi dhe ca ditë më pas janë 3 900 e ca testime dhe 600 e ca raste. Pra, çfarë bëhet? Paturpësisht uljet numri i testimeve 3-4 herë dhe thonë: kemi pak raste. Në realitet janë me qindra. Këto janë të vërteta. Këto janë shifra zyrtare, nuk janë të miat. Çfarë mendimi kam unë, si njeri i një shteti publik, është histori tjetër, nuk e hedh poshtë sallën e parlamentit, por do të flas gjithmonë me shifrat e tyre. Kush i justifikon këto shifra? Kush u del për zot? Kush e mori vendimin e madh që t'i çojë në minimum testimet? Jeni të lumtur për këtë, sepse keni pak raste. Po në lidhje me historinë e numrit të rasteve, ku në një ditë evidentohen 680-700 raste, pastaj të nesërmen evidentohen 130 raste? Pse? Sepse ulen testimet. Çfarë është kjo?! Luajtje propagandistike?! Kjo është e vërteta. A i shmangeni kësaj të vërtete? Janë të njëjtat shifra. Këto shifra nuk mbajnë propagandë. Ky është realitet që nuk lëviz.

Cila ka qenë shkalla e rimbursimit? I keni të raportuara zyrtarisht, e zeza në të bardhë, në Komisionin parlamentar të Shëndetësisë nga përfaqësuesit e qeverisë. Janë dhënë 320-330 mijë dollarë për 8000 e ca raste, kur vetë qeveria



ka 200 e ca mijë raste. Pra, të gjithë ata që duan të jenë korrektë me njerëzit, rastet me COVID, qofshin të lehta, të mesme apo të rënda kanë nevojë për trajtim mjekësor. Janë raste të ndryshme nga njëri-tjetri, por secili rast ka nevojë për trajtim dhe ky trajtim kushton. Kur nuk i paguan shteti, kush i paguan?! Apo nuk ka problem, se shqiptarët janë solidarë me njëri-tjetrin dhe i gjenden njëri-tjetrit në vështirësi! Po kjo “shejtan” qeveri, kjo “dreq” qeveri, kur do t’u gjendet njerëzve?

Po thuhet se pandemia ndodh një herë në 200 vjet. Po bërtasin e po thërrasin për vaksinimin; shumë mirë, le të vaksinohemi. Po me këtë shinën tjetër, të përditshme, kush do të merret? Kush e vë dorën në zemër për këta? Po për taksat që këta kanë paguar, se këta i kanë paguar taksat (këtë që themi ne paguani, nuk i paguajnë nga xhepi këta, por janë nga buxheti që kanë paguar qytetarët)? A nuk marrkan gjë mbrapsht nga taksat këta? Kush e vë dorën në zemër për ta? Apo taksat e tyre bëhen rrugë, që kushtojnë 24 milionë euro?! Kur vjen puna për 18 milionë euro, të gjithë bashkë votoni kundër dhe pastaj rrihi gjoksin dhe thoni: “Ja çfarë i kemi bërë pandemisë. E kemi menaxhuar mirë pandeminë, e kemi qarë!”. Po, e keni lënë në dorë të Zotit. Ja ku i keni, nga 200 mijë të sëmurë, po flas me shifrat tuaja, maksimumi 8500 (500 i keni peshqesh nga unë se po ia shtoj shifrës), janë mbështetur financiarisht, pra u janë rimbursuar.

Çfarë bëhet në çdo familje? Çdo familje që merr lajmin se është e infektuar dy halle ka: ka hallin shëndetësor, që ua nxjerr gjumin, sepse ka edhe zhvillime të papritura, e ka provuar që është një sëmundje me të papritura të mëdha, por ka edhe hallin shumë të madh atë ekonomik. Këto familje vendosin kokën në jastëk duke menduar se ku do t’i gjejnë ato para. Mjekimi kushton, plotësuesit mjekësor kushtojnë, shërbimet mjekësore në banesë kushtojnë, pra të gjitha kushtojnë. Po këta çfarë bëjnë? Këta mbajnë gjallë një treg të zi, që i plaçkit qytetarët në mënyrë të përditshme, të cilët nuk i ndihmon njeri. Edhe për këtë do të vazhdojmë të flasim ne?! Ky është sukcesi i menaxhimit të pandemisë?!

Kjo nuk është për kritikë. Ne ju themi: jepuni një ndihmë konkrete, por ju nuk e jepni.

Për të votuar ato koncesionet varg e varg në buxhet ju e ngritët dorën që të gjithë, ndërsa për të dhënë lekë për rimbursimin e barnave për të sëmurët, të cilët shkoni t’i takoni si elektorat... Si do t’u thoni atyre të sëmurëve: kur kishim për të votuar një amendament që duhej rimbursuar ilaçet, ne votuam kundër, se e kishte propozuar një deputet i opozitës, se ne duam të kënaqim Kryeministrin dhe nuk duam t’ia prishim qejfin?! Nga buxheti ikin qindra milionë, por ai 18-milionëshi ishte shumë i dhimbshëm, nuk mund ta votonit, i bëtë bllok të gjithë dhe votuan kundër. Kjo është e vërteta. Këtë ndihmë duan ata, nuk kanë nevojë për llafe të bukura. Propagandën nuk e ha njeri, as ata që e kanë humbur jetën nuk e hanë këtë, por as ata, që janë me mijëra, të cilët po vuajnë nga komplikacione shumë të rënda pas COVID-it. Ky është një problem i madh në të gjithë botën. Në dorë të Zotit që të gjithë.

Po çfarë është në fund fare? Në fund duartrokasit, mbajnë fjalime të mëdha dhe thonë: kemi bërë këtë, shyqyr që ishim ne, se po të mos ishim ne kush e di se çfarë do të ndodhte me pandeminë. Ja, ajo që ndodhi: nuk i financon njeri dhe nuk tregojnë të vërtetën. E thashë, këto shifra janë shumë të turpshme. Ulin testimet me 3-4 herë që të ulen shifrat, ky është një turp dhe faj publik. Këtu nuk ka drejtësi, sepse, po të kishte drejtësi do të ndodhte si me kryeministrat e Europës, të cilët kanë vajtur nën hetim, edhe pse nuk kanë pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë, jo më ata që kanë pasur përgjegjësi, operatorët e sistemin.

Përballë këtyre të pavërtetave të mëdha ju nuk keni dëshirë të reflektoni. Votën e keni për të blerë vaksinën, por qindra njerëz bërtasin e ulërasin përditë me shumë të drejtë, sepse janë në mëshirë të fatit. Ky është momenti për të reflektuar, të paktën një herë të vetme. Kjo ndihmë dhe kjo mbështetje shumë e madhe financiare ose jepet sot, ose nuk jepet kurrë, sepse atyre njerëzve nuk u jepet asgjë për rimbursimin, ndërsa mjekëve u rritet paga me demek me 6%. Pra, mjekët dhe të sëmurët nuk kanë nevojë as për violinë dhe as për koncerte në oborret e spitaleve, por kanë nevojë për ndihmë konkrete.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Në emër të grupit fjalën e ka zonja Spahiu.

**Klodiana Spahiu** – Përshëndetje, të nderuar qytetarë,

Ky akt normativ, që po diskutojmë sot, është një amendim që lehtëson procedurën e alokimit të dozave Pfizer, të dhuruara nga shtetet e tjera, pasi tashmë nuk do të jetë e nevojshme të ndryshohet marrëveshja bazë, por Pfizer-i do të njoftohet për të gjitha këto dozat që do të ndryshohen. Në fakt, Shqipëria ka një plan kombëtar të vaksinimit anti-COVID, i cili është një dokument i miratuar dhe parashikon çdo hap konkret për vaksinimin e popullatës dhe ndërhyrjet për të siguruar kapacitetet e nevojshme në administrimin e vaksinave në Shqipëri. Tashmë është bërë rutinë, që sa herë diskutojmë një akt normativ, fatmirësisht kanë qenë të shumtë në numër për të përballuar situatën, do të dëgjojmë fjalime, ku shpeshherë do të përfshihet edhe ironia, edhe sarkazma, edhe negativiteti, por ndoshta edhe mënyra për të frenuar këtë proces kaq të rëndësishëm për qytetarët shqiptarë. Unë do të thosha se nuk ka gjë më të rëndësishme që të gjithë bashkë të ishim në një mendje, se ky proces në të cilin ne kemi hyrë, procesi i vaksinimit, nuk mund të përballet dot vetëm, nuk mund ta përballojë dot vetëm as maxhoranca, as qeveria. Por, tek dëgjoj kolegët, më duket e pamundur fryma e bashkëpunimit, sepse nëse ka pasur një bashkëbisedim, ose një trajtim të të gjitha çështjeve në komisionin tonë, ajo ka qenë sa herë ne jemi mbledhur. Nëse ne do të vazhdojmë me të tilla ironi ndaj kolegëve, besoj se absolutisht nuk arrijmë në qëllimin që ne kemi, që të rrisim numrin e vaksinimit. Ka edhe kolegë, që kanë drejtuar institucionin e shëndetësisë dhe e dinë shumë mirë se ç'probleme të mëdha ka Ministria e Shëndetësisë dhe të gjitha hallkat që mbulon kjo ministri.

Ne duhet të jemi realistë dhe të flasim me këmbë në tokë, se në të gjithë Europën dhe Ballkanin askush nuk diskuton se si të rrisë kostot për të përballuar sëmundjen financiarisht, duke shtuar medikamentet apo duke përballuar shpenzimet e spitalit, sepse sot që flasim situata në të gjitha spitalet në Gjermani është në kushte tepër të vështira; sot që flasim situata në të gjitha spitalet në Austri është në kushte tepër të vështira, me kapacitete të ezauruara dhe janë duke çuar pacientë drejt shteteve të tjera. Pra, këtu nuk është fjala për të rritur kostot

maksimale për shpenzime, por është fjala për të diskutuar me njëri-tjetrin, që të rrisim frymën e bashkëpunimit për vaksinimin. Unë dua t'ju jap shifra konkrete, pavarësisht se dëgjuam edhe shifra më parë, ku situata, për hir të së vërtetës, nuk paraqitet pesimiste dhe do t'ju sugjeroja edhe kolegëve, edhe kolegëve mjekë, që të lexojnë buletin e fundit të Institutit të Shëndetit Publik, ku janë edhe të dhënat e sakta mbi numrin e rasteve, të paktën të dy javëve të fundit, në javën e dyzet e shtatë dhe fatmirësisht po ruhet i njëjti ritëm si në javën e dyzet e tetë. Kemi pasur 341 raste në javën e dyzet e gjashtë, më falni, 3410 raste në javën e dyzet e gjashtë dhe kemi 2991 raste në javën e dyzet e shtatë. E superdiskutuar edhe në parlament, edhe në Komision është çështja e numrit të testeve, që është një numër që nuk vendoset as nga Instituti i Shëndetit Publik, as nga drejtoritë, por bëhet në bazë të kërkesave, në bazë të rasteve të reja që shkojnë për të bërë testimin, sipas udhëzimit të mjekut të familjes dhe në bazë të hetimit dhe të gjurmimit. Pra, nuk është një numër që përcaktohet paraprakisht, por është numër që realizohet në bazë të nevojave dhe ne flasim me shifra reale që kemi. Dhe për të diskutuar me shifra reale, me këto dy javët e fundit ne duhet të jemi optimistë. Jam plotësisht dakord me propozimet e kolegut Braçe, që ne duhet të zbatojmë masat, sepse, në fakt, nuk i zbatojmë, duke filluar nga ne të parët. Kemi kolegë në Komisionin e Shëndetësisë, që e kundërshtojnë mbajtjen e maskës dhe ruajtjen e kujdesit dhe të largësisë.

Megjithatë, unë dua të rikthehem në vendimet, që po merren tashmë edhe në shkallë botërore. Pak ditë më parë u mbledh Asambleja Botërore e Shëndetësisë dhe ishte një vendim i saj lidhur me një traktat të përbashkët, për të vendosur përfundimisht një rregull të ligjëruar për vaksinimin. Presidentja e Parlamentit Europian, Ursula von der Leyen theksoi se ka mbërritur momenti, që BE-ja duhet të diskutojë mundësinë e vaksinimit të detyrueshëm për të luftuar valën aktuale të infektiveve dhe variantin e ri Omicron.

Ne kemi insistuar vazhdimisht që duhet të rrisim numrin e të vaksinuarve, sepse ky virus fiton mutacione të reja dhe pikërisht jemi në një mutacion të ri, që ka një shkallë shumë të lartë të transmetimit të sëmundjes. Pa dyshim që nuk

dihet shumë rreth këtij virusi, rreth këtij mutacioni të ri, por ajo që ne dimë dhe jemi të sigurt është që vaksinimi është hallka e vetme dhe pse të mos jemi të gjithë njëzëri për të mbështetur, për të nxitur, për t'u bërë ne ambasadorët e këtij procesi kaq të vështirë, por ne dalim në foltore e fillojmë me koncesionin dhe e mbarojmë me rrugën e pashtuar, duke harruar që problemi kryesor sot që ne flasim, është të respektojmë masat dhe të rrisim shkallën e vaksinimit.

Prandaj, të nderuar kolegë, le të bëhemi bashkë në këtë proces kaq të vështirë, që po gjuhëzon botën, ku nuk jemi vetëm ne dhe këto nuk janë fjalime demagogjike. Ndoshta propozimet për të shtuar buxhetin për të mbështetur qytetarët, për të planifikuar diçka më të mirë për ta janë pa dyshim propozime kurajoze që kërkojnë vëmendjen e të gjithëve, por mos harroni se ai që e ka provuar dhe që ka qenë në pozicionin drejtues të këtij institucioni e kupton shumë mirë se sa shumë hallka duhen bashkuar për të funksionuar siç duhet. Jemi në një situatë ku vërtet ka gjëra të paparashikuara, por ajo që dimë me siguri të plotë është që ne duhet të respektojmë masat. Vërtet jam shtangur dhe kur pashë një skenë, një grumbullim në një qytet të Shqipërisë, dhe thashë më vete: O Zot, a ka ndonjë në atë sallë me aq shumë njerëz që të jetë personel shëndetësor, me aq shumë grumbullime dhe a do të ketë reflektime ose një ndërgjegje qytetare për të kuptuar që në atë sallë me aq shumë grumbullime, pas dy javësh pa dyshim, do të ketë një numër të caktuar viktimash.

Ndaj, të nderuar kolegë, të nderuar qytetarë,

Dua t'ju bëj një thirrje që më vjen nga zemra: nuk ka gjë më të rëndësishme se shëndeti, nuk ka gjë më të rëndësishme se jeta! Për këtë arsye, ju lutem, mendohuni mirë kur tentoni të grumbulloheni, qoftë edhe për arsye madhore të politikës sonë kaq të vështirë, sepse nuk ka politikë më të rëndësishme se shëndeti!

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për deputeten Mesila Doda.

**Mesila Doda** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuara zonja deputete,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Që në fillim duhet të japim një mesazh: kur bëhet fjalë për jetën e shqiptarëve, për jetën e njerëzve, absolutisht të gjitha palët rreshtohen në mbrojtje të saj. Kjo do të thotë se sa herë bëhet fjalë për çështje që kanë lidhje me pandeminë ose vaksinimin e popullatës, të gjithë duhet të jemi të rreshtuar në një front, që është fronti i jetës.

Duke u nisur nga kjo, dua të ndalem te projektligji që na paraqitet sot, si dhe te mënyra si po paraqitet ky projektligj.

Së pari, dua të them se ka shumë pak argumente që të flasim për këtë projektligj. A e dini pse? Sepse ka vetëm dy nene, në të cilët tregohet se do të ketë një ndryshim të kontratës, por ne nuk kemi asnjë ndryshim. Neve nuk na ka ardhur asnjë akt tjetër bashkëlidhur me këtë. Për më tepër, bëhet fjalë për disa ndryshime, të cilat kalojnë në ministrinë përkatëse për dhënie mendimi, por nuk vijnë në parlament. Nuk e kuptoj pse parlamenti është një organ, tek i cili ka më pak besim se te nëpunësit e ministrive përkatëse? Kjo do të thotë se nëpunësi i Ministrisë së Drejtësisë e ka për detyrë të mos i shpërndajë, por duhet t'i shikojë këto akte, ndërsa Komisioni i Shëndetësisë nuk ka mundësi t'i ketë këto akte, nuk ka mundësi të shikojë se për çfarë ndryshimesh bëhet fjalë në atë marrëveshje.

Unë nuk e di se për çfarë ndryshimesh bëhet fjalë: mund të jenë çmime, mund të jenë edhe sasi, mund të jenë edhe formula, mund të jenë edhe përshtatje, ashtu si komisionerja europiane Ursula von der Leyen kërkoi për ta përshtatur për variantin e ri "Omicron", por ne nuk dimë asgjë nga këto. Pikërisht, për të ditur pak më shumë për çështjen e pandemisë, strategjinë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për përballjen me pandeminë dhe pasojat që kanë ardhur prej saj, kjo nuk mund të jetë çështje e një 5-minutëshi që kalon, kur edhe ministrja nuk është e pranishme, sepse ka një punë tjetër, ndërkohë që këtu trajtohet një projektligj i sjellë prej saj.

Ndoshta duhet të zhvillojmë një seancë të gjatë në këtë parlament, ku të flasim edhe për mënyrën si u trajtua në momentet e para, por edhe sesi po vazhdon të trajtohet dhe cila do të jetë rruga që do të zgjidhet, pra cili do të jetë fundi dhe si do t'ia dalim të shkojmë në fund të këtij tuneli. Sigurisht, mund të më thonë që këtë

nuk e dinë as shtetet e tjera, nuk dihet si do të evoluojë, por, të paktën, ne duhet të kemi një logjikë dhe një strategji. Kjo na takon të gjitha palëve. Kjo do të thotë se ky krahu këtej nuk është se e mendon më keq se ky krahu tjetër këtej, ose ende më e rëndë, ata që janë përfaqësues të ekzekutivit nuk mund të mbyllin veshët dhe sytë para gjërave që thuhet si nga përfaqësuesit e PS-së, ashtu edhe nga përfaqësuesit e opozitës.

Kjo lloj arrogance dhe kjo lloj shprehjeje e ekzekutivit ndaj parlamentit nuk duhet të ndodhë. Nuk ka asnjë arsye pse sot deputetët duhet të jenë më pak të besueshëm se punonjësit e ministrive. E pra, kjo ndodh. A e dini pse ndodh? Sepse në këtë vend ka ende një mentalitet autoritarist, i cili ushqehet çdo ditë dhe prej të cilit ne nuk kemi bërë divorc kurrë, nuk jemi ndarë kurrë.

Në këtë sallë ka një deputet, të cilit sot duhet t'i vijë turp që është bashkë me ne. Ai vazhdon dhe uron Festën e Çlirimit, "29 Nëntorit" me foton e Enver Hoxhës. Nga ky krahu këtej ka persona, të cilëve personi për të cilin bëhet fjalë, jo deputeti, por Enver Hoxha, mund t'u ketë vrarë njerëzit e shtëpisë. Disa në këtë sallë e trajtuan si çështje etike. Por, jo, këto janë çështje, të cilat duhet të trajtohen penalisht. Kemi sjellë këtu ligjin për dekomunistizimin, kemi sjellë ligjin për heqjen e medaljeve, kemi sjellë ligjin që duhet të ikin nga postet drejtuese, nga politika, nga drejtësia të gjithë ata që i kanë duart me gjak nga sistemi i kaluar.

A e dini pse e kemi bërë? Sepse ende nuk kemi arritur të ndahemi nga "vlerat" e së kaluarës, ende nuk kemi arritur t'i themi të keqes "e keqe" dhe të mirës "e mirë". Sigurisht, tentuam të ndërtojmë një sistem tjetër, të bazuar në vlera krejt të tjera, por ky sistem nuk mund të ngrihet në qoftë se ne kemi të njëjtin mentalitet, nëse ende nuk kemi dënuar krimet e së kaluarës. Mbi krimet e së kaluarës nuk mund të ngrihet një shoqëri e drejtë. Ne nuk jemi të gjithë bashkëvuajtës dhe bashkëfajtorë, disa janë fajtorë dhe disa janë vuajtës nga ai regjim. Sot nuk mund të amnistojmë dot askënd nga ata që i përkasin të kaluarës dhe të ngremë një shoqëri, e cila është krejtësisht e pavërtetë, hipokrite.

Sot gjendemi në këtë hendek, ku ende del një deputet dhe guxon të thotë se Enver Hoxha ka qenë hero, komandant dhe burrë i madh. Unë

e kuptoj që ka shumë zhgënjim për atë që ka bërë klasa politike në këta 30 vjet, e cila herë i sulet Shqipërisë, dhe shqiptarët herë i trajton si shërbëtorë të pronës publike, herë si pronarë të pronës publike, por kjo nuk është arsye e mjaftueshme të amnistosh krimet e një periudhe gjysmëshekullore, që e kanë privuar Shqipërinë nga një histori normale.

Sot duhet të kishim një histori, e cila duhet të shkonte për nga progresi, por, për fat të keq, ne gjendemi brenda një spiraleje ku përsërisim veten. Ne kemi përsëri tendenca autoritariste, ne kemi tendenca që të ngatërrojmë vlerat, të mos i themi të mirës "e mirë" dhe të keqes "e keqe" dhe kemi po ashtu armiqtësi të fshehura, të cilat shkojnë deri në fund, në pjesët dhe segmentet e fundit të këtij vendi.

Pikërisht për këtë do të duhet të fillojmë dhe të kemi një periudhë të re të qasjes me të kaluarën, por edhe një periudhë të sjelljes ndryshe ndaj institucioneve, sepse nga legjislativi buron ekzekutivi dhe nga parlamenti buron qeveria. Nuk mundet në asnjë mënyrë që asnjë prej deputetëve të pranojë t'i sjellin letra të tilla ku thuhet thjesht se do të bëhet një ndryshim dhe nuk dimë asgjë se çfarë do të bëhet, por të gjithë ngremë dorën thjesht se është çështje pandemie dhe për respekt të jetës njerëzore. Kjo nuk mund të vazhdojë dot më në këtë situatë. Të paktën Komisioni i Shëndetësisë, ashtu siç e bën edhe Komisioni i Sigurisë, do të duhet të informohet, por mbi të gjitha arroganca e këtyre që janë prapa nesh duhet të marrë fund. Këtë jua them edhe kolegëve nga ky krahu, edhe kolegëve nga krahu tjetër.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** –Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar".

Fjalën e ka zonja Ibrahimaj.

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ky muaj intensiv i punës për prezantimin e buxhetit të vitit 2022 në Kuvend nuk ka lënë jashtë vëmendjes së Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë dhe të qeverisë shqiptare një angazhim ndër më kryesorët që ai ka, atë të forcimit të luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe luftës kundër korrupsionit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton në nivel global tek Task Forca e Veprimtarisë Financiare (FATF) dhe, si rrjedhojë, ndjek zbatimin e politikave dhe të planit të dakordësuar në tetor të vitit 2018, pjesë e planit të përbashkët kundër terrorizmit, ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Nga ana tjetër në nivel rajonal Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton në Komitetin e Ekspertëve për mbikëqyrjen financiare mbi adresimin e rekomandimeve të MONEYVAL-it dhe të grupit të posaçëm për veprimin financiar. Pikërisht për të qenë në linjë me rekomandimin e këtyre organizatave dhe me standardet ndërkombëtare kemi ndërmarrë nismën ligjore të rishikimit të ligjit organik të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke harmonizuar dispozitat e këtij ligji në përputhje me direktivën e ndryshuar të BE-së mbi parandalimin dhe përdorimin e sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, një angazhim ky i premtuar dhe i mbajtur për t'u përmbushur brenda këtij viti.

Qëllimi madhor i ndryshimeve të sjella përmes këtij projektakti është fuqizimi i mekanizmit parandalues në pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke kontribuar në fushën e sigurisë kombëtare dhe globale nga njëra anë dhe në përmbushjen e detyrimeve tona në procesin e integritetit evropian.

Ky ligj, me ndryshimet e tij, sjell rishikimin e rikategorizimit dhe rikategorizimin e subjekteve raportuese, duke bërë qartësimet e nevojshme, të cilat në ligjin aktual lënë vend për ambiguitet për kategorinë e subjekteve të ekspozuar politikisht apo të familjarëve të tyre apo duke kategorizuar veçmas audituesit, kontabilistët e miratuar dhe këshilltarët tatimorë, si subjekte raportuese. Përfshin edhe kategoritë e tjera raportuese si shitësit e veprave të artit, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme, që kryejnë transaksione mbi 500 mijë lekë në rastet e dhënies me qira, si dhe përfshirjen si subjekte raportuese të çdo individi, person fizik apo juridik, që tregtojnë mallra mbi 1 milion lekë.

Për herë të parë kemi parashikim në projektligj për një procedurë të qartë të vigjilencës së zgjeruar, për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo transaksioneve të vendeve me risk të lartë. Për herë të parë përcaktojmë në ligj detyrimet edhe për ofruesit e shërbimeve virtuale si parashikimi i detyrimit për t'iu përgjigjur kërkesave të DPPP-së, detyrim, i cili nuk ka qenë më parë për këtë kategori subjektesh.

Në përgjigje të rekomandimeve të MONEYVAL-it dhe të FATF-s, ky ligj rishikon sanksionet administrative si për personat fizikë, ashtu edhe për ata juridikë, nisur nga fakti se ato sanksione që janë aktuale në ligj janë të ulëta dhe joproportionale. Janë ndryshuar afatet e ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të marrëdhënies ndërmjet biznesit dhe klientit, të cilat variojnë nga 50 vjet deri 40 vjet, duke iu përshtatur procedurave të parashikuara në Kodin Penal kombëtar.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju theksoj se prej hyrjes së Shqipërisë në listën gri në muajin shkurt të vitit të kaluar, pavarësisht të gjitha vështirësive të shkaktuara nga pandemia Covid-19, qeveria shqiptare ndërmori menjëherë një angazhim të nivelit të lartë politik për zbatimin e planit të veprimit të dakordësuar nga FATF. Që prej atij momenti ne kemi adresuar të gjitha çështjet që konsiderohen si decizive për daljen nga lista gri dhe tashmë kemi një kuadër të plotë ligjor dhe funksionim të plotë të regjistrave për deklarimin e pronarëve përfutës, si dhe të regjistrat të centralizuar të llogarive bankare, të cilat janë ndër mjetet më efektive që institucionet ligjzbatuese duhet të përdorin për të gjurmuar të dhënat dhe veprat penale në fushën e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Kemi miratuar ligjin për organizatat jofitimprurëse, i cili do të jetë një mekanizëm më shumë për transparencën e të dhënave në këtë sektor dhe për ndjekjen e veprimtarive të organizatave që mund të jenë të përfshira në aktivitete kriminale. Është në funksion të plotë ligji dhe projekti i fiskalizimit, i cili jo vetëm do t'i shërbejë qëllimit të tij primar, pra qëllimeve primare, atyre të rritjes së mbledhjes së të ardhurave, reduktimit të informalitetit, rritjes së eficientës së administratës tatimore, por edhe gjurmimit në kohë reale të çdo subjekti, individi

apo OJF-je të përfshirë në vepra penale të lidhura me evazionin apo pastrimin e parave, duke e bërë Shqipërinë vendin e parë në rajon të pajisur me infrastrukturën e nevojshme në këtë drejtim dhe duke shërbyer si një kartë jeshile në përmbushjen e rekomandimeve përkatëse për daljen nga lista gri.

Kemi rritur numrin e dënimeve penale për veprat penale të pastrimit të parave, si dhe kemi rritur numrin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve lidhur me këto vepra, ku theksi i veçantë është vazhdimi i reformës në drejtësi.

Të pajisur me të gjitha instrumentet e duhura dhe në kuadër të planit të veprimit ICRG/FATF kemi kryer analiza risku sektoriale për produkte specifike për parandalimin e pastrimit të parave dhe financime të terrorizmit, duke u përqendruar te rreziku i keqpërdorimit të personave juridikë, ai i pastrimit të parave në sektorin e pronave të paluajtshme për agjentët e pasurive të paluajtshme, për avokatët, për kontabilistët dhe audituesit, kemi kryer analiza risku të aseteve virtuale dhe të atyre shërbimeve të aseteve virtuale për pastrim parash dhe financim terrorizmi.

Tashmë bashkëveprimi me institucionet mbikëqyrëse, nëpërmjet inspektimeve të përbashkëta, duke përfshirë noterët, avokatët, audituesit ligjorë apo institucionet financiare, është në një nivel më të lartë.

Kemi rritur bashkëpunimet me organizmat e akuzës dhe të korrupsionit si: SPAK-u, Prokuroria dhe SHISH-i.

Po punojmë për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të detyrimeve që rrjedhin nga ligji kombëtar, por edhe detyrimeve ndërkombëtare.

Po punohet në fushën e licencimit të profesioneve të lira, si: noterët, avokatët, agjentët e pasurive të paluajtshme apo audituesit, si dhe kontabilistët, për të cilët është kërkuar që subjektet mbikëqyrëse të kryejnë një proces të mirëfilltë shqyrtimi, pra vetingut të tyre, me qëllim parandalimin e çdo licencimi me historik kriminal, për t'u ushtruar nga këto profesione të lira.

Të nderuar deputetë,

Jam e vetëdijshme se kemi ende shumë punë për të bërë, por më lejoni të them se ndryshime të tilla, siç është hyrja dhe dalja nga lista gri, pra në monitorim të shtuar, nuk vijnë si

pasojë e vendit që vlerësohet, por ka shkaqe që lidhen me metodologjitë e përdorura nga këto organizma.

Vlerësimi i organizmave ndërkombëtare është një vlerësim sa teknik, aq edhe i nivelit të zbatimit të politikave. Shqipëria ka hyrë në listën gri në vitin 2012, në vitin 2015 dhe tashmë sërish në vitin 2020. Është e rëndësishme të analizojmë arsyet, shkaqet e hyrje-daljeve të Shqipërisë nga lista gri dhe, mbi të gjitha, reagimet e qeverisë në drejtim të përmirësimit të eficiencës së luftës kundër parandalimit të pastrimit të parave.

Në vitin 2012 Shqipëria kishte një mungesë të theksuar strategjike në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u vlerësuar nga FATF-ja si një vend me mungesë, deficiencë të thellë në legjislacionin dhe implementim të proceseve të identifikimit, gjurmimit dhe sekuestrimit të aseteve kriminale, si dhe me mungesë të legjislacionit për financimin e terrorizmit.

Në vitin 2020 jemi vlerësuar për mungesë efektiviteti të masave të marra. E si mund të ishte ndryshe?! Për të arritur një reformë, fillimisht duhet të hartohet e gjithë baza ligjore, duhet të forcohen institucionet dhe më pas të flitet për eficiencë dhe efektivitet të tyre.

Reforma në drejtësi nuk ishte e lehtë, por u zbatua. Nuk duhet të harrojmë që përfshirja në listën gri është një proces që e kalojnë shumë shtete. Në rajon, deri në vitin 2019 Serbia ka qenë në listën gri, gjithashtu, në vitin 2020, së bashku me Shqipërinë, në listën gri ishin edhe vende si Islanda dhe aktualisht është Malta dhe Turqia. *Open Data* është strategjia politike, ku duhet të vepohet për të luftuar korrupsionin dhe pastrimin e parave, dhe ne e kemi bërë këtë duke filluar me regjistrimin e pronarëve përfitues me *databazën PEP-së* apo me *databazën* e kompanive offshore.

Absolutisht, përpjekjet tona janë të shumta, gjithashtu edhe përparimet. Synimi ynë është të integrohemi në BE duke i përmbushur të gjitha standardet. E them këtë me bindje të plotë se kurrë më parë nuk kemi pasur një intensifikim të punës kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave si vitet e fundit.

Lufta kundër korrupsionit dhe ryshfetit është një sfidë për të gjithë ne dhe dukshëm mund të lexohet jo vetëm përmes indeksesh, të cilat kanë burime të ndryshme informacioni, por

edhe metodologjie matjeje, gjithashtu mund të lexohet edhe në përpjekjet tona ndaj këtyre fenomeneve.

Flasim për një rrjet antikorrupsioni, ku çdo agjenci ka një koordinator korrupsioni.

Flasim për transparencë publike dhe shërbimet dixhitale në masën 90%, të cilat kanë minimizuar kontaktet fizike me zyrat e qeverisë.

Flasim për një sistem denoncimi të korrupsionit dhe për institucione, të cilat e investigojnë atë në prokuroritë speciale, që merren pikërisht me këto raste.

Tashmë, kur vigjilenca është shtuar dhe barrierat në çdo nivel janë forcuar, nuk mund të flasim për një nivel të lartë korrupsioni bazuar vetëm në perceptime. Megjithatë, siç thotë një eksperte e nivelit të lartë të fushës antikorrupsion: “Sa më e madhe të jetë përpjekja për marrjen e masave kundër korrupsionit, aq më i lartë është perceptimi për ekzistencën e tij”.

Të nderuar deputetë,

Prezantimi i këtij ligji shumë sensitiv ka sjellë mjaft diskutime në komisione për shkak të rëndësisë dhe objektit që ai ka në fokus, por më lejoni të theksoj se qeveria shqiptare ka marrë masa për të realizuar atë çka të gjithëve ju, të nderuar deputetë, por edhe neve, na shqetëson, dalja e Shqipërisë nga lista gri.

Sot, më shumë se një vit nga hyrja e Shqipërisë në listën gri, kemi marrë masa për të pasur 3 elementet bazë në luftën kundër pastrimit të parave:

- 1- bazën ligjore;
- 2- burimet njerëzore, nëpërmjet nëpunësve civilë të trajnuar që punojnë në institucione të forta;
- 3- pajisjet me sisteme dhe *data* baza të ndërthurura jo vetëm me sistemet tona në vend, por edhe me ato ndërkombëtare.

Me miratimin e këtij projektligji jo vetëm që do t'i hapim dritën jeshile Shqipërisë për daljen nga statusi në monitorim të shtuar, por, edhe më shumë se kaq, do të bëjmë një hap më shumë në harmonizimin e politikave dhe ligjeve në përputhje me standardet e BE-së, si e vetmja rrugë e përbashkët në integrim, prosperitet, siguri kombëtare dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Ju ftoj të gjithëve ta votoni atë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zotin Lulzim Basha.

**Lulzim Basha** – Të dashur bashkëqytetarë, zonja dhe zotërinj,

Do të isha thellësisht i prekur, madje i mallëngjyer nga fjalimi që sapo dëgjova, nëse kjo do të ishte dita ime e parë në Shqipëri apo do të isha nga ato personazhet që vijnë për 3 orë dhe nuk dëgjojnë opozitën, por takojnë vetëm qeverinë dhe atë pjesë të shoqërisë civile që paguhet nga qeveria.

Por, në fakt, zonja dhe zotërinj, ju e dini fare mirë se kjo pseudomaxhorancë, anëtarët e së cilës prej disa vitesh shfaqen rregullisht në përgjimet e antimafias italiane dhe jo vetëm, ka sjellë në këtë seancë një projektligj, i cili, gjoja synon parandalimin e pastrimit të parave të pista. Të gjithë ata, që e njohin mirë realitetin e përditshëm të Shqipërisë, qofshin shqiptarë apo të huaj, e kanë parë dhe e shohin përditë se si gjatë sundimit të kësaj pseudomaxhorance, institucionet u gangsterizuan, llumi i shoqërisë u fut lirshëm në parlament dhe në bashkitë e vendit. Krimi i organizuar ka sekserë me emër dhe mbiemër në nivelet më të larta të qeverisë. Në mendjet e të gjithëve lind rrefshëm pyetja: a mund të jenë po këta që propozojnë masa për parandalimin e pastrimit të parave? A mund të jenë këta, që lejuan me urdhër politik kanabizimin e Shqipërisë, shndërrimin e vendit në Kolumbinë e Europës dhe në prodhuesin e parë të kanabisit në kontinent, sipas OKB-së, të njëjtët që mund ta ndalojnë pastrimin e parave? A mund të jenë këta, të cilët lejuan që shifrat marramendëse të eurove, që prodhoi trafikimi masiv i drogës, të pastroheshin e të pastrohen pa kokëçarje në kryeqytet dhe në zonat më ekskluzive të bregdetit shqiptar, që janë edhe më të mbikëqyrurat, frenuesit e pastrimit të parave? A mund të jenë ata, që kapitenin më të suksesshëm të betejës me drogën, kanë ministrin e parë të Brendshëm në historinë e këtij vendi të akuzuar zyrtarisht për trafik narkotikësh, garantues të luftës kundër pastrimit të parave të pista? A mund të jenë këta, që në janar të këtij viti dolën në përgjimet e antimafias së Katanxaros, me titujt e tyre, si kryeministër, ministër apo kryetarë bashkie, ku drejtues të një prej organizatave mafioze më të rrezikshme në botë, *Ndrangeta*-s italiane, bënë plane për leje ndërtimi korruptive në Tiranë dhe në bregdet, për tenderë të qeverisë shqiptare, për koncesione dhe llokma të përcaktuara qartë e me përqindje të

majme, garantët që paratë nuk do të pastrohen më në Shqipëri?

A mund të jenë këta, që jo më pak se 2 javë përpara dolën prapë në përgjimet e antimafias italiane, këtë herë me një tjetër organizatë mafioze, po kaq të rrezikshme si është *Ndrahngeta, Cosa Nostra-n*, si garantët e një operacioni të pastrimit të parave, për të cilin merrej si i mirëqenë bashkëpunimi i zëvendëskryeministrit dhe drejtuesit të Drejtorisë të Pastrimit të Parave, autorët të iniciativave parandaluese dhe ndëshkuese? A ka nevojë t'u përgjigjem këtyre pyetjeve që janë thjesht e vetëm retorike apo të mjaftohem vetëm me përgjigjen që keni në maj të gjuhës, të dashur bashkëqytetarë, përgjigjen që e dinë fare mirë edhe këta që na kanë sjellë ndryshimet e propozuara?

Asnjëri prej jush, që përgjatë këtyre viteve ka toleruar, ka inkurajuar, ka nxitur dhe ka përfutur nga pastrimi i parave të pista, nuk mund të jetë garanti i luftës kundër pastrimit të parave të pista dhe të përdorë iniciativa të tilla, si një përpjekje për të mbyllur sytë, veshët, madje edhe hundën, që qytetarët nën propagandën tuaj të mos ndiejnë kutërbimin e parave të pista, të korrupsionit qeveritar dhe të krimit të organizuar. Nuk ka asnjë rastësi në këtë veprimtari, madje është e pafalshme të kërkosh për gjurmë, ndërsa ujku është në këtë sallë dhe pak metra jashtë saj. Mjaft të dalim nga kjo ngrehinë dhe të shohim me sy të lirë se si të rrethuara me skelat e ndërtimit centrifugat e qindra lavatriçeve, që pastrojnë paratë me miratimin e kësaj qeverie, pa të cilën nuk hidhet dot një lopatë beton, rrotullohen 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Kjo shkon dorë më dorë me një paradoks kriminal: në vendin ku baballarët përfundojnë në qeli, sepse merremtojnë shtëpitë e tyre apo burgosen, sepse lidhin energjinë elektrike për shkak të pamundësisë për ta paguar për ngrohjen e fëmijëve të tyre, ata, që me bekimin e këtyre pastrojnë miliona euro, vijnë pa kokëçarje të hedhin kat mbi kat përfitimet e parave të korrupsionit dhe të drogës, duke shkatërruar besimin e qytetarëve të shteti dhe institucionet, duke goditur konkurrencën dhe ekonominë.

Asnjë sipërmarrës i ndershëm nuk përballet dot sipas rregullave të tregut, sepse tregu nuk u përgjigjet më ligjeve të tij, por ligjeve të korrupsionit dhe klaneve të drogës. Këto nuk

janë vetëm cilësime të Partisë Demokratike, janë të evidentuara nga raportet ndërkombëtare të Këshillit të Europës dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Shqipëria është renditur nga MONEYVAL-i, nga struktura e përhershme e Këshillit të Europës, në listën gri të vendeve me probleme të mëdha në luftën kundër pastrimit të parave. Indeksi i Bazelit këtë vit rrezikun për pastrim parash në vendin tonë e ka rritur, duke e ulur Shqipërinë 28 vende në krahasim me vitin e shkuar, duke e konsideruar nga më të rrezikuarit në rajon dhe në Europë.

Po sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, citoj: “Shqipëria mbetet e pambrojtur ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, krimit të organizuar dhe institucioneve të dobëta ligjore dhe qeveritare”. Vitin e kaluar nisma globale kundër krimit të organizuar ndërkufitar, e financuar nga qeveria gjermane dhe norvegjeze, nxori në pah skemën me të cilën financohen qiellgërvishtësit që u kanë rrëmbyer diellin rrugëve të Tiranës, ku thuhet: “Rreth 60% e firmave të ndërtimit, që kanë marrë leje në periudhën 2017- 2019 në kryeqytet, nuk justifikojnë burimet e tyre financiare, ndërsa vlerësohet se për këtë periudhë 3-vjeçare janë pastruar në aktivitetin e ndërtimit rreth 1,6 miliardë euro para të pista”.

Mbyllet citimi: “1,6 miliardë euro!” Një shumë e frikshme që mban në këmbë ekosistemin e kalbur, ku gjallon krimi dhe korrupsioni, në të cilin ndërthuren interesat e politikanëve të korruptuar, oligarkëve të panginjur dhe botës së krimit, që e kanë kthyer Shqipërinë në një lavatriçe gjigante të pastrimit të parave, e cila jo vetëm dëmton ekonominë, por edhe trashëgiminë, kujtesën historike dhe hapësirën publike dhe gjithçka tjetër që nën sundimin tuaj antiqytetar dhe antikombëtar kthehet në plaçkë për fare pak njerëz. Madje kjo lavatriçe nuk ndaloi së punuari edhe në ato ditë të vështira, kur në momentet më kritike të pandemisë, detyruat me autoblanda të ndalonte gjithçka tjetër. Kur e gjithë ekonomia ndaloi, duke pësuar goditje edhe për shkak të paketave gjysmake, më të ulëtat në rajon, çuditërisht ndërtimi pësoi një rritje të pashpjegueshme, me miliona metra katrorë beton të hedhur jo të mbështetur në ekonominë reale, por në atë të zezë, jo të motivuar nga nevojat e tregut, por nga



domosdoshmëria për të nxjerrë paratë e korrupsionit dhe të drogës nga dyshekët e për t'i kthyer ato në beton dhe grataçiela.

Po aq çuditërisht, në një vend të varfëruar dhe të plakur nga largimi i qindra-mijëra bashkëqytetarëve tanë, kryesisht nën moshën 30 vjeç, ky shpërthim ndërtimesh nuk vepron sipas rregullave të kërkesë-ofertës, sepse në një vend, ku fuqia blerëse vjen në ulje, në vend që të ulët çmimi për metër katror, ndërkohë që shtohet numri i ndërtimeve dhe sasia e metrave katrorë të ndërtuar, çmimi vetëm rritet. Rritet, madje kalon edhe nivelet e kryeqyteteve të vendeve të pasura të BE-së.

Kjo gjë prodhon një efekt tjetër negativ për shumicën e shqiptarëve dhe të familjeve të tyre, që nuk fitojnë më shumë se 500 mijë lekë të vjetër në muaj, sidomos familjet e reja, dhe efekti është pamundësia për të ëndërruar për të blerë një shtëpi me çmim të arsyeshëm, sepse çmimin nuk e përcakton tregu, nuk e përcakton konkurrenca, e përcaktojnë korrupsioni, ryshfeti, paligjshmëria, pastrimi i parave të pista të korrupsionit qeveritar dhe të krimit të organizuar. Është ky karshillëk që përbuz punën e ndershme, përbuz mundin e burrave dhe të grave të këtij vendi për ta ndërtuar jetën e tyre këtu, me të cilin nxiten dhe ushqehen mosbesimi, apatia, dëshpërimi dhe në fund dëshira dominuese për ta lënë këtë vend.

Ndërsa e gjithë kjo skemë mafioze vijon të veprojë, pavarësisht asaj që shohim me sy të lirë në Tiranë, kudo në qytetet tona, në bregdetin tonë, pavarësisht alarmit të ngritur në raportet më serioze të partnerëve tanë ndërkombëtarë, nga organizatat, studiuesit, nga gazetarët kurajozë të medieive vendase dhe të huaj, asnjë nga institucionet përgjegjëse nuk e vë ujin në zjarr, nuk pyet, nuk heton dhe nuk i monitoron këto leje ndërtimi që u jepen kompanive fantazmë, sepse asnjë nga këto institucione nuk bën punën minimale: nuk ndjek paranë.

Kjo *omertà* institucionale, ky kod heshtjeje që i përket mafies dhe subjekteve të saj, zbulon si fajtorë të gjithë ata që kanë detyrën të mos e lejojnë Shqipërinë të kthehet në një parajsë për pastruesit e parave dhe miqtë e tyre në politikë. Nga ana tjetër, mosveprimi, paraliza e institucioneve dhe e shtetit të kapur e shndërron Shqipërinë në një ferr pandershmerie dhe pandëshkueshmërie për qytetarët që kërkojnë

standarde minimale, që meritojnë standarde europiane për të ndërtuar jetët e tyre dhe të familjeve të tyre në vendin e tyre.

Kjo *omertà* po prodhon një ekonomi të droguar, që nuk pasqyron forcat normale të tregut, që prodhon një rritje fiktive në letër, pa vende pune, pa fuqi blerëse, pa mirëqenie, përveç mishngrënësve të Nusretit dhe Kryeministrit me avion privat qeveritar e një grushti të pangjinshëm oligarkësh. Ju krekoseni me sukseset tuaja imagjinare, por, në fakt, kjo *omertà* gjymton konkurrencën, iniciativën e lirë, besimin te shteti shqiptar, besimin te ligji që, siç shihet në fakt, është kthyer jo në mbrojtës të ligjit, por në legjitimues të krimit dhe korrupsionit që kryhet për t'i pastruar këto para.

Fundi i kësaj *omerta*-je, e përsëris dhe do ta përsëris derisa SPAK-qilimkuqit t'i dalin së mbari kicat, pret që drejtësia të mos fshihet pas gishtit, por të hapë sytë e të veprojë sipas ligjit. Nuk është e vështirë. Mjafton të ndiqni paratë, zotërinj të SPAK-ut, mjafton një xhiro në këmbë në Tiranë, të zbrisni nga makinat tuaja të blinduara, të ngrini kokën lart e, teksa ju merren mendtë nga katet që mezi numërohen më sy të lirë, t'i shtroni vetes pyetjet që çdo qytetar i këtij vendi i bën vetes, kur sheh që kullat e parave të pista mbijnë si kërpudhat pas shiut; të parave të pista që kjo qeveri i lejon dhe heshtja e mosveprimi i SPAK-ut dhe i institucioneve të tjera i legjitimon me hetimet që nisen e nuk bitisen.

Kjo *omertà* merr fund, kur në këtë sallë, edhe ata nga ky krah i parlamentit, që nuk duan të digjen si i njomi me të thatin, do të pranojnë se kjo e keqe, që sot pretendoni ta ndaloni me këto propozime në këtë ligj që nuk zbatohet, e ka origjinën tek e keqja më e madhe që ka kapur shtetin, te korrupsioni, i cili, përpara se të pastrohet në mënyrë të ndjeshme nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duhet të shfaroset së pari nga kjo sallë, duke pastruar këtë sallë dhe qeverinë nga të gjithë ata, që janë pjesë e pengesave të zhvillimit normal politik, ekonomik dhe social të vendit, për shkak të abuzimeve që kanë kryer, duke shpërdoruar besimin e qytetarëve, duke pasuruar veten në dëm të qytetarëve të shtetit më të varfër të Europës.

Faktet që ju rendita, të cilat lehtësisht mund t'i verifikoni nëpërmjet dokumenteve zyrtare, nga ato të SHISH-it tek ato ndërkombëtare,

tregojnë sa serioz dhe alarmant është fenomeni i pastrimit të parave dhe është e qartë se ai nuk mund të zgjidhet me ndryshime estetike, kinse për ta përafuar legjislacionin tonë me atë të BE-së. Për përballjen me këtë gangrenë të rëndë, ka një rrugë, ka një zgjidhje, ka një pikënisje: pranoni për veten tuaj atë që kërkoni të bëni të detyrueshme për noterët, që i keni sjellë si propozim në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave, vetingun për politikanët! Nëse ky mjet gjykohet nga ju si i nevojshëm për noterët, përmes të cilit synohet pengimi i pastrimit të parave, e njëjta logjikë duhet të vlejë edhe për politikanët.

Pse një trajtim preferencial, pse dy standarde?! Për më tepër, në dallim me noterët, përgjegjësitë e politikanëve janë shumë më të mëdha, efektet dhe impaktet e vendimeve të politikanëve janë shumë më serioze, ndaj edhe cilësia e politikanëve, pastërtia e figurës së politikanëve, që doemos reflekton edhe vendimmarrjen në interes të qytetarëve, e bën të moralshme edhe përpara qytetarëve që të jemi ne të parët të kalojmë nga ky filter dhe kurrsesi nuk mund t'ua imponojmë të tjerëve e ta shmangim për veten tonë.

Pra, kjo çështje është shumë e thjeshtë dhe duhet të trajtohet me kurajë, pa frikën e fatit personal të askujt. Për të ndalur pastrimin e parave, deformimet e panumërta që pandëshkueshmëria, korrupsioni dhe lidhjet me krimin kanë prodhuar në ekonomi dhe në shoqëri, duhet të fillojmë me pastrimin e politikës.

Kjo është çështja kryesore, këtu ndahet e shkuara nga e ardhmja. Çdo debat tjetër është një zgjatje e panevojshme e një shfaqjeje që shqiptarët e kanë vuajtur në kurriz për shumë gjatë, duke e lënë vendin në pozita të pamerituara në krahasim me shtetet e tjera, sidomos në raport me ku duhet të ishte, për shkak të burimeve natyrore që Zoti i ka falur Shqipërisë dhe me potencialin njerëzor që ka.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për ministrin Ibrahimag.

**Delina Ibrahimaj** – E dëgjova me vëmendje fjalën dhe ajo që më mbeti në mendje është përsëritja e fjalëve “terr”, “tmeri”, “mafie” “varfëri”, “mjerim”. Si duket, nuk jetojmë në të njëjtin qytet apo në të njëjtën Shqipëri, ku në

datën 25 prill shqiptarët votuan për këtë qeverisje dhe për këtë maxhorancë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, mos flisni nga vendi! E dëgjojmë me respekt zonjën që flet.

**Delina Ibrahimaj** – Sot jemi këtu për të diskutuar disa ndryshime në një projektligj, i cili jo vetëm na përafro me standardet e BE-së, jo vetëm e ndihmon Shqipërinë në daljen nga lista gri, jo vetëm e ndihmon në luftën kundër pastrimit të parave, kundër akteve terroriste, kundër korrupsionit, por na bën krenarë që jemi duke marrë nisma, të cilat do ta zhvillojnë intensifikimin e luftës sonë kundër parandalimit të pastrimit të parave.

Dëgjova për mjerimin dhe varfërinë, ndërkohë që kjo qeveri i ka rritur vendet e punës, ka rritur të ardhurat për frymë, ka rritur zhvillimin ekonomik të vendit; dëgjova për të gjitha kullat që po ndërtohen të Tiranë që, në perceptimin tuaj, tregojnë për pastrim parash, ndërkohë që, në perceptimin tim, tregojnë zhvillim, tregojnë ecurinë ekonomike, e cila nuk duket vetëm me sy, por duket edhe në shifra. Shifrat e INSTAT-it treguan se nuk ka një rritje vetëm në sektorin e ndërtimit, por ka një rritje gjithëpërfshirëse në tërë sektorët e ekonomisë. Jam e bindur se parashikimi për rritjen me 7, 8 %, që FMN-ja ka bërë për vitin 2021, do të tejkalohet, duke parë ecurinë e të ardhurave. I ndjek me kujdes të gjithë treguesit e të ardhurave nga tatimet apo nga doganat, dhe të gjitha sipërmarrjet po lulëzojnë.

Për njëmbëdhjetëmujorin, ne kemi realizuar një rritje prej 8, 6 % më të lartë se viti 2019. Nuk e krahasoj vetëm me vitin 2020, sepse patjetër ishte një vit i pakrahasueshëm, për shkak të asaj që ndodhi, për shkak të pandemisë, por e krahasoj me 2019-ën. Pra, ekonomia jo vetëm e ka marrë veten, por po ecën me ritme shumë më të shpejta se ç'ishte para vitit 2019.

Rritja e çmimeve të banesave në një qytet si Tirana është një rritje normale dhe nuk mund të lidhet vetëm me blerjen e banesave të reja, por lidhet edhe me rritjen e vlerës së aseteve, që këta individë kanë, por edhe me përdorimin e fondeve që mund të vijnë nga shitja e aseteve apo nga vendosja e aseteve në kolateral. Besoj se të gjithë ekonomistët në sallë e kuptojnë këtë.

Unë dua t'ju kërkoj të gjithë anëtarëve të parlamentit, si nga ana e maxhorancës, ashtu

edhe nga ana e opozitës, që aty ku ka ndërhyrje të mira ligjore, aty ku ka progres, të mos hedhin baltë e të mos politizojnë çdo lloj ligji dhe ndërhyrjeje, që i sjellim me qëllime të mira. Unë dua t'ju kujtoj se qytetarët shqiptarë janë këtu, jetojnë këtu dhe i mbajnë mend shumë mirë të gjitha radhët që mbanin dhe ryshfetet që jepnin për të marrë një certifikatë, për të marrë një vërtetim nga çdo institucion, që sot nuk kanë më nevojë t'i marrin, nuk kanë më nevojë të luten, nuk kanë më nevojë të japin ryshfete, pasi çdo gjë mund ta bëjnë online, në një kohë më të shkurtuar, pa pasur nevojë të angazhohen me asnjë punonjës të administratës publike.

Unë dua t'ju kujtoj se të gjitha organet ligjzbatuese janë aty për të kontrolluar të gjithë drejtuesit e nivelit të lartë, me qëllim që të mos angazhohen në vepra korruptive. Të gjitha ligjet e parashikojnë këtë. Të gjitha sistemet e parashikojnë këtë.

Ju lutem, votoni ligjin dhe mos hidhni baltë mbi çdo nismë të qeverisë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Taulant Balla.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Po, urdhëro!

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Bie dakord me ministren e Financave, që ligji përpiket të na përafrojë me direktivat e Bashkimit Europian. Nuk është ky problemi që ka Shqipëria...

**Lindita Nikolla** – Tani, keni diskutim apo procedurë, ju lutem?

**Ferdinant Xhaferraj** – Jo, jo, për procedurë. Që ta sqarojmë edhe projektligjin për parandalimin...

**Lindita Nikolla** – Po nuk është procedurë kjo!

**Ferdinant Xhaferraj** – Këtu kemi ministren e Drejtësisë, këtu kemi kryetarin e grupit parlamentar, aty është ministrja e Financave, që të sqarohen edhe shqiptarët që po flasim për parandalimin e parave. A mund të na thoni cili është emri i atij zëvendëskryeministrit, që del te përgjimet e fundit në lidhje me pastrimin e parave?

**Lindita Nikolla** – Nuk është procedurë kjo. Ju lutem, ndërpritjani fjalën!

Fjala për zotin Taulant Balla.

**Taulant Balla** – Unë mendoj se jua kam kërkuar disa herë të bëjmë një seancë të posaçme për Rregulloren e Kuvendit, sepse mendoj se kur një deputeti i jepet fjala, qoftë për ndërhyrje për replikë apo çështje të procedurës, duhet të kalohet më pas.

Megjithatë, do të kisha dashur shumë që zoti Basha të qëndronte në sallë. Në fakt, ndërhyrjen për çështjet e Rregullores e kam edhe në lidhje me kohën. Koha duhet të jetë dhjetë minuta për çdo deputet. Kështu parashikohet në Rregulloren e Kuvendit. Megjithatë, zotit Basha do të doja t'i sugjeroja, meqenëse Sali Berisha na ka akuzuar për bashkëpunëtorë në çështjen e "Toyota Yaris", të bëjë të njëjtën gjë që bëra unë me zotin Basha. Unë e kallëzoja penalisht në gjykatë zotin Basha. Mendoj se edhe zoti Basha ta kallëzojë penalisht në gjykatë zotin Berisha.

*(Ndërhyrje nga salla)duhet*

Meqenëse po flasim për pastrim parash, zotëria që bën zhurmë atje, ka qenë avokat i zotit Basha në atë gjyq të humbur nga zoti Basha.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Tani, zonja kryetare, unë nuk e di si do të arrijmë të vendosim rregull në këtë sallë, kur në këtë krah të sallës flet kushdo prej jush, ndërsa këndeje nuk flet askush.

Dua të rikthehem te çështja për të cilën po ju flisja. Unë përsëri i kërkoj zotit Basha ta kallëzojë penalisht zotin Berisha, me padi penale apo civile, si të dojë, nëse zoti Basha paska bashkëpunuar me mua në lidhje me atë çështje. Por është karma. Tridhjetë vjet Sali Berisha çfarë nuk ka thënë për këtë pjesë të sallës. Çfarë nuk ka thënë. Tani mbajeni me shëndet. Tani ka kohë të merret me ju me muaj e me vite, dhe për gjërat që ju na keni akuzuar ne me pa të drejtë, tani dëgjoni Saliun t'jua thotë juve.

Kaq kisha për këtë pjesë.

Për sa i përket ligjit që kemi sjellë, unë ju ftoj ta votoni, sepse është kryekëput me disa gjëra që ju keni propozuar. Keni propozuar çështje që lidhen me vetingun e politikanëve? Pa dyshim. Ky ligj është një ndihmë e madhe për dy institucione, për më shumë organe të tjera ligjzbatuese për pastrimin e parave. Pse? Sepse kemi forcuar konceptin e personit të ekspozuar politikisht dhe të personave lidhur me të. Sepse, natyrshëm, për pastrimin e parave ka dyshime, madje ka hetime edhe për persona të ekspozuar politikisht.

Përse s'e votoni ju këtë? Përse nuk e mbështesni ju forcimin e këtij ligji, që t'i shkojë mbrapa pastrimit të parave edhe në lidhje me personat e ekspozuar politikisht?

*(Ndërhyrje nga salla)*

E keni votuar kundër në komisione.

Tani, për sa u përket subjekteve...

*(Ndërhyrje nga salla)*

Të lutem!

*(Drejtimitin e seancës e merr zonja Felaj)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Bardhi, ju lutem, mos flisni nga vendi! Mos flisni nga vendi!

**Taulant Balla** – Kulturën nuk jua imponoj dot. Respektin ndaj Rregullores do t'jua imponojmë me zor, nëse nuk doni. Kur të mbaroj unë, merrni fjalën ju!

Dëgjova personin që foli, i cili, me sa di unë, është ende kryetar i Partisë Demokratike, zotit Lulzim Basha, që nuk tha asnjë gjë, nëse do të votojë apo jo për këtë projektligj. Kur nuk e thotë kryetari i partisë, nuk do ta thotë bishti i fundit i kavallit.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Prandaj po ju them dhe po ju ftoj ta votoni. Nëse do ta votoni, një mijë herë faleminderit!

Tani, tri gjëra ka ky projektligj: e para, zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave, dhe natyrshëm ai i financimit të terrorizmit.

E dyta, ka të bëjë me parandalimin e hyrjes së produkteve të veprave penale dhe veprimtarive të tjera kriminale, që transferojnë paratë, sikurse u tha këtu apo sikurse është një çështje që është bërë publike, madje zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrimin e parave, e këtu natyrshëm do të nxijsa qoftë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, nën Ministrinë përkatëse të Financave, por qoftë dhe institucione të tjera ligjzbatuese, edhe për kërcënimet që vijnë nga asetet digjitale, nga kriptomonedha që është një dimension tjetër i nevojës për të intensifikuar luftën kundër pastrimit të parave.

Këto janë çështjet. Votoni dhe keni bërë një gjë shumë-shumë të mirë, sepse në fund të fundit, ajo që na intereson është që, përtej fjalëve, të kalojmë në vepra.

Ja pra, kemi një projektligj, i cili na vjen në ndihmë. Ato shifrat që përmendi zoti Basha s'janë të vërteta. Por nuk ka rëndësi. Qoftë dhe një e dhjeta e asaj që thotë zoti Basha, është përsëri një kërcënim. Është një kërcënim për

shtetin shqiptar, për taksapaguesit shqiptarë. Këtu pastaj, do të dal te një element, mos u habisni, që do t'i bëjë një kritikë Ministrisë së Financave, por në tërësi qeverisë, se Ministria e Financave ka vetëm tre muaj që e ka marrë atë detyrë.

Tani, zonja Ministre, ky Kuvend ka për detyrë të miratojë ligje. Aktet nënligjore i keni për detyrë ju. Tani, unë kam votuar këtu, në këtë sallë dhe kam mbajtur një fjalë, përsëri për këtë çështje, në vitin 2019, kur kemi bërë ndryshimet në ligj. Në vitin 2019 kemi futur në ligj edhe parimin e gjobës. Nëse Luli, me "Toyota Yaris"-in, siç thotë Saliu, do të sillte 5 milionë euro, me parimin e gjobës që kemi futur në nenin 17, personat që bënë fushatë për Partinë Demokratike në Laprakë dhe që ishin personat që transportuan paratë me "Toyota Yaris"-in, mos e harroni këtë, ligji thotë se duhet të paguanin deri në 50% të shumës gjobë, por ligji nuk zbatohet, sepse qeveria nuk ka nxjerrë ende aktet nënligjore.

Zonja Ministre, kanë kaluar 2 vjet dhe ende nuk është bërë VKM-ja përkatëse për përcaktimin e mënyrës së vjeljes së gjobës. Çdo ditë dëgjojmë në televizion lajme për persona, të cilët janë kthyer nga Anglia apo Italia me kaq para dhe që janë ndaluar në Rinas apo në një pikë tjetër doganore. Nëse do të kishim miratuar vendimin e qeverisë dhe nëse personi do të ishte përsëritës, do të kishim arkëtuar në buxhetin e shtetit një shumë të madhe të ardhurash. Parimi në fillim ka qenë me gjobë, nëse je shkelës për herë të dytë, 30% dhe për shumat mbi 50 mijë euro shkon deri në 50%. Nuk ka ndodhur.

Prandaj, Kuvendi duhet të rrisë kapacitetet e veta monitoruese, qoftë në aspektin e implementimit të ligjit, qoftë në aspektin e asaj që shkruhet në nenin e parafundit. Për kulturë juridike, në nenin e parafundit, përpara se të përcaktohet koha kur hyn në fuqi, përcaktohet edhe koha për sa kohë duhen bërë aktet nënligjore. Gjashtë muaj, kemi thënë, por kanë kaluar dy vjet.

Merreni kritikën si një instrument për t'u vënë menjëherë në lëvizje që ta bëjmë këtë gjë, sepse qytetarët presin që ne të jemi shembulli i respektimit të afateve që vendosim vetë.

Gjithashtu, dua të them diçka për punën e Kuvendit. Nën kujdesin e veçantë edhe të Kryetares së Kongresit amerikan, zonjës Pelosi,

sot fillon dimensionin parlamentar i Samitit për Demokraci, ku Shqipëria është pjesë, e thirrur nga Presidenti Biden. Dua t'u kërkoj të gjithë kolegëve që, brenda mundësive, të jenë pjesë e këtyre diskutimeve *online* përmes komunikimit në zoom, në mënyrë që në seancat pasardhëse, në vijim edhe të Samitit për Demokraci, të kemi edhe ne disa diskutime, madje, pse jo, edhe mocione me debat për çështje që lidhen me ato diskutime që do të kemi përgjatë samitit, ku, natyrshëm, adresimi i luftës kundër korrupsionit do të jetë njëra prej tri çështjeve madhore të samitit, por edhe të dimensionit parlamentar në kuadër të kongresit. Kongresi është organizuesi, por sigurisht që ...

*(Bie gongu)*

Së fundi, zonja Kryetare, dua të them diçka për procedurë. Zoti Braçe ngriti këtu një shqetësim që për mua është i drejtë dhe për të cilin, t'ju them të drejtën, kam kontaktuar personalisht me ministren e Shëndetësisë dhe ajo me komitetin teknik.

Mbajtja e maskës në ambiente të mbyllura në Republikën e Shqipërisë është detyrim ligjor. Përsëri, sipas akteve të miratuara nga qeveria, një qytetar gjobitet nëse nuk e mban maskën në një ambient të mbyllur. Unë nuk gjej dot një shpjegim pse ne, duke filluar nga anëtarët e qeverisë dhe deri deputetët këtu, jemi të parët që e shkelim një vendim, ligj apo akt që e kemi miratuar vetë?

Sot nuk gjen dot në Europë një parlament ku deputetët të jenë pa maska. Nëse ndonjëri prej jush gjen sot një parlament në Europë ku deputetët marrin pjesë në seancë plenare pa maska, kjo është ...

Zonja Kryetare, është e vërtetë që në Konferencën e Kryetarëve kemi rënë dakord për kushtin që deputetët duhet të jenë të vaksinuar në mënyrë që të marrin pjesë në punimet e Kuvendit. Pra, edhe nën përgjegjësinë e kryetarit të grupit të shumicës, unë kam depozituar pranë shërbimeve të gjitha certifikatat përkatëse të vaksinimit. Po ashtu, është e vërtetë që një kolege deputete, për arsye të sugjerimit mjekësor, nuk e ka bërë vaksinën. Pra, mjekët kanë sugjeruar që vakcina ka një efekt dytësor që nuk e lejon bërjen e saj. Ndërkohë, në mos gaboj, nga ana e opozitës janë pesë apo gjashtë deputetë që nuk e kanë bërë akoma vaksinën. Ne duhet të jemi shembulli edhe për këtë çështje,

ashtu siç ju fola edhe për çështjen e pastrimit të parave, që lidhej me ligjin në fjalë.

Zonja Kryetare, të gjithë ne në këtë sallë duhet të mbajmë maskën. Në rast të kundërt, ministrja e Shëndetësisë të njoftojë shërbimin përkatës, të ngarkuar me ligj për adresimin e kësaj çështjeje dhe të gjobiten të gjithë ata që e shkelin ligjin, ministrat, deputetët e të tjerët me radhë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Besoj se do të mund ta reflektojmë këtë gjë.

Fjalën e ka zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** - Që ne jetojmë në realitete të ndryshme, kjo nuk ka asnjë diskutim.

Realiteti ku jeton sot biznesi i ndërtimit, kryesisht në Tiranë, por edhe shumë biznese të tjera në të gjitha qytetet e Shqipërisë, është ai i përgjimeve të antimafies.

“Atëherë, kam folur me mikun tim, Nik, që më ka thënë se ky tipi mori tri licenca ndërtimi në Tiranë dhe duhen 180 milionë euro. Kërkojnë financiar, më tha, e gjejnë sipërmarrësin shumë thjesht”. Ky është realiteti me të cilin përballen bizneset këtu në Tiranë sa herë trokasin në një derë shteti.

Unë e dëgjova me shumë interes ministren e Financave kur bëri prezantimin dhe replikën (kanë filluar të gjithë të përdorin të njëjtën morfologji fjalimi) dhe m'u duk sikur foli Edi Rama; po me të njëjtat fjalë, po me të njëjtën retorikë, po me të njëjtin nënvlerësim për këdo që flet ndryshe.

Është e vërtetë që jetojmë në realitete të ndryshme, sepse ne jetojmë me realitetin që 500 mijë shqiptarë janë larguar nga Shqipëria, që të paktën gjysma e atyre që sot regjistrohen si azilkërkues janë shqiptarë nën moshën 19 vjeç, që sot mbi 30% e shqiptarëve janë në pragun e varfërisë (ky është një realitet që ka nevojë për vëmendje), kurse qeveria jeton në realitetin e estetikës: “Hajde bëjmë dy ligje shumë të mirë, shumë të bukur, i përafrojmë edhe me Bashkimin Europian, sepse do të zgjidhim çdo problem që ekziston sot për pastrimin e parave”.

Pastrimi i parave, si shumë terma të tjerë, është futur në fjalorin e përditshëm të politikës pas vitit 2013, ashtu siç u përfshi edhe dekriminalizimi. Deri atëherë ne nuk kishim diskutuar për kriminelë në parlament, për grushte nëpër cepa korridoresh po nga ana e kolegëve

socialistë, për shqiptarë që largohen masivisht, për shkolla që mbyllen, për investime publike që mungojnë, për koncesione, për borxhin 100% të produktit të brendshëm bruto. Pas vitit 2013 të gjitha këto u ulën këmbëkryq në këtë parlament.

Sigurisht, sot kemi të bëjmë me një realitet të ri dhe duhet të flasim për këtë realitet të ri. Pastrimi i parave sot është njolla e zezë e turpit që ka vendosur qeveria mbi imazhin e Shqipërisë, që e përfshiu Shqipërinë në listën gri të pastrimit të parave, që e përfshin atë në çdo renditje ndërkombëtare nga Instituti i Basel-it deri te raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit dhe që ka etiketuar tre sektorë: turizmin, ndërtimin, lojërat e fatit. Pastrimi i parave është zyrtar.

Departamenti i Shtetit shkon edhe më larg. Ai thotë se pastrohen para edhe me fonde publike, me koncesione, me partneritetin publik - privat. Pjesa e investimit e atyre që janë persona jopublikë, investitorët privatë, është e gjitha për të pastruar para.

Opozita do ta kishte mirëpritur këtë ligj nëse në vazhden e tij dhe të diskutimeve do të kishim një paketë të plotë që e trajtonte këtë çështje.

Unë që e lexova ligjin, dhe e diskutuam edhe në komision, nuk arrij dot të kuptoj nëse në personat e ekspozuar politikisht, që i përcakton ligji, dhe shumë mirë bën që i përcakton, përfshihet edhe Klodian Zoto i insineratorëve, që ka pasur një biznes me një ministër sot në qeveri? A u japim zgjidhje një herë e përgjithmonë atyre që nuk kanë asnjë biznes, por bëjnë para vetëm me fonde publike? A japim me këtë ligj përgjigje për 140 leje ndërtimi në Tiranë të marra nga kompani me bilanc zero, që nuk kanë bërë asgjë në jetën e tyre, përveçse ndërtojnë, ose kompanive që nuk bëjnë asgjë përveçse marrin tendera dhe koncesione? A japim zgjidhje me këtë ligj?

A u dhamë zgjidhje kompanive offshore me ligjin që u miratua në parlament? Çfarë interesi ka kompania malteze offshore, e cila mori me koncesion terminalin në portin e Durrësit, që paguan një gjobë prej 500 mijë lekësh të rinj? Apo çfarë u ndodhi kompanive të OST-së, të cilat kanë marrë fonde publike dhe i kanë çuar paratë në offshore?

E kemi ligjin, shumë të mirë e kemi, madje edhe të përafuar, por a i jep zgjidhje çështjes së

vullnetit politik? Sepse për çështje të vullnetit politik kemi arritur deri këtu.

Në fakt, pastrimi i parave është një çështje, e cila mendoj se duhet të trajtohet me një paketë të plotë, ku të merrej parasysh edhe dëmi që po i shkaktohet sot ekonomisë. Sot, qindra, mijëra biznese janë duke u mbyllur vetëm si rezultat i pastrimit të parave. Këto biznese po dalin nga tregu si rezultat i konkurrencës së pandershme. Megjithëse ky ligj do të duket shumë bukur në listën e atyre gjërave që ne duhet të plotësojmë dhe do të vendoset një shenjë, që është plotësuar edhe ky detyrim, përsëri, në praktikë, nuk do të ndodhë asgjë, si me korrupsionin, ashtu edhe me pastrimin e parave. Sepse ka një tendencë këtu në Shqipëri, sa më shumë ligje që bëjmë aq më shumë është tendenca për të mos e luftuar fenomenin, si në rastin e pastrimit të parave. Sa më shumë institucione bëjmë për korrupsionin aq më shumë rritet korrupsioni. Sa më shumë e luftojmë vjedhjen e zgjedhjeve aq më shumë vidhen zgjedhjet.

Dëgjova ministrin kur foli edhe për sektorin e ndërtimit, edhe kur tha se kemi një rritje ekonomike, të cilën edhe FMN-ja e parashikon deri në 7,8%. Po përse ndodh kjo? Prej sektorit të ndërtimit. Nuk ka asnjë sektor tjetër që të ketë rritjen e sektorit të ndërtimit. Prej sektorit të ndërtimit dhe prej ditës së zgjedhjeve, kur u paguan rreth 120 milionë euro vetëm për rindërtimin. E gjitha kjo është një rritje që rrotullohet rreth një tremujori dhe sektorit të ndërtimit në Tiranë, joefektive, që nuk shoqërohet me nxitje dhe me zhvillim ekonomik dhe që nuk ka asnjë lidhje me realitetin, nuk ka asnjë lidhje me realitetin që përjetojnë qytetarët shqiptarë jashtë kësaj sale, pavarësisht nëse janë të majtë apo të djathtë.

Sot ekonomia shqiptare ka një problem real. Sot ekonomia shqiptare është kthyer në një ekonomi të centralizuar, është kthyer në një ekonomi që nuk prodhon asgjë, që nuk ka një model, është kthyer në një ekonomi, e cila fatkeqësisht pastron para dhe me këtë ligj nuk do të zgjidhim asgjë.

Me gjithë dashamirësinë, me gjithë sugjerimet që dhamë, me të gjitha elementet që propozuam në komision, sigurisht, si gjithmonë nuk u dëgjuam, pastaj, vijnë kolegët këtu dhe bëjnë thirrje patetike: "Hajde ta miratojmë bashkërisht"! Ne nuk kemi për ta ngritur kartonin

për çdo gjë që ju sillni këtu në Parlament, por në qoftë se doni të dëgjoni se si mund të luftohen fenomenet, se si mund ta marrim seriozisht luftën ndaj pastrimit të parave, ndaj korrupsionit, jemi të gatshëm të bëjmë propozimet tona, por këto duhet të jenë të shoqëruara me vullnetin politik, për të cilin kam humbur shpresat se ekziston. Kam humbur shpresën që ndoshta pas 9 vjetësh qeveria do të kthehet në rrugën e drejtë, të cilën nuk e mori as në vitin 2013, kur filloi qeverisjen.

Gjatë këtyre viteve kemi denoncuar një aferë shumë të rëndësishme, të cilën e përmenda edhe pak më përpara, aferën e inceneratorëve. Kjo është afëra që e u ka mbyllur gojën shumë mediave dhe shumë politikanëve këtu në Shqipëri, por fatmirësisht, jo një pjese të madhe të opozitës. Me këtë ligj, përsëri nuk i japim zgjidhje çështjes së pastrimit të parave në sektorin publik, ashtu sikurse nuk u japim zgjidhje kompanive, të cilat me bilanc zero marrin një koncesion nga sot, nesër, pa pasur asnjë lloj eksperience, asnjë ditë eksperiencë në këtë fushë. Pse? Sepse kanë mbështetje politike, sepse kanë mbrojtje politike, sepse sot Parlamenti po kthehet në një mburojë, për të krijuar një botë që nuk ekziston, jo për shqiptarët që jetojnë në varfëri, për shqiptarët që largohen, për të rinjtë që u mbyllën shkollat, apo për ata shqiptarë që sot, fatkeqësisht, nuk shohin asnjë shpresë. Sot ky Parlament po miraton ligje për estetikë, po miraton ligje që nuk e kapin dhe nuk e trajtojnë thelbin e çështjes, si dhe nuk i zgjidhin problemet më të mëdha, nuk zgjidhin korrupsionin, krimin e organizuar dhe vjedhjen e parave të buxhetit të shtetit.

Në qoftë se do të kishte një paketë të plotë ligjore për pastrimin e parave, e cila ta trajtonte çështjen duke filluar nga burimi, deri në ndjekjen e parave, si nga fondet publike, ashtu edhe të parave që janë duke u paguar në offshore me fondet publike, unë besoj se opozita do të ishte e gatshme ta votonte.

Nuk e di se çfarë do të bëjnë kolegët e mi, por vota ime për këtë ligj do të jetë kundër. Unë do të votoj kundër, për arsyen e thjeshtë, se ky ligj është vetëm estetike dhe nuk e prek thelbin e problemit, nuk prek çështjen për të cilën shqiptarët sot kanë nevojë.

Ka disa kolegë, që ndoshta edhe mund ta votojnë, zoti Balla, nuk e diskutoj. Ka disa

kolegë që edhe mund ta votojnë, por përderisa mua ky ligj nuk më sqaron nëse Klodian Zoto quhet “person i ekspozuar politikisht”, i lidhur me qeverinë, nuk e votoj dot, sepse jam duke drejtuar një komision hetimor dhe nuk kam asnjë informacion se ku kanë shkuar paratë. Nëse e zgjidhim me këtë ligj çështjen, se ku kanë shkuar paratë dhe fondet publike, atëherë do ta votoj.

Kolegët e tjerë mund ta votojnë, por në këtë moment unë deklaroj votën kundër, deri kur çështjes së pastrimit të parave t’i vendosim atë emër që meriton dhe ta trajtojmë ashtu siç e meriton.

Sot Shqipëria është etiketuar si vend në listën gri dhe lista e përfshin vendin vetëm prej pastrimit të parave, kjo vetëm prej veprimeve dhe vullnetit politik të qeverisë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Për rekord, më duhet të mbaj edhe unë një fjalim dhe pas meje do të flasë zonja Ina Zhupa.

Më pas të përgatitet ministri Manja.

Atëherë, fjalën e ka ministrja Ibrahimaj.

**Delina Ibrahimaj** - Në fakt, kam dy përgjigje.

Të parën e kam për zotin Balla. Unë marr angazhimin t’i kalojmë të gjitha aktet nënligjore që shoqërojnë këtë ligj brenda afatit të përcaktuar nga Kuvendi, pasi është detyra jonë ta bëjmë këtë dhe, në fakt, është angazhimi ynë që luftën kundër pastrimit të parave ta çojmë në një nivel tjetër dhe është detyrë e qeverisë të miratojë të gjitha aktet nënligjore.

Për sa i takon parafolësës, dua të ritheksoj që, kur flasim për fakte, kur flasim për aktualitetin dhe kur flasim për ambientin në të cilin jetojmë, duhet t’u referohemi fakteve, nuk mund t’u referohemi aludimeve.

Për sa i përket gjendjes ekonomike, dua të theksoj se në tremujorin e dytë të këtij viti ekonomia shqiptare u rrit në të gjithë sektorët e saj. Industria u rrit me rreth 40%, ndërtimi u rrit me 41%, tregtia u rrit me 31%. Pra, sektorët kryesorë që ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit u rritën në të njëjtin nivel, afërsisht me ndërtimin. Është e pavërtetë që rritja ekonomike është e bazuar vetëm te ndërtimi dhe është e pavërtetë që ndërtimi është i bazuar te paratë e pista. Janë disa institucione, të cilat punojnë për të gjurmuar këtë fenomen dhe për ta luftuar këtë

dukuri. Është angazhimi ynë që kjo dukuri të shkojë drejt reduktimit.

Për sa i përket çështjes së jetës dhe mbijetesës së emigrantëve dhe të emigracionit, të azilkërkuesve dhe joazilkërkuesve, ju sugjeroj t'u referoheni shifrave zyrtare, sepse niveli i emigracionit ka qenë dyfish më i lartë në periudhën kur keni qeverisur ju. Pra, ju lutem, t'u referoheni shifrave dhe jo perceptimeve, duke thënë që shqiptarët po largohen, se janë të pakënaqur.

Rritja e numrit të vendeve të punës në gjithë këto vite qeverisje tregon se ekonomia shqiptare po ecën, ekonomia familjare po ecën, rritja e numrit të bizneseve që operojnë në vend dhe rritja e të ardhurave të mbledhura prej tyre, tregon që bizneset po ecin në drejtimin e duhur.

Dua t'ju rikujtoj që edhe gjatë vitit të tmerrshëm 2020, kur ne pësuaam gjithë atë dëm nga pandemia, nga mbyllja, bizneset vijuan të jenë të hapura dhe numri i të punësuarve u rikuperua në fund të këtij viti. Gjithashtu, dua të ritheskoj se falë mbështetjes së politikave të qeverisë numri i bizneseve të vogla u rrit gjatë këtij viti, pasi ne mendojmë të përfshijmë, të bëjmë akte apo ligje, atje ku ka nevojë më shumë.

Për sa i përket numrit të vendeve të punës, më lejoni t'ju kujtoj që në fund të viti 2013 numri i vendeve të punës ishte 478 187, ndërkohë, sot që flasim është 653 053.

Ju lutem, referojuni shifrave!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Ndryshimet e propozuara në ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” janë ndryshime shumë të rëndësishme, që kanë lidhje jo thjesht dhe vetëm me njësimin e legjislacionit tonë me atë ndërkombëtar në këtë fushë, por me rritjen e mundësive ligjore dhe praktike, që institucioni në fjalë, i njohur si njësi jonë e inteligjencës financiare, të mund të përmbushë misionin e tij, ashtu sikundër, në fakt, e ngarkon edhe ligji, të mbrojë interesat e vendit nga krimi financiar dhe financimi i terrorizmit dhe të kontribuojë në stabilitetin, integritetin, rritjen, qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Shqipëri dhe të ekonomisë në përgjithësi, nëpërmjet zbulimit dhe goditjes së veprimtarive kriminale.

Për të rifreskuar ndoshta edhe kujtesën e dikujt këtu që mendon se pastrimi i parave është një fenomen për të cilin ne kemi folur në vitin 2013 dhe në vijim, vetë institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, është ngritur në vitin 2000, ndërkohë që si vepër penale kjo është parashikuar në Kodin tonë Penal në vitin 2003, pra ka një kohë shumë të gjatë në të cilën institucionet shqiptare përpiqen të bëjnë legjislacion dhe këtë të fundit ta përdorin në luftën kundër pastrimit të parave.

Siç e thashë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është një institucion që daton nga viti 2000. Pra, në dy dekada ky institucion është rritur, është kompletuar me legjislacion dhe, në fakt, legjislacioni është arma më e efikase në parandalimin dhe në goditjen e çdo paraje, kujtoj edhe një herë që sigurohet nëpërmjet burimeve të paligjshme.

Pastrimi i parave dhe i produkteve të krimit bashkë me financimin e terrorizmit përbëjnë vepër penale. Këto të dhëna tregojnë dinamizmin në njërin anë të këtij nukli, që sot, në fakt, bashkëpunon me mekanizma prestigjiozë ndërkombëtarë në luftën kundër riciklimit të parave dhe ndjek çdo udhëzim, çdo metodologji pune që ato ofrojnë. Fenomeni, në vetvete, në fakt, nuk është fenomen nacional, nuk është vetëm i një vendi, nuk është vetëm i Shqipërisë, përkundrazi, është fenomeni që sot kërcënon çdo ekonomi kombëtare, së bashku me financimin e terrorizmit, që është një fenomen i shfaqur më vonë në kohë. Madje, nëse do të doni të shihni se cilat janë prioritetet kryesore të dy mekanizmave kryesorë që Bashkimi Europian përdor si mekanizma, si instrumente në luftën antikorupsion, dhe e kam fjalën për FATF-in dhe MONEYVAL-in, do të shikoni se dy prioritetet kryesore të tyre janë pikërisht parandalimi i parasë së pistë, goditja e saj dhe e financimit të terrorizmit.

E bëra këtë parantezë për faktin se rëndom në Kuvend nuk diskutohet për ligjin, për atë çfarë ne kemi si detyrim të ofrojmë në fund të ditës si të zgjedhur që jemi, si ligjvënës, por me një lloj kompetence të pakompetentë, ngrihen diskutime dhe analiza, si dhe mbërrihet në përfundime, të cilat kanë vetëm një të përbashkët: nxirjen, mohimin, fshirjen e çdo përpjekjeje pozitive, sado të vogël, në luftën



kundër një fenomeni kriminal që ligji, në fakt, e ndëshkon pa asnjë tolerancë, sepse e dënon vetëm me burgim.

Kjo, kolegë, nuk është të inkurajosh luftën kundër krimit, nuk është as edhe kritikë, sepse minimalisht kritika do të duhej të paraprihej nga ballafaqimi, pastaj nga propozimi për ta shkruar ligjin më mirë, për ta qasur në mënyrë identike me atë çfarë na sugjerojnë sot institucionet e ekspertizës. Unë mendoj se është thjesht dashakeqësi e mbushur me mlllef ndaj çdokujt që punon dhe synon të rrisë performancën e vet të punës, duke kontribuar kështu drejtpërsëdrejti në goditjen e kujtdo që tenton të fusë në ekonominë e ligjshme atë të ardhur që rrjedh nga krimi dhe godet kështu çdo biznes të ndershëm, që, në fakt, kërkon të veprojë sipas ligjit për t'i dhënë Çezarit, dhe në këtë rast fjala është për shtetin, atë që i takon dhe që natyrisht është e shtetit dhe duhet të jetë e shtetit.

Besoj që, kur shqiptarëve u flitet për pastrimin e parave dhe për historinë e lindjes së këtij fenomeni në vendin tonë, nuk ka se si të mos u kujtohen vitet e rrumpallës që përkojnë pikë për pikë me vitet tuaja të qeverisjes; nuk ka se si të mos u kujtohet, për shembull, që ai që del sot nga “foltorja”, ishte personi që futi dhe bekoj piramidat. A e dini se piramidat janë lavatriçet më të mëdha ndonjëherë të pastrimit të parave në këtë vend, në vendin tonë, Shqipëri?

Nuk munden shqiptarët, po ashtu, të harrojnë trarët e shqyer të doganave, ndërtimet që mbinë si kërpudhat pas shiut në çdo hapësirë publike, nga Veriu në Jug, shfrytëzimin barbar jo vetëm të territorit, por edhe të çdo burimi jetik tonit, trafiqet e njerëzve nga deti dhe nga toka, trafikun e armëve, kontrabandën e naftës dhe të mallrave të tjera e sa e sa vepra të ngjashme, gropa këto të mëdha në jetën tonë shoqërore dhe ekonomike që çuan në lulëzimin e parasë së pistë. E kjo në mungesë të çfarë? Të ligjit, të rregullit, që parandalon, godet dhe nuk lejon që ekonomia jonë të vritet pa fund dhe të rrëzohet përtokë.

Nëse ka një llogari për t'u kërkuar në këtë mes, se si kemi luftuar kundër parasë së pistë, kjo llogari fillon nga këtu, nga parlamenti, duke e pyetur veten: ç'bëmë ne dhe ç'bëtë ju, ata që ishin dhe ata që nuk janë, edhe ata që duket sikur kanë ardhur me galopin e kalorësit antikorrupsion në këtë Kuvend?

Po e nis nga më baziket, ndërtimet, dhe po i marr të gjitha bashkë, me leje dhe pa leje, sepse besoj që biem dakord që edhe te ndërtimet pa leje (dhe nuk flas për ato ndërtime që janë banesa individuale apo njësi individuale) në shumicën e tyre kanë qenë dhe janë fryt i parasë së paligjshme.

Ne vendosëm rregull në aplikimin për lejet e ndërtimit, vendosëm aplikimin *online* për të evituar tarifën e korrupsionit. Viojmë ende që nga viti 2014 me reformën e ndërtimeve pa leje.

Së fundi, unë, në fakt, dua ta përhëndes kolegun tim, ministrin e Drejtësisë, zotin Manja, që Drejtoria Antikorrupsion po bën fokus të punës së saj edhe lejet e ndërtimit të dhëna nga çdo bashki.

Po ju, ku jeni ju në gjithë këtë? Askund. E keni sharë, e keni mohuar. Një herë të vetme nuk kam dëgjuar dikë që të thotë: “Po, është gjëja e duhur”. Është e vështirë, patjetër, që po, mund të bëhen edhe gabime, por është e vështirë të zhbësh 30 vjet me një të rënë të lapsit.

Pra, nëse sot ky sektor për të cilin po flasim, sektori i ndërtimit, çmohet si sektori më me risk për pastrimin e parave, bujrem, si e kontrollojmë më mirë ne këtë? Si e kontrollojmë territorin? Si e kontrollojmë më mirë dhënien e lejeve të ndërtimit? Si i bëjmë ne më të përgjegjshëm kryetarët e bashkive dhe çdo instancë tjetër që e ka për detyrë, në fakt, të ndjekë zbatimin korrekt të lejeve të ndërtimit? Kjo nuk do të thotë, në fakt, ta bësh situatën rozë, aq më pak nuk do të thotë ta bësh edhe zi, se po bashkëpunon me socialistët, por të kontribuosh si i zgjedhur dhe përfaqësues i forcës sate politike, për këtë vend dhe për këtë popull.

Unë nuk mund të rri, në fakt, pa e thënë zhgënjimin që kam ndier në Komisionin e Ligjeve kur dikush nga deputetët e këtij komisioni u shpreh: “Si resto nga ana jonë do të jetë arroganca”. Imajino ta mendosh dhe ta thuash këtë gjë pa qenë në pushtet, se ç'ndodh nesër nëse verbërisht, lehtësisht, i hapet rrugë një individi të tillë në Kuvendin e Shqipërisë.

Ndërkohë që disa fjalën “e madhe” e peshojnë po aq sa mendjen, mua më vjen mirë të them që në këto vite qeverisjeje tonën, për sa i takon luftës kundër pastrimit të parave nuk jemi mjaftuar thjesht me udhëzime, me binjakëzime, me aktivitete të tjera dytësore, por kemi punuar

fort me ligjin që, sikundër e thashë, ngelet arma më e efektshme në dispozicion.

Ligjet “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare”, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, “Për regjistrin e pronarëve përfitues” dhe projekte të tjera, ndër të cilat ne e kemi miratuar një së fundi, si ligji për regjistrin e të gjitha OJF-ve, projektligji “Për licencimin e ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme” së bashku me disa rregullime që ne duam të fusim në ligjin “Për noterët”, të gjitha këto së bashku, në fakt, do të formësojnë një legjislacion, që pa dyshim nuk ka se si të mos e shprehë efektivitetin e vet, duke bërë që Shqipëria të konsiderohet realisht në terma afatgjatë një vend ku klima për të bërë biznes është e sigurt.

Lufta kundër parasë së pistë do të duhet të biem dakord, zhvillohet në disa fronte, madje Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave është komplementare me luftën që bën organi i ndjekjes penale, sepse luftohet vepra penale nga e cila përfitohet e ardhura që pastaj futet në ekonominë e ligjshme.

Ne, në fakt, këtë kemi kërkuar, që, kur goditet korrupsioni, goditet para e pistë. Këtë gjë bëmë edhe me reformën në drejtësi, për të cilën prapë kemi rast t’ju themi: do të doni të renditeni pro apo kundër? Kur goditet informaliteti, goditet njëkohësisht edhe para e pistë. Ne këtë po bëjmë me fiskalizimin.

Në këtë betejë që për DPP-në është më së shumti teknike, por edhe ligjore, ne kontribuojmë duke ushtruar detyrat tona. Unë mendoj që ne mund t’i qasemi më mirë kësaj çështjeje nëse u vëmë më shumë vesh të gjitha raportimeve që ne marrim nga burime të ndryshme, nëse i lidhim dhe i krahasojmë, por kjo gjë, fatkeqësisht, nuk ka ndodhur në Kuvendin e Shqipërisë.

*(Bie gongu.)*

Realisht është një pikë që unë do të dëshiroja me zemër që gjërat të ndryshojnë në Kuvendin e Shqipërisë, duke mos ngelur më në politikën e vjetër të baltës. Kjo është një shenjë që këtij vendi dhe këtij Kuvendi duhet t’i lëmë një brez të rinj politikanësh dhe intelektualësh; të kërkojmë të jemi të dobishëm më shumë sesa të kërkojmë të dukemi të rëndësishëm. Kjo është ajo që unë mendoj për këtë çështje.

Faleminderit!

*(Zonja Felaj kthehet në drejtimin e seancës.)*

Fjala është për zonjën Zhupa.

**Ina Zhupa** – Në fakt, këtë maxhorancë unë e kam ndarë në tri kategori: patronazhistë, pasionarë e pasionare dhe kategoria e tretë pastërtorë dhe shkurt, siç ju pëlqen edhe juve, jeni PPP.

Në kategorinë e parë të patronazhistëve kemi spiunin modern nën shembullin e partisë-shtet, për të cilën kemi aq shumë nostalgji, modelin që ju adhuron mënyrën se si ju doni të sundojë ligji në këtë vend, ku diktatori i radhës është vetë zot dhe vetë shkop.

Kategorinë e dytë pasionarë dhe pasionare e kam klasifikuar, duke u nisur nga një personazh, të cilin ju, ndoshta, e mbani mend, i luajtur me mjeshtëri në “Portokalli” nga Mariana Kondi, e cila quhej “pasionare llapa”. Pasionaret dhe pasionarët e kësaj mazhorance vijnë këtu e flasin për qeverisjen më të mirë, për arritjet që nuk i ka parë historia, për zhvillim, për pastrim parash, për ligje të mrekullueshme, faleminderit qeverisë, faleminderit ministres, dhe, ndoshta, është kategoria më e parrezikshme, por edhe më e pëshitra.

Kategoria e tretë janë ata që unë i kam quajtur pastërtorët; janë pikërisht ata që japin bekimin për të pastruar paratë e pista në këtë vend; janë ata që bëjnë korrupsionin më të madh; janë ata pastërtorët, peshqit e mëdhenj; janë të njëjtët peshq që sot na kanë sjellë ligjin në parlament; janë ata peshq që sot duhej të ishin subjekt i këtij ligji. Ligji nuk do të kishte kuptim nëse ata, që japin garancinë, ata që janë mjeshtër e pastrimit të parave të pista në Shqipëri, nuk janë subjekt hetimi i ligjit. Shqipëria është në listën gri të pastrimit të parave, ndërkohë që kishte dalë nga kjo listë, por, falë punës suaj të palodhur për të pastruar paratë e pista, u futëm përsëri në këtë listë. Kjo është një arritje juaja, të cilën ne nuk mund t’jua mohojmë, por arritje të tilla u bëjnë dëm vetëm Shqipërisë dhe shqiptareve.

Raporti MONEYVAL i Këshillit të Europës shkruan: “Korrupsioni paraqet rreziqe të mëdha të pastrimit të parave në Shqipëri, i lidhur shpesh me aktivitete të krimit të organizuar, ai generon sasi të konsiderueshme të të ardhurave kriminale dhe, seriozisht, dëmton funksionimin

efektiv të sistemit të drejtësisë penale”; këtë e thotë raporti i Këshillit të Europës dhe nuk e themi ne.

Por pyetja është: kush e bën korrupsionin? A bëhet dot korrupsion i madh pa përfshirë zyrtaret e shtetit, pa dhënë lejet këta, pa dhënë koncesionet këta; pa dhënë PPP-të këta?! Ja, pra, kuptohet fare qartë, mjafton të lexosh raportin se ku është burimi dhe ku duhet ta kërkojmë fajtorin për pastrimin e parave të pista.

Sipas FATF-së, ne jemi në grup me këto vende (dhe unë do të lexoj, për të gjithë ata që nuk e dinë se ku është Shqipëria, se me cilat vende krahasohet për standardet e pastrimit të parave): me Barabdosin; Burginafasin; Kamboxhian; Ishujt Kajman; Haitin; Xhamajkën; Jordaninë; Malin; Maltën; Marokun; Mia Maren; Nikaraguan; Pakistanin; Panamanë; Filipinen; Senegalin; Sudanin; Ugandën; Jemenin dhe Zimbabvenë. Kjo është kategoria që jemi ne (lista); kategoria me cilën është Shqipëria. Po çfarë e lidh Shqipërinë me këto vende? Çfarë të përbashkëta ka? Asgjë nuk ka nga gjeografia; asgjë nuk ka nga tradita; asgjë nuk ka nga aspiratat të saj për t’u bërë shtet anëtar i Bashkimit Europian, por ka një gjë të përbashkët: ka një udhëheqësi tribale që qeveris me standarde afrikane dhe jo me standardet europiane. Kjo na bën ne bashkë me këto vende, ndaj jemi në të njëjtin raport dhe jemi të detyruar sot që t’i votojmë ligje të tilla; i votojmë ligjet, nuk është problem, por problem është se kush do t’i zbatojë këto ligje?! Ja, e bëme edhe një *check* në listën e detyrimeve që na kanë vendosur, mirëpo ata që duhet ta luftojnë, ata e bëjnë procesin.

Ligjin unë do ta votoj pro, megjithatë kush do ta zbatojë?!

Ne shquheni për injorimin, shkeljen dhe moszbatimin e ligjit, dhe unë do të ju sjell një rast konkret. Si deputete e qarkut të Vlorës, po ju them se jeni duke bërë një krim të madh me të ashtuquajturin aeroportin e Vlorës! Nëse e keni seriozisht, duhet ta bëni aeroportin, por në përputhje me ligjin dhe për të mirën e Vlorës dhe të Shqipërisë.

Leja e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit më 24 nëntor ishte e kundërligjshme, pasi për projektin ende nuk kishte një studim të miratuar mjedisi dhe nuk janë marrë parasysh

konventat ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria bën pjesë.

Në progresraportin e Komisionit Europian shkruhet për aeroportin në zonën “Vjosë-Nartë” se është në konflikt me ligjet kombëtare dhe konventat ndërkombëtare të mbrojtjes së larmshmërisë biologjike, të cilat Shqipëria i ka ratifikuar. Ja, pra, ligjet i keni, por ju nuk i zbatoni, por ju i shkelni dhe i shkelni me vendimet tuaja. Në fakt, aeroporti i Vlorës nuk ka projekt. Aeroporti i Vlorës nuk ka studim dhe, mbi të gjitha, nuk ka para për t’u ndërtuar, duhen rreth 138 milionë euro. Ku janë këto para? Ku i keni kërkuar?! Pra, nuk keni asgjë! Më 28 nëntor ju inauguruat vetëm shkatërrimin e mjedisit; inauguruat vetëm shkatërrimin e zonave të mbrojtura; inauguruat vetëm shkeljen e ligjit dhe asgjë që lidhet realisht me aeroportin e Vlorës. Arroganca e këtij pushteti vjen këtu e na tregon se si të votojmë ligje për pastrimin e parave, kur, në fakt, “Maliqi” këtu mbrapa nuk pyet fare.

Janë 37 organizata mjedisore, të cilat ju kanë dërguar raporte të sakta pse nuk duhet ta bëni aeroportin atje, sepse jo vetëm e shkatërroni atë mjedis, shkelni ligjet, por është e rrezikshme nëse zgjidhni atë zonë dhe në qoftë se e bëni aty me kokëfortësinë tuaj, sepse të gjithë shpendët rrezikojnë që të futen edhe në motorët e çartërave, të avionëve që do të zbresin atje. Por nuk ka rëndësi, sepse tragjeditë ndodhin, bëhen edhe filma, do të thoni ju, edhe këtë do ta kaloni. Edhe po ndodhi ndonjë gjë, e rëndësishme është që ju të bëni atë që keni menduar për të bërë.

Kështu nuk qeveriset, kështu jeni duke shkatërruar vendin, jeni duke masakruar shqiptarët, jeni duke bërë turpet më të mëdha në histori me gjoja dëshirën për të investuar, me gjoja propagandën për të investuar. Ndaj, përpara se ne këtu sot dhe çdo ditë të diskutojmë për ligje të mira, për përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian, të bëjmë një *check* në listën e detyrimeve që na vendosin nga ana ligjore, se ne duhet të jemi garantët që ato, që ne shkruajmë dhe për të cilat ngremë dorën apo japim votën tonë pro, të mund të zbatohen dhe të vihen në zbatim për të mirën e qytetarëve shqiptarë dhe jo thjesht të jenë letra për të mbushur sirtarët e ministrive, për të mbushur sirtarët e zyrave të shtetit.

Meqenëse folët këtu për lejet e ndërtimit dhe për shkurtime të letrave, vetëm futja e dokumenteve është *online*, më pas çdo gjë tjetër nuk ka lidhje fare me procesin *online*, dhe ju e dini mirë se si bëhet.

Sot kemi rastin, dhe ju kërkoj edhe juve që jeni prezentë, të tërhiqeni nga masakra që jeni duke parashikuar për aeroportin e Vlorës, si një shenjë që ju ligjet që bëni doni t'i zbatoni.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Dua t'ju kujtoj gjithmonë, në respekt të Kodit të Etikës dhe sjelljes në këtë Kuvend, që fjalë dhe shprehje të pahijshme, edhe pse përdoren në spektakle humori, nuk mund të përdoren në Kuvendin e Shqipërisë. Do të ishte në nderin tuaj, si grua dhe si zonjë, që të mos i kundërdrejtoheni asnjë gruaje dhe asnjë zonje brenda kësaj sale dhe as jashtë kësaj sale në të gjitha anët me fjalët që përdorët pak më parë në fjalimin tuaj.

Fjala për ministrin Manja.

**Ulsi Manja** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, unë nuk e di se, sipas ndarjes që bëri kolegja paraardhëse e opozitës, te cili grup jam, te “Pasionari” apo te “Pasionarja llapa”! Zonjë e nderuar, zgjohu nga gjumi, sepse më 25 prill të 2021-shit qytetarët e kanë ndarë se kush do të merret me punë dhe me përgjegjësi para qytetarëve dhe se kush do të llopë. Nëse e keni fjalën për të ndarë se kush do të llopë në foltoren e Kuvendit dhe se kush do të llopë te foltorja tjetër, kjo është puna juaj, këtë nuk jua zgjidhim dot ne.

Të nderuar kolegë,

Nëse fokusi i diskutimit të sotëm është ligji dhe niveli i zbatimit të ligjit nga institucionet shqiptare, janë dy gjëra krejt të ndryshme, por, nëse keni shqetësime për nivelin e zbatimit të ligjeve që ka ky vend nga institucionet shqiptare apo nga agjencitë tona shtetërore, po, e pranojmë këtë diskutim në një seancë tjetër dhe, po të doni, të posaçme, sepse parlamenti i ka të gjitha instrumentet dhe mekanizmat e duhur të kontrollit dhe monitorimit parlamentar për të kontrolluar nivelin e zbatimit të ligjeve që ne miratojmë në këtë parlament, ndërsa miratimi i ligjeve është tërësisht atribut i këtij parlamenti.

Meqenëse sot jemi te një projektligj shumë i rëndësishëm, çështja duhet ndarë: a jeni pro miratimit të këtij ligji apo keni probleme me nivelin e zbatimit të këtij ligji, sepse ky ligj është në fuqi. Ne sot kemi sjellë në Kuvend disa shtesa dhe ndryshime në këtë ligj, që burojnë nga rekomandimet e mekanizmave europiane dhe ndërkombëtare, ku qeveria shqiptare ka marrë angazhime dhe janë detyrime që duhen përmbushur në kuadër të integritimit. Njëri nga këto projektligje, ku ne kemi angazhime ndërkombëtare, është projektligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar. Kjo vjen si paketë ndryshimesh në korpusin e ligjeve tona, të cilat janë ekzaktësisht rekomandime të MONEYVAL-it dhe FATF-së.

Ky ligj, ligji për agjentët imobiliarë, që do të vijë shumë shpjet në parlament, si dhe ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për noterinë”, së bashku me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” janë një paketë ndryshimesh ligjore, që ne i kemi sjellë në këtë Kuvend në përmbushje të rekomandimeve të MONEYVAL-it dhe FATF-së, sepse jemi vend anëtar i Këshillit të Europës dhe kemi detyrime për të përmbushur në rrugën tonë drejt integritimit.

I gjithë fokusi i diskutimeve këtu nga kolegët e opozitës, shkon nga shkon, në fund është: “Pranoni vetingun në politikë, sepse kjo është zgjidhja”. Duhet të jemi të qartë, sepse edhe ligjin e noterisë e kanë marrë si veting të noterëve. E dëgjova kryetarin e opozitës kur tha: “Tani që pranuat edhe vetingun e noterëve, o burra, pranoni propozimin tonë për vetimin e politikanëve”. Jo, more jo, ndryshimet e ligjit “Për noterinë” janë rekomandime të MONEYVAL-it dhe FATF-së, që kanë të bëjnë pikërisht me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Janë filtra në këtë drejtim dhe s'kanë lidhje me vetimin e noterëve. Ligji “Për noterinë” është një ligj i ri, është bërë me asistencën më të mirë të ekspertëve të Bashkimit Europian dhe është në fuqi.

Gjithkund shohin veting. Të bëhen propozime në këtë sallë në funksion të nevojave politike të ditës, të cilat bien ndesh me konceptet dhe parimet e shtetit të së drejtës, pasi ne kemi votuar reformën në drejtësi, e cila është një reformë që po jep rezultatet e veta konkrete, nuk

janë zgjidhje, por ngatërresa e radhës, që nuk i shërben askujt.

Të kalojmë te ligji i sotëm. Ndërmarrja e nismës për propozimin e një pakete të madhe me ndryshime ligjore, në të cilën përfshihet edhe ky projektligj, është treguesi i vullnetit politik të kësaj qeverie dhe të kësaj maxhorance, sepse Shqipëria nuk mund të jetë kurrsesi një vend, ku mund të kryhen veprimtari të paligjshme të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Me forcimin e këtij kuadri rregullator në këtë fushë ne u japim të gjitha instrumentet e duhura shesë organeve tona ligjzbatuese që të parandalojnë dhe të ndjekin penalisht çdo person që përshihet në këtë aktivitet të paligjshëm.

Nga ana tjetër, ne garantojmë çdo operator të tregut, qoftë bankë ose institucion tjetër financiar, sepse me këto rregullime qartësohen përfundimisht dhe ngushtohen hapësirat për transaksione të dyshimta ligjore.

Miratimi i këtij ligji përmbush një detyrim për të përafuar të drejtën e BE-së në këtë fushë dhe tregon edhe një herë gatishmërinë tonë dhe të qeverisë për të përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga integrimi, sepse ne jemi edhe në një moment, ku presim të fillojnë negociatat me BE-në dhe, siç e dini, kapitulli XXIII dhe kriteri politik janë kapitulli i parë i negociatave që do të hapen me Bashkimin Europian dhe që mbyllet i fundit.

Ndryshimet e propozuara zvogëlojnë në maksimum rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit. Gjithashtu, ndryshimet kanë në fokus parandalimin e hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarive kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë, ose zbulimin dhe raportimin e tyre, duke e lidhur këtë edhe me zbulimin dhe goditjen e kërcënimeve për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Një kategori të caktuar profesionesh të lira ligji e ka ngarkuar me detyrime specifike, duke marrë në konsideratë standardet e MONEYVAL-it dhe FATF-së, por edhe natyrën e punës që këto profesione bëjnë.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme që ky projektligj bën është ai i zgjerimit të rrethit të personave të ekspozuar politikisht. Tashmë, në kufizimet dhe detyrimet që vendosen ndaj këtyre

personave, shtohen edhe kategori të reja të subjekteve, duke përmbushur jo vetëm një detyrim që buronte nga direktiva, por, njëkohësisht, duke qenë shembulli më i mirë i vullnetit të palëkundur për të luftuar këtë fenomen, pavarësisht se ku shfaqet, si dhe pavarësisht me sa pushtet ekonomik ose politik do të jenë këto subjekte.

Në përmbyllje, ritheksoj edhe një herë se miratimi i këtij projektligji, nëpërmjet zbulimit dhe goditjes së veprimtarive kriminale, ka një rëndësi të posaçme në mbrojtjen e interesave të vendit nga krimi financiar dhe financimi i terrorizmit, si dhe kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin, integritetin, rritjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Shqipëri dhe të ekonomisë në përgjithësi. Për më tepër, miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara në këtë projektligj do të mundësojë nxjerrjen e Shqipërisë në një kohë sa më të shpejtë nga lista e vendeve “nën monitorim të shtuar”, si dhe plotësimin e standardeve për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor me *aquis* të BE-së.

Edhe një herë, të nderuar kolegë, ju ftoj ta votojmë së bashku këtë projektligj, sepse ky projektligj dhe ndryshimet që propozohen janë përmbushje e detyrimeve që kemi në kuadër të procesit të integritimit në BE.

Me sa di unë, qasja juaj për negociatat dhe integrimin tonë në BE ka qenë pozitive, sepse keni deklaruar që sa herë do të kemi projektligje në këtë sallë, që kanë lidhje me integrimin, do të jepni votën tuaj pro. Unë shpresoj që sot ju ta bashkoni votën me ne për t'i miratuar këto ndryshime, të cilat duhet të hyjnë në fuqi një orë e më parë, në mënyrë që agjencitë tona ligjzbatuese të kenë shtesë në dorë edhe një instrument për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Për të tjerat kemi kohë, do të flasim pas 4 vjetësh, kur të vijmë zgjedhjet e radhës.

Edhe një herë faleminderit! Jam i bindur që zonjën Zhupa nuk e konkurrojmë të gjërat e artit, të kulturës dhe të recitimit të poezive, gjithsesi ajo tani ka radhën e për diskutim!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për zonjën Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, zonja Felaj!

Tani, që ta sqarojmë, se kemi dhe Kryeministrin artist dhe mendova se duke pasur Kryeministrin artist duhet të keni dhe ju një qasje artistike, “Pasionare llapa” ka qenë personazh i spektaklit “Portokalli” dhe është interpretuar nga Marjana Kondi. Ju ftoj ta shikoni, e keni dhe në *Youtube*. Është shumë e ngjashme dhe mund t’ju duket vetja sikur po dëgjoni fjalimet e disa kolegëve dhe kolegeve këtu, por ky nuk është faji i personazhit. Gjejini fajin diku tjetër.

Zoti Manja ka shumë të drejtë kur flet për standardet e Bashkimit Europian, por unë ju citova që ne jemi duke arritur standardet e Bashkimit Afrikan, pra jemi “më nalt”, siç do të thoshte zoti Manja në disa përgjime telefonike.

Sa i përket vetingut në politikë, është shumë e vërtetë, ne e kërkojmë, do ta kërkojmë edhe nga vetja jonë, në radhë të parë, sepse mendojmë dhe jemi të bindur se në ato karrige atje janë ulur njerëz që merren të parët me pastrimin e parave, të cilët janë të lidhur me botën e kimit. Ju mund të demonstroi që nuk keni frikë duke e votuar dhe duke e pranuar paketën tonë për vetingun në politikë. Tregojeni këtë dhe hajdeni më pas të diskutojmë edhe për të gjitha masat e tjera për të cilat ka nevojë një shtet ligjor.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** - Në fakt, nuk kam replikë për sa tha kolegja e opozitës, por meqenëse përmendi punën e përgjimeve, unë e kam thënë disa herë në këtë sallë, por ti je deputete rishtarë dhe nuk besoj se ke pasur rastin ta dëgjosh deklaratën time, që ndryshe nga kryetari juaj, ky që keni tani, i radhës, i cili heziton të shkojë para autoriteteve të drejtësisë dhe të japë shpjegime për shumë gjëra, kam qenë dhe jam i gatshëm të paraqitem para çdo autoriteti të drejtësisë në vend, por dhe jashtë Shqipërisë, sepse raporti im me të vërtetën dhe me ligjin lidhet me formimin tim, zonjë. Kështu që ti mund t’i përmendësh sa herë të duash ato, ti dhe shumë të tjerë këtu, që fshihen pas gishtit, por Ulsi Manja, si prokuror, si deputet dhe si ministër Drejtësie as nuk ka firmosur dhe as nuk ka për të firmosur kurrë nxjerrje banditësh nga burgjet e sigurisë së lartë në funksion të proceseve elektorale si në vitin 2009, për të bërë rrush e kumbulla votën e lirë dhe demokracinë në këtë vend, dhe as nuk ka për të dhënë licenca noterësh, prapa të cilave fshihen

interesa okulte dhe që sot janë turpi i shërbimit të noterisë në Shqipëri. Kështu që, kur të më drejtosh gishtin herë të tjera, interesohu pak se kush është Ulsi Manja!

**Ermonela Felaj** – Zoti Leskaj, ju lutem, për çfarë e kërkonti fjalën?

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Për procedurë ose për replikë, por për këtë të fundit nuk është rasti. Nëse keni diçka për procedurë, patjetër.

**Ulsi Manja** – Zonja Nënkrjetare, meqenëse kolegu Spaho përmendi fjalën “tërmet”, e ftoj ta përmendësh shumë herë atë fjalë të “foltorja”, se është fjalë e mirë. Më beso, të shërben të “foltorja”!

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegë! Ndërhyrja ishte për të respektuar Kodin e Sjelljes dhe të Etikës. Të respektosh Kodin e Sjelljes dhe të Etikës nuk është diskrecionale, sepse e kemi miratuar në këtë vend, është detyruese. Atë çfarë unë i drejtova zonjës Zhupa për fjalën që përmendi, shpresoj ta kuptojë drejt, që sjellje dhe fjalë të pahijshme nuk mund të bëhen në Kuvendin e Shqipërisë, pavarësisht se diku tjetër ato janë krejt të natyrshme dhe mund të përcillen me lehtësi; e para.

E dyta, zonjë, në qoftë se ju mendoni se roli i deputetit duhet të degradojë me sjelljen e personazheve të spektakleve të humorit, bëjeni, për ne nuk ka asnjë problem. Dakord? Në qoftë se ju mendoni se roli juaj si deputete është ky, bëjeni, nuk ka problem për askënd. Thjesht tërheqja e vëmendjes ishte sa miqësore, aq dhe në respekt të Kodit të Etikës, të cilin ata që drejtojnë seancat janë të detyruar t’ua kujtojnë të gjithë kolegëve.

Fjala është për zotin Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Zonja Nënkrjetare...

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegu Leskaj e ka kërkuar fjalën para jush dhe e ka kërkuar për procedurë! Tani, më thoni, si mund të drejtoj në këto kushte, kur ju ngriheni tre veta njëherazi?!

Fjala është për zotin Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Kërkimi i fjalës për procedurë ka të bëjë me korrektesën që duhet të tregojmë në shifra apo në përcaktimet që bëjmë. Në veçanti, kam një vërejtje për deputetët dhe përfaqësuesit e maxhorancës. Ju bëni krahasime me vitin e mbrapshtë ’97 dhe më kujtoni diktaturën, që i bënte krahasimet me vitet ’38-

'39. Në rast se doni të jeni korrektë, duhet t'u thoni shqiptarëve që në vitet 2012 dhe 2013, pra në vitet kur ishte në pushtet qeveria "Berisha", Shqipëria renditej në vendin e 90 dhe 96, me 5,48 pikë në 2012-n dhe 5,43 pikë në 2013-n, në një kohë kur Shtetet e Bashkuara ishin në pozicionin e 97 dhe 102, pra ishim në këtë grup.

Në këta 10 vjet, fakti që indeksi i Bazelit ju rendit në pozicionin nr. 39, me 5,72 pikë, tregon që ne kemi shkuar prapa dhe jo para, zonja drejtuese e seancës. Shifrat janë kokëforte. Për më tepër, treguesit, indikatorët e institucioneve të specializuara ndërkombëtare duhet të na bëjnë të jemi më të kujdesshëm dhe më të përgjegjshëm kur të deklarojmë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Zoti Spaho, keni fjalën.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Po jua them juve, që t'ia përcillni Ulsit, sepse Ulsi është nga ata që hedh gurin e fsheh dorën dhe ikën, se deri aty e ka burrrinë. Unë e kam quajtur "foltoren" tërmet dhe nuk kam frikë ta them edhe këtu, pavarësisht se jam në pjesën e grupit tim, dhe do të vazhdoj ta quaj të tillë. Me gojë dhe me shkrim e kam quajtur kështu dhe nuk ka nevojë të më japë këshilla Ulsi.

Ulsi të kujdesit për atë që i ka dalë në dosjen e Dibrës, për të cilën vazhdon akoma gjyqi, për vjedhjen e votave, kur edhe sot është zhvilluar një seancë gjyqësore, ku drejtori i policisë fliste me Ulsin për vjedhje votash dhe ky i thoshte: "Do të të ngremë në përgjegjësi. Pse vetëm në Bulqizë e paske synimin ti?! Ne do të ngremë sipër ty, me aq shumë vota sa po vjedh". Ato trimëritë, që nuk ka firmosur e të tjera, të shkojë t'ia tregojë dikujt tjetër, se, po të kishte shtet këtu, ai nuk do të ishte sot ministër Drejtësie.

**Ermonela Felaj** – Viojmë seancën.

Fjala është për zotin Salianji. Të përgatiten zoti Braçe dhe zoti Spaho.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Zonjë, nuk ka replikë mbi replikë, të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Zoti Spaho, ju lutem, mos flisni nga vendi!

Fjala është për zotin Salianji.

Zoti Salianji, vijojeni fjalën, ju lutem!

**Ervin Salianji** – Tani, ka një diferencë ndërmjet asaj që flasin përfaqësuesit e qeverisë dhe asaj që keni sjellë ju si qeveri.

Nga njëra anë, thoni që këtu nuk ekzistojnë problematikat që ngre opozita në lidhje me pastrimin e parave, në lidhje me kthimin e Shqipërisë dhe kryesisht të Tiranës në një lavatriçe të pastrimit të parave dhe, nga ana tjetër, keni propozuar dhe keni sjellë një ligj, i cili ashpëson masat, vendos më shumë persona në monitorim, jo persona dosido, por si ata që ne i denoncojmë pothuajse përditë dhe që çdo deputet i opozitës i ka përmendur edhe këtu, pra personat e ekspozuar politikisht. Ka një problematikë të madhe me personat e ekspozuar politikisht, të cilët janë të përfshirë në pastrim parash dhe ju të detyruar keni sjellë një ligj, për të cilin, për arsye se vjen edhe si rekomandim, për shkak të përfshirjes së Shqipërisë në listën gri, do të votojmë pro, pavarësisht qëndrimeve personale që mund të ketë secili prej kolegëve brenda grupit parlamentar. Do të votojmë pro, jo se besojmë se ju keni vullnet politik për ta zbatuar, jo se besojmë se ky ligj ka munguar për të luftuar dhe për të parandaluar pastrimin e parave në këtë vend, por për t'ju hequr edhe një instrument propagande, që ju do ta përdorni, që "këta kanë ndonjë merak"! I vetmi merak që kemi ne është zbatimi i ligjit dhe çuarja para përgjegjësisë e cilitdo që përfshihet në këtë veprimtari.

U tha nga përfaqësuesit e qeverisë, në komisione, u tha edhe këtu nga ministrja hyrja në listën gri, sikur të jetë arritje e madhe. Pra, Shqipëria ka hyrë në listën gri dhe njerëzit që e dëgjojnë, të cilët pyesin se çfarë është kjo listë gri, u duket sikur është ndonjë arritje. Shqipëria, për shkak të përfshirjes në veprimtarinë e pastrimit të parave në mënyrë masive, ka rënë shkallë të caktuar duke u vendosur nën monitorim të shtuar. Pra, futja në listën gri është për zi, jo për bardhë, kjo nuk është për t'u mbrojtur dhe as për t'u mburrur.

Të njëjtën gjë tha edhe zëvendësministrja në komision. Ne themi se problematikat kryesore janë te ndërtimi, ndërsa ministrja thotë që ndërtimi sjell zhvillim; ndërkohë drejtori i Parandalimit të Pastrimit të Parave, kjo nuk është meme, e ka thënë realisht se ndërtime ka edhe në Nju Jork, edhe në Londër në dijeninë time, atje ka pasur bum ndërtimesh këto kohë. Pra, si Nju Jorku, si Londra dhe si Tirana, që nuk ka mundësi, janë në të njëjtin rang, sipas qeverisë.

Ajo që duhet thënë, për të cilën secili prej përfaqësuesve të qeverisë që del e mbron duhet të mbajë përgjegjësi, është pse ka pasur mungesë efektiviteti deri më sot, me ligjin qenë ekzistues, në luftën ndaj pastrimit të parave?

Vetëm brenda një viti janë pastruar 1,6 miliardë euro dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë tha se janë konfiskuar 31 milionë euro. Shikojeni pak raportin mes luftës që bëhet dhe parave të pista që pastrohen në këtë vend: 1,6 miliardë, sipas raporteve, 31 milionë euro, të cilat do t'i shohim kur të shkojnë në gjykata, se edhe OFL-ja u përdor si një instrument për të përfshirë të gjithë lllumin e krimit në veprimtari, për të grumbulluar vota për Partinë Socialiste.

Dalja nga lista gri, na u tha këtu nga përfaqësuesja e qeverisë, do të mjaftojë po të përfshihen tre elemente: bazën ligjore, pajisjen dhe burimet njerëzore, a thua se Shqipëria po krijohet sot për herë të parë si shtet dhe nuk ka pasur bazë ligjore për parandalimin dhe luftën ndaj pastrimit të parave, se nuk ka pasur burime njerëzore, ndërkohë që është i njëjti drejtor, i cili u pyet edhe në komision: o zotëri, meqenëse ekziston në përgjimet e antimafias italiane, a të ka ndërhyrë ndonjë zyrtar më i lartë se ti, ministrja ose zëvendëskryeministri, njëri prej?! Nuk u përgjigj fare. Po, zero, sepse përbënte kërcënim për të, për të mbajtur vendin e punës, sepse kështu thuhet në përgjime. Këtu duhet puna e SPAK-ut dhe ndërhyrja e institucioneve ligjzbatuese, të cilat janë më të mirëpaguarat në këtë vend, për të qartësuar opinionin publik se për çfarë bëhet fjalë.

Nga ana tjetër, se nuk u përmend fare këtu, një prej burimeve kryesore (do të lexoj një prej medieve më të rëndësishme, e cila mbështetet financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, që është "INA medie"), thotë: "Shqiptarët nuk e harrojnë që u bë një teatër i madh me kazino të në këtë vend. Kazinotë, përveç ndërtimit, janë një prej instrumenteve që përdor krimi i organizuar dhe ata që duan të pastrojnë para". Sipas kësaj medie: "Kazinotë pranojnë të qarkullojnë fiktivisht sikur janë luajtur shuma të mëdha parash nga aktivitete të paditura dhe të padëklaruar kundrejt përqindjes së dakodësuar, paraprakisht, duke certifikuar vlerat si të fituara në lojëra fati. Prandaj, përveç 3 kazinove, po hapen edhe 4 të tjera vetëm në Tiranë, të cilat tregu nuk i justifikon, sepse

Shqipëria nuk ka fuqi financiare për të justifikuar 7 apo 8 kazino të mëdha. Përse duhen këto, atëherë? Për aq sa janë, janë shumë dhe sjellin një dëm social shkatërrimtar, prandaj edhe qeveria ndërmori me trumbetim operacionin "Fundi i marrëzisë". Të mos futemi dhe të shikojmë se si kazinotë e licencuara në mes të Tiranës, ku asnjëra nuk është brend ndërkombëtar, janë të gjitha të lidhura me pronarë lojërash fati, të cilët kanë qenë pronarë edhe të "Fundi i marrëzisë", që u trumbetua me të madhe nga ana e Kryeministrit.

Risi e këtij ligji ishte përfshirja në nenin 2, pika 10, të tij, të përkufizimi i personave të ekspozuar politikisht, ku për efekt të ligjit do të konsiderohen edhe personat me marrëdhënie të ngushta familjare, personale, pune apo biznesi. Kjo është një ndër arsytet pse ne do ta votojmë pro këtë projektligj. Nga ana tjetër, ligji nuk e përcakton dot, sepse, parashikimi është me rëndësi, pa diskutim një pjesë e mirë e zyrtarëve të lartë publikë, siç i kemi denoncuar në mënyrë të përhershme, përdorin persona të tretë për të krijuar biznese, të cilët më pas shndërrohen në përfitues të mëdhenj të fondeve publike, të partneriteteve publike-private apo të çdolloj tenderi e koncesioni në këtë vend. Por ajo që është e paqartë është se si do të bëhet zbulimi i këtyre personave, sepse, aq sa është i rëndësishëm parashikimi në ligj, është edhe vullneti, edhe mënyra se si do të realizohet, që kjo të bëhet me vullnetin e munguar politik të maxhorancës.

A mund të thuhet që ndërtimi sjell zhvillim në këtë vend, ku prej 3 vjetësh bankat e nivelit të dytë, 10 nga 12 të tilla, pothuajse e refuzojnë kreditimin e sektorit të ndërtimit për shkak të riskut të lartë që bart ky sektor? Gjithashtu kemi edhe refuzimin e institucioneve ndërkombëtare bankare për të përzier depozitat e qytetarëve shqiptarë me para të pista. Rrjedhimisht lind pyetja, të cilën e kemi bërë dhe po bëhet përsëri, u bë edhe në komision: pse nuk e ka shqetësim qeveria dhe Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave? Ku i gjejnë burimet e financimit 141 kompani, të cilat marrin leje ndërtimi në Tiranë për të ndërtuar mbi 6,3 milionë metra katrorë vetëm në 3 vjetët e fundit? Një përgjigje e pyetjes pa diskutim mund të jenë edhe raportet e organizatave ndërkombëtare, si: "Global Initiative", e cila thotë se nga 141 kompani, që



fituan leje ndërtimi në Tiranë, 59% e tyre nuk kishin burime financiare të mjaftueshme, ndërsa 60% e vlerës së këtyre ndërtimeve mendohet se vjen nga paratë e pista. Në total për vitet 2017 – 2019 në Shqipëri janë pastruar 1,6 miliardë euro. Qeveria nuk ekziston fare.

Po si ka mundësi, kur Shqipëria e prin luftën ndaj pastrimit të parave në çdo përgjim të rastësishëm të partnerëve, siç janë ata italianë, që flitet vetëm për një lehtësi në pastrimin e parave në Shqipëri?!

Në përgjimet e antimafias së “Cantazaros” në 1586 faqe, Tirana dhe Shqipëria, dëgjojeni mirë, përmendet 536 herë. Pra, në organizatat mafioze në Catanzaro, nga prokuroria italiane, Shqipëria përmendet për pastrim parash 536 herë. Në çdo rast kur flitet për Tiranën apo për Shqipërinë biseda ka të bëjë me pastrimin e parave apo me krijimin e të ardhurave nëpërmjet lejeve të ndërtimit, tenderëve dhe koncesioneve. Në përgjime veçanërisht përmenden 3 leje ndërtimi me vlerë 180 milionë euro. Në përgjimet e antimafias së Catanzaros flitet, gjithashtu, edhe për përfshirjen në tenderë dhe koncesione nëpërmjet dhënies së ryshfetit zyrtarëve më të lartë të shtetit, që nga sekretari i ministrisë, zëvendësministri, ministri, kryetari i Bashkisë së Tiranës apo edhe Kryeministri. Madje përmenden edhe emra të caktuar, “Nik”, si presidenti i një grupi të quajtur “Sol”.

Niveli i lartë i korrupsionit bën që Shqipëria dhe qeveria ta ketë vullnetin pothuajse zero për të luftuar pastrimin e parave, sepse janë burimi kryesor dhe lënda kryesore me të cilën duhet të merren organet ligjzbatuese, jo ashtu siç tha ministri i Drejtësisë, që unë mund të shkoj aty, sepse nuk shkohet me qejf përpara organeve ligjzbatuese, përpara prokurorisë, por shkohet me detyrim për t’i marrë dhe për t’i nxjerrë përpara shqiptarëve të gjithë ata që zhvatin dhe vjedhin në këtë vend.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Kërkoj mirëkuptimin tuaj për t’ia dhënë fjalën zotit Shehi. Të përgatiten zonja Dhima dhe zoti Spaho.

**Dashamir Shehi** – Të nderuar kolegë,  
E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Edhe unë dua të them dy-tri shifra, sa për të hapur fjalën, për sa i përket kësaj teme. Këtu u tha që vetëm vitet e fundit 1,6 miliardë është shifra e përafërt, që është pastruar në Shqipërinë;

280 - 260 milionë qenë vetëm për vitin e shkuar. Këto shifra mund të jenë të përafërta, pra mund të mos jenë kaq, por mund të jenë më pak ose më shumë. Zakonisht këto shifra janë më shumë, sepse, si çdo biznes i pistë, nuk është se llogaritet fiks.

Edhe sipas treguesit të Bazelit, ne kemi shkuar mbrapa dhe sot krahasohemi me disa vende afrikane. Por, përtej kësaj, çfarë tregojnë shifrat dhe cili është risku për ambientin ndërkombëtar, sepse ata që po na i thonë këto janë të gjithë të huaj. Nuk ka ndonjë raport nga Shqipëria se cili është risku për këtë punë apo ndonjë analizë.

Këto që përmenden janë të gjitha shkrime, fjalë, analiza dhe perceptimi i të huajve. Sikur kjo nuk ndodh mbi ne, mbi shpatullat e shqiptarëve. Ky është një realitet, që na duhet për studim. Në fakt, ky është realiteti ynë i përditshëm, i cili ngjan me anekdotën e shqiptarëve dhe besoj të të gjithë botës, ku luani po hante gomarin dhe ai lutej: “Zot, bëje ëndërr, se ndoshta nuk është e vërtetë”! Mirëpo kjo situatë është e vërtetë, u ndodh të gjithëve, sepse ka afektuar ekonominë shqiptare dhe të gjithë sektorët me radhë. Të gjithë këtu e shikojnë me çudi të madhe sektorin e ndërtimit, për të cilin po flasim.

E dini pse po e përmend në fillim? Nuk është i vetmi sektor, madje ndërtimi ka edhe një lloj llaku, që tregon mirëqenie të dukshme, vizive, pasi shumica e shqiptarëve nuk i shikojnë paratë që pastrohen në kazino, kurse ndërtimi duket, por unë e them sepse perceptimi për ndërtimin është i tillë, që u vjen mirë jo vetëm ndërtuesve, por u pëlqen të gjitha palëve në Shqipëri dhe nuk e kuptojnë çfarë dëmi po bëhet në këtë fushë. Kjo nuk është thjesht se po ndërtohen godinat aty ku nuk duhet dhe jo siç duhet të ndërtohen, me armaturat e duhura, por sepse i gjithë ky sektor po shkon drejt një vetëshkatërrimi, pasi e ka humbur elementin e konkurrencës; është një raport thjesht financiar midis atyre që japin lejet dhe atyre që pastrojnë paratë, kurse pjesa tjetër nuk ka ndonjë vlerë të madhe, mund të ndërtohet ku të duash, mund të ndërtohet si të duash nëse fut disa para më shumë. Sigurisht, nga kjo prodhohet ekonomi në një farë mënyre, por është një ekonomi e pistë, nuk është konkurruese, është shkatërrimtare, që po ndërton një flluskë të madhe financiare, jo thjesht

ndërtuese, sepse nuk do të bien godinat, por do të bien paratë e këtij biznesi, që do të shkatërrojë dhe do të tërheqë me vete edhe pjesën tjetër të ekonomisë.

Të gjithëve u pëlqen. Madje, nëse do ta dëgjojnë këtë fjalim, disa do të thonë: “Çfarë ka ky budalla me paratë? Lëri njerëzit të punojnë, të pasurohen”, sepse edhe në vitin 1997 kemi thënë: “Lëri të punojnë, të pasurohen. Paratë tona janë të pastra”, dhe e pamë se çfarë do të thotë të pasurohesh shpejt, pa ligje, pa rregulla dhe pa leje. Kjo po ndodh dhe të gjithë, duke e ditur që ka një fitim falas, punojnë dhe marrin të gjithë nga pak, disa marrin shumë, por në përgjithësi del për të gjithë, si për muratorin, si për atë të duraluminit, edhe për atë që shet betonin, dhe u pëlqen të gjithëve.

Nëse do ta shikoni, ky sektor është rritur 30%. Çudi e madhe! Kjo shifër është e njëjta me vitet 1996-1997, kur u rrit 30%.

Dëgjova ministren, e cila tha: “Çfarë keni? Ekonomia është rritur: 30% kjo, 40% kjo tjetra, 42% ajo tjetra”.

Kush jemi ne? As Kina nuk është rritur kështu. Nga dalin këto shifra? Vërtet që mund të rritesh brenda një 3-mujori me 30%, mund të rritesh për 1 muaj, si për shembull, parvjet u rrit 300% prodhimi i energjisë elektrike, meqenëse ra shi, por kjo nuk është ekonomi reale. Ekonomia reale bazohet duke krahasuar 1 vit më parë me vitin e sivjetshëm dhe çfarë do të ndodhë vitin që vjen. Cila është kjo ekonomi? Çfarë shifrash u tregoni shqiptarëve?

Unë do të thosha se kjo temë duhet marrë seriozisht nga shteti shqiptar. Këtë temë nuk e mund një ligj i ri, absolutisht. Ne jemi dakord me këtë ligj. Nëse do t’ju duhen ligje të tjera, mund t’i bëjmë.

I thamë drejtorit që erdhi atë ditë, se nëse ju duhet më tepër personel, mund t’i merrni dhe t’i specializoni. Ne absolutisht jemi dakord me të gjitha këto, por nuk jemi dakord me përgjigjen klasike të tij, shumë të bukur, që do të mbahet mend. E dini si tha? “Janë shtuar ndërtimet dhe shtëpitë, sepse nga viti i pandemisë, popullit, duke ndenjur në shtëpi, iu rrit dëshira për shtëpi”. Domethënë, si një përgjigje për pastrim parash. Nuk ma ha mendja që mund ta pranojë ndonjë estradë në botë këtë gjë. Megjithatë, e tha qetësisht, seriozisht dhe e dini pse? Sepse nuk është thjesht biznesi i atij, nuk e ka ai për detyrë

ta ndalojë, pasi ka njerëz mbi të që e urdhërojnë, ndaj e thotë aq qetësisht një budallallëk të madh, sepse e di shumë mirë që këtu ka forca të tjera, grupe politike dhe financiare, shefa që drejtojnë qeverinë, që i kanë thënë: do ta bësh këtë punë, ose vendosim dikë tjetër ta bëjë. Kjo nuk ka absolutisht asnjë logjikë tjetër.

Unë nuk pres që kjo drejtori të mbyllë apo të parandalojë pastrimin e parave, por ka për detyrë të bëjë çdo vit analizë se cilët janë sektorët e riskut, të ndërtojë ligje, që të involvojnë brenda një çerniereje të përbashkët, për t’i agreguar të gjitha institucionet e shtetit, së pari, Drejtorinë e Taksave dhe Tatimeve, së dyti, sektorët e policisë, që duhet të ndjekin krimin ekonomik; të kordinojnë me prokuroritë, të shikojnë bashkë me Bankën e Shqipërisë se cilat elemente të tregut financiar involvohen në këtë situatë. Nuk mund të pastrohen shifra të tilla në një vend kaq të vogël, pa bankën nga pas, pa policë që mbyllin sytë dhe pa qeveri, që është dakord se këto sjellin zhvillim. Do të ishte budallallëk i madh, sepse është e pamundur fizikisht, teknikisht dhe nga të gjitha pikëpamjet, që një operacion kaq i madh financiar të bëhet në një vend me GDP kaq të vogël. Kjo pjesë është e koordinuar dhe unë nuk pres ta ndalojë Drejtoria e Pastrimit të Parave, por pres që ata të bëjnë detyrën e vet, të paktën të bëjnë një analizë vjetore, ku të tregojnë sektorët e riskut.

Zotërinj të nderuar,

Për këtë temë mund të flasim me javë, por do t’ju kujtoja disa gjëra, për hir të një jete të gjatë këtu.

Kemi qenë në Afganistan para 20 vjetësh dhe gjysma e vendit ishte e mbjellë me drogë. Qeveritë perëndimore, për të gjetur të ardhura, për të marrë me të mira popullin afgan, e mbyllën një sy dhe thanë: nuk ka gjë, le ta shesin.

Këta e mbjellin drogën si misër. Ky është Afganistani pas 20 vjetësh. Një vend që merr rrugën e krimit për të mbijetuar ekonomikisht nuk pasurohet kurrë, por vetëm shkatërrohet. Nëse do të ishte kështu, do të ishin pasuruar Meksika, Kolumbia dhe jo Amerika; do të ishte pasuruar Afganistani dhe jo Dubai, ku pastrohen ato para.

Ky do të jetë edhe fati i Shqipërisë nëse ne të gjithë nuk u mbyllim pak dorën atyre që e kanë marr me kaq të lehtë këtë proces. Pse?

Sepse krimi po hyn në politikë, ka hyrë në administratë, në polici dhe në drejtësi. Krimi është bërë ndërkombëtar dhe do të bjerë tjetër ekspertizë brenda Shqipërisë për t'i fryrë institucionet tona. Ne nuk kemi thjesht detyrë të paralajmërojmë, por kemi detyrë të marrim aksione të nevojshme për t'i dhënë një farë drejtimi kësaj pune.

Kaq kisha.

Më vjen keq që bëj Kasandrën për këtë punë, por them se ia vlen.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehi!

Fjalën e ka zonja Dhima.

Të përgatitet zoti Spaho.

**Antoneta Dhima** - E nderuar zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji që po e diskutojmë sot ka për qëllim hartimin dhe garantimin e një kuadri të plotë ligjor, sipas standardeve europiane për sigurimin dhe mbrojtjen e sistemit financiar, por edhe të ekonomisë shqiptare nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pastrimi i parave është procesi i përdorur për të fshehur burimin e parave ose të pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale dhe përgjithësisht përfshin shndërrimin e të ardhurave të krimit në një formë të ligjshme.

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit mund të përfshijnë edhe institucionet financiare si: bankat, subjektet financiare jobankare dhe zyrat e këmbimit valutor nëpërmjet kanaleve të transferimit të parave, pagesave apo kredisë.

Përfshirja, edhe pa dijeni, në këto procese, mund t'i shkaktojë dëm shumë serioz reputacionit të një institucioni, sistemit financiar, organit të tij rregullator dhe vendit në përgjithësi.

Në zbatim të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" dhe ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", institucioni i Bankë së Shqipërisë është një nga institucionet e rëndësishme financiare që mbikëqyr veprimtarinë e subjekteve të licencuara prej saj, duke vlerësuar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe rregullave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Shqipëria është bashkë me të gjitha vendet që kërkojnë dhe dëshirojnë të arrijnë fitoren e

luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar për përballimin me sukses të kësaj sfide të kohës.

Lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar kërkon kohë dhe këtë luftë duhet ta bëjmë bashkë me vendet e tjera, pasi këto sfida kërkojnë angazhim e zgjidhje të përbashkët.

Pastrimi i parave është aspekti financiar i të gjitha krimeve ekonomike dhe si aktivitet forcon kriminelët dhe organizatat kriminale, duke u dhënë atyre mundësinë të vazhdojnë aktivitetin e tyre të paligjshëm. Ai ndikon në sistemin ekonomik, gërryen besimin publik të institucioneve dhe sistemin e vlerave, si dhe, në epokën moderne të globalizimit dhe teknologjisë, ndikon në lëvizjen e kapitalit financiar, duke kërcënuar stabilitetin ekonomik.

Miratimi i këtij projektligji do të sigurojë minimizimin e rrezikut të pastrimit të parave, financimin e terrorizmit nëpërmjet hartimit të politikave të harmonizuara, si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet për të mundësuar një akses më të shpejtë në marrjen e informacionit.

Gjithashtu, ky projektligj synon parandalimin e hyrjes së produkteve apo pasurive të siguruara, si pasojë e konsumimit të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve, të cilat shkojnë për mbështetjen e terrorizmit në sektorin financiar ose në sektorët e tjerë të vendit. Gjithashtu, në rast të prezencës në vend të këtyre produkteve ose pasurive, miratimi i këtij projektligji do të synojë zbulimin e kërcënimeve për pastrim të parave, financimin e terrorizmit dhe, pa më të voglin dyshim, raportimin e tyre.

Mangësitë e evidentuara në ligjin aktual për mungesën e përafrimit të plotë me direktivat e Bashkimit Europian, angazhimi i Republikës së Shqipërisë, që buron nga neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizimit-Asocimit Shqipëri – BE, bëri të mundur ndryshimet në ligj.

Kërkesa për ndryshim ka ardhur në mbështetje të vlerësimeve të kuadrit ligjor që i janë bërë Shqipërisë nga MONEYVAL dhe nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar, të cilët kanë identifikuar nevojat dhe kanë bërë rekomandimet e duhura në funksion të efektivitetit të sistemit dhe përputhshmërisë teknike me rekomandimet e Grupi të Posaçëm të Veprimit Financiar.

Komiteti MONEYVAL është një organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Europës, i cili vlerëson pajtueshmërinë me standardet kryesore ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave e financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe është ky komitet, që harton rekomandime për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme.

Përmes krijimit të kuadrit të plotë ligjor, duke e harmonizuar me atë të BE-së, si dhe nëpërmjet forcimit të integritetit të sistemit parandalues në vend, kemi kontribuar për sigurinë, si dhe për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës.

Kontributin kryesor në hartimin e këtij projektligji e ka Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Projektligji është konsultuar me bankat e nivelit të dytë, me institucionet financiare jobanka, me shoqëritë e transfertave, me Bordin e Mbikëqyrjes Publike, IEKA-n, me Postën Shqiptare, me kompaninë e auditimit “Deloitte Albania”, me shoqëritë e transfertave, me Bankën e Shqipërisë, si dhe i është dërguar për konsultim Dhomës të Avokatëve të Shqipërisë dhe Dhomës së Noterëve të Shqipërisë.

Vlen të theksojmë faktin se projektligji është konsultuar dhe ka marrë komente, të cilat janë reflektuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, edhe nga eksperti ndërkombëtar i GIZ-it, edhe nga delegacioni i BE-së në Shqipëri.

Gjithashtu, duhet të theksojmë faksin që ky projektligj nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Marrëveshja është nënshkruar midis gjashtë institucioneve: Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave për të goditur pastrimin e parave. Kjo marrëveshje ka bërë bashkë këto institucione, të cilat do të punojnë për ta luftuar këtë fenomen, pra pastrimin e parave dhe korrupsionin. Në nivel qendror është ngritur një strukturë, e cila vepron si një organ monitorues dhe koordinues për pastrimin e parave, për financimin e terrorizmit, krimeve financiare, si dhe hetimit të pasurive, ku puna dhe angazhimi i të cilëve do të na nxjerrë nga lista gri.

Duke vlerësuar se projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi dhe se miratimi i tij do të mundësojë plotësimin nga Shqipëria të detyrimit për harmonizimin e plotë të kuadrit ligjor shqiptar me direktivat e BE-së kundër pastrimit të parave, të nderuar kolegë dhe kolege deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

*(Drejtimit e seancës e merr zonja Nikolla)*

**Lindita Nikolla**- Faleminderit!

Fjala për zotin Edmond Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Një kritik kur po dëgjonte njëherë dikë, që fliste siç foli ministrja e Financave këtu, pati thënë se me vjen ta ndërpres dhe t'i them që gënje, por gënje me masë. Pse e them këtë? Kur e diskutuam këtë projektligj në Komisionin e Ekonomisë kishte ardhur zëvendësministrja e Financave, zonja Vjero, e cila tha se ndryshimet janë kozmetike, kurse këtu po dëgjojmë të thuhet se ndryshimet qenkan fantastike, që plotësojnë kërkesat e BE-së për të na hequr nga lista e zezë e vendit me risk të lartë për pastrim parash. Tani ose njëra, ose tjetra gënjen, por se cila gënjen, gjejeni ju.

Lëre pastaj kur dëgjon Ulsin, ai flet si e ëma e Zeqos në majë të thanës, siç ka folur gjithmonë, por, prandaj e bënë ministër Drejtësie, sepse flet si e ëma e Zeqos në majë të thanës!

Nuk ka përafrim të legjislacionit me direktivën e BE-së. Hapeni projektligjin dhe ma gjeni se ku është tabela e përafrimit! Vetëm janë cituar dy dokumente të BE-së për çështjen e pastrimit të parave. Atëherë, çfarë përafrimi legjislacioni paskemi me BE-në?! Gënjeshtër!

Bëhet një ndryshim kozmetik, siç e tha me të drejtë zonja, me qëllim që të sigurojnë te raporti i ardhshëm ndonjë frazë, që Shqipëria ka bërë rregullime dhe përmirësime në legjislacionin për pastrimin e parave dhe luftën kundër terrorizmit. Por sa kohë që në listën e MONEYVAL-it jemi në listën gri, do të thotë se ne jemi shumë problematik si vend për pastrimin e parave. Të gjitha të tjerat janë fjalë.

Është edhe Malta, na tha ministrja. Sot, në të gjitha vendet e Këshillit të Europës është vetëm Shqipëria. Nuk është hera e parë që Shqipëria hyn në listën gri, pra në listën e

vendeve me rrezikshmëri të lartë për pastrim parash dhe financimin e terrorizmit.

Mirë që ky MONEYVAL –i nuk qenka ndonjë gjë për t'u shqetësuar, po raportin e DASH-it për vitin 2022 a e keni lexuar ndonjëherë dhe të shikoni se çfarë shkruhet, zotërinj qeveritarë? Aty shkruhet se Shqipëria nuk ka bërë asnjë përparim në pastrimin e parave. Më shumë se kaq nuk ka çfarë të thotë? Çfarë konstaton? Grupet kriminale të Amerikës Latine dhe të Europës kanë shënjestruar tregun e shërbimeve në Shqipëri. Ajo që ndodh rëndom është se paratë pastrohen në tregun e pasurive, në ndërtim, midis të tjerave, që është drejtimi kryesor ku pastrohen paratë. Prandaj lulëzon ndërtimi në Shqipëri.

Çfarë arsyes nxjerr raporti i DASH-it pse Shqipëria nuk ka bërë asnjë hap përpara në pastrimin e parave? Korrupsionin me fondet publike, krimin e organizuar, prezencën e lartë të krimit të organizuar në Shqipëri, institucionet e dobëta që luftojnë pastrimin e parave dhe legjislacionin i dobët. Këto janë disa nga arsyet, por jo ajo që na tha njëri në komision, se është rritur ndërtimi, sepse kanë blerë shtëpi ngaqë e ndjenin veten në siklet gjatë pandemisë në ato sipërfaqet e vogla. Pra, ku jemi mirë ne? Ne kemi korrupsion, kemi krim të organizuar, kemi institucione të dobëta, qesharake madje, dhe legjislacion të dobët, që lejon pastrimin e parave. Këto janë sukseset?! I keni parë si kanë shkuar procedimet penale për pastrimin e parave nga viti 2018 në vitin 2020?

Procedime të regjistruara në vitin 2018 ishin 280, në vitin 2019 ishin 220 dhe në vitin 2020 ishin 130; të pandehur të dërguar në gjyq në vitin 2018 ishin 60, në vitin 2019 ishin 40 dhe në vitin 2020 ishin 20; të dënuar në 2018 ishin zero, në vitin 2019 ishin 30 dhe në vitin 2020 ishin 20, kurse në raportin e DASH-it për vitin 2020 thuhet se janë dënuar vetëm 3 persona për pastrim parash.

Si është e mundur që 60% e lejeve të ndërtimit që jepen në Shqipëri nuk i kanë burimet e financimit? A e dini ju që Shqipëria është i vetmi vend që jep leje ndërtimi pa sqaruar burimet e financimit? Në cilin vend të Bashkimit Europian e më gjerë, po flas për Evropën, jepen leje ndërtimi pa sqaruar burimet e financimit? Si do ta financosh ti ndërtimin e kullës, të pallatit?

I kam unë vetë paratë apo i ka kompania, paratë nuk mbahen në thes, por mbahen në bankë. Po, kompania mund t'i ketë, por duhet t'i ketë 100% në bankë, në qoftë se e financon vetë, por në qoftë se e financon vetë dhe me kredi, duhet t'i marrë kredi në bankë, në qoftë se është me bashkëfinancim, edhe ai bashkëfinancuesi duhet t'i ketë paratë në bankë.

A doni ju që të ndalohet pastrimi i parave në Shqipëri? Hajdeni të bëjmë një amendament që të rregullojë çështjen e financimit të ndërtimeve dhe ku gjithçka të kalojë nëpërmjet kanaleve bankare! Një shtet serioz këtë bën dhe nuk lejon që të ndërtohet me torba apo me thasë me lekë, apo siç mund të thonë disa që do ta financoj unë që në gropë me ata që do të blejnë shtëpitë. Pse, ku jemi, në kohën e feudalizmit, apo të bashkësive primitive kur ndërrohej një dele me 3 thasë me gurë?

Kompanitë offshore janë rrezik për Shqipërinë dhe janë shtuar si kërpudhat. A doni shembuj? Kompania DH Albania e Unazës, që mori Unazën dhe OST-në, guaska, që shoqërohet edhe me kompani me pronësi të paqarta. Kur ia thashë drejtorit të Pastrimit të Parave rastin e DH-së, më tha: "Jo, ajo e ka pronarin". Po, more zotëri, e ka pronarin, atë 20-vjeçarin që çau ferrën dhe nuk e kapi më dot njeri. Ai është guaska, janë të tjerët pronarë dhe detyra jote është t'i gjesh së bashku me shtetin që përfaqëson.

A doni ta ndalojmë pastrimin e parave? Hajdeni të bëjmë amendament këtu për kompanitë guaska, por edhe për ato me pronësi të paqartë që ose të kenë emër, mbiemër, vendndodhje dhe llogari bankare, ose nuk ka aktivitet ekonomik dhe nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në tenderë dhe të përdorin fonde publike. Kështu vepron një shtet serioz që dëshiron vërtet të hyj në Bashkimin Europian.

Për të mos folur më pas për përgjimet që përzihen edhe në sistemin bankar, ku zyrtarët, sikurse pretendohet, do t'i japin urdhër bankës që t'u liroj paratë, paratë e ardhura nga jashtë, që futen pa asnjë kufizim. Nuk po them për Toyota Jaris, se ato qenë të fshehura, por është një individ, J.K., që ka një proces, i cili për 3 vjet 4 milionë euro ka investuar në Velipojë për ndërtime. Si i solli këto para? Si i investoi? Madje, u bënte thirrje edhe të tjerëve andej nga i kishte, nga vendi i origjinës, hajdeni dhe

investoni këtu se është, më falni për shprehjen, rumpallë.

Në mbyllje më duhet t'ju them se këto ndryshime, sikurse e tha edhe zëvendësministrja, janë kozmetike, prandaj duhet të shërbejnë si kabanë alarmi, sepse jemi shumë larg zbatimit të kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Nëse do të vazhdojmë kështu, ka rrezik të na klasifikojnë te vendet me risk të lartë për financimin e terrorizimit, sepse pastrimi i parave është bashkëngjitur me financimin e terrorizmit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja Ibrahimaj.

**Delina Ibrahimaj** – Në fakt, nuk jemi këtu as për të gënjyer dhe as për të hedhur hi në sytë e askujt. Ajo që unë thashë ishte e qartë dhe e saktë, që kjo nismë ligjore në bashkëpunim me të gjithë nismat e tjera ligjore që kanë filluar, jua përmenda me radhë, kanë të bëjnë me ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues, me ligjin për krijimin e regjistrimit të llogarive bankare, me ligjin e fiskalizimit, me ndërthurjen e të gjitha databazave tona, me hyrjen e Shqipërisë në vendet e OECD-së, të cilët shkëmbejnë informacione për sa u përket individëve shqiptarë që mund të kenë llogari nëpër vende të huaja. Pra, ka të bëjë me një sërë nismash. Mund t'ju rendis edhe të tjera, por nuk dua t'ju ha më shumë kohë për të diskutuar për këtë projektligj, i cili është vetëm pozitiv, por, gjithashtu, ka të bëjë edhe me përgjegjshmërinë tonë kundrejt qytetarëve dhe njëri-tjetrit për luftën kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit. Zotëri, këtu askush nuk gënjen.

Gjithashtu, dua t'ju theksoj se rritja ekonomike që ju përmenda nuk është një rritje ekonomike në ajër, por është e bazuar dhe e krahasuar me 1 vit më parë. Sigurisht, ka këto vlera bombastike, do t'ju thosha, pasi viti i kaluar ka qenë një vit që ka pasur recesion dhe rënie ekonomike, por tregon për qëndrueshmëri të rritjes.

Unë nuk iu referova vetëm normave të rritjes ekonomike në sektorin e ndërtimit, por normave të rritjes ekonomike në të gjithë sektorët, si dhe të dhënave të 11-mujorit për të ardhurat e mbledhura nga qeveria në krahasim me vitin 2019. Pra, kur bëjmë analiza ekonomike, bëjmë analiza gjithëpërfshirëse dhe jo me një apo dy tregues të vendosur aty në ajër.

Këta tregues janë të bazuar si nga ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve, ashtu edhe nga rritja e normës së kredidhënies për të gjithë sektorët. Sigurisht, këtu dua të përmend edhe sektorin e ndërtimit. Ne, analizat ekonomike dhe nismat e akteve nënligjore i marrim seriozisht dhe nuk jemi këtu për të gënjyer dhe për të hedhur hi në sytë e askujt.

**Lindita Nikolla** – Po, urdhëroni, zoti Spaho!

**Edmond Spaho** – Faleminderit!

Meqenëse më kujtuat rritjen ekonomike, ju si ministre e Financave dhe Ekonomisë duhet të na sqaronit se si është e mundur që në një vit pandemie ndërmjet tre sektorëve kryesorë të ekonomisë, turizmit, bujqësisë dhe ndërtimit dy kanë shkuar në gropë dhe vetëm një është rritur me ritme të paimagjinueshme. Përgjigjja e atij zotërisë së pastrimit të parave kishte lidhje pikërisht me këtë pyetje.

Sa i takon gënjeshtërs, nuk ka pse të më drejtosh mua, por sqaroheni me zëvendësministren tuaj, e cila e tha në prezencën e 15 burrave dhe grave, që janë ndryshime kozmetike.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Boçi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, nuk bëhet replikë mbi replikë!

**Luçiano Boçi** – Të flasësh për parandalimin e parave të pista në një vend që qeverinë e ka të pistë, parlamentin të pistë, arsimin e ka të pistë, shëndetësinë e ka të pistë, ekonominë po se po, duket si një shaka shumë e trashë. Brenda kësaj shakaje serioziteti i bërjes së ligjeve, pothuajse të njëjta dhe të përafërta me Bashkimin Europian, të bën të shqydhesh gazet, ndërkohë që të dëgjosh ministren përkatëse kur thotë që zhvillimi ekonomik matet me lartësinë e kullave, i bie që të mbash barkun me dorë nga gazi.

Për rastësinë time, po shihja para 2 ditësh një dokumentar për Etiopinë, besoj se e dini se ku është Etiopia, i cili paraqiste grataçela të bukura në Addis Abeba, që çfarë t'ju them unë! E çfarë tregon kjo, se Addis Abeba ia ka kaluar edhe Amerikës, ku edhe ne në bazë të këtyre lartësive së këtyre ndërtesa ia kemi kaluar?

Ndoshta ministrja ngatërron shiritat e grafikëve në Excel të rritjes së korrupsionit dhe

të pastrimit të parave të pista me lartësinë e gradaçelave, por nuk po ndalem më shumë këtu.

Te ne ndodh një gjë e çuditshme: sa më shumë pasurohet kuadri ligjor, aq më shumë shtohet pastrimi i parave. Ecim në progresion, drejt. Edhe sikur të sjellim ndryshime të tjera, përsëri pastrimi i parave në Shqipëri nuk parandalohet, ai do të shtohet. E dini pse shtohet? Sepse nuk janë vetëm grupet kriminale ato që merren me pastrimin e parave, kryesisht janë zyrtarët dhe pushtetarët e korruptuar, janë ata që na sjellin këto ndryshime ligjore për t'u hedhur hi syve të botës: "Ne jemi për progresin, ne jemi duke u zhvilluar", ne po luftojmë, ndërkohe që nuk bëhet asgjë. Parandalimi te ne nuk është çështje ligjesh. Ju e dini shumë mirë këtë, sepse folët këtu për ligje, që i merrni me seriozitet. Jo, jo, parandalimi, lufta ndaj krimit dhe korrupsionit të parave të pista është çështje e vullnetit politik. A ekziston ky vullnet politik? Fare! Këtë e tregojnë të dhënat. Mondi e citoi, vetëm 1% e çështjeve penale lidhen me pastrimin e parave të pista dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre shkojnë në gjykata.

Megjithatë, ne flasim për miliona, për gjëra të mëdha. Për ta kuptuar nivelin e pastrimit të parave, unë do të marr një shembull të thjeshtë, që edhe publiku ta kuptojë mirë. Po u referohem çmimeve të apartamenteve në Tiranë, po marr këto më të lartat, 3 mijë apo 4 mijë për metër katror, sigurisht në zonën e Bllokut, dhe po i ballafaqoj me shtresat e shoqërisë shqiptare.

Pensionistët sot marrin 1 mijë euro në vit. Një çifti së bashku, sikur të mos hanë, të mos pinë dhe të mos paguajnë ujë dhe drita, i duhen 200 vjet që të shlyejnë një apartament 100 metër katrorë në Tiranë. Domethënë, i bie të jetojnë sa një shqiponjë.

Marrim pjesën tjetër, sipas Bankës Botërore, 35% e shqiptarëve jetojnë me 5 dollarë në ditë. Sa vite i duhen kësaj shtrese? 35% e shqiptarëve janë 1 milion qytetarë, si dhe 750 mijë pensionistë, pra u bënë 1 milion e 750 mijë, edhe këtyre u duhet, në bazë të të ardhurave, 200 vjet për të marrë një apartament 100 metër katrorë.

Por të mos shkojmë më tej, të vazhdojmë me shtresën e mesme, me mësuesit, që marrin pothuajse 6 mijë euro në vit të ardhura, pa ngrenë, pa pirë edhe këta. Sa vite u duhen edhe

këtyre që të paguajnë shtëpinë? U duhen 150 vjet, që hyjnë te shtresa e mesme.

Po ata që kanë rrogat e larta, që marrin 1 mijë euro në muaj, pra kanë të ardhura më shumë? Edhe atyre u duhen pothuajse 50 vjet.

Pra, ja ku jemi. Ku janë blerësit e apartamenteve? Pse paska një bum kaq të madh gradaçelash dhe pallatesh në Tiranë, kur nuk ka blerës?! Ku gjenden paratë e investimeve?! U trajtua edhe nga Ervini kjo çështje. Ku janë këto 141 kompani, të cilat marrin të drejtën e ndërtimeve, por një pjesë e tyre deklarojnë se kanë të ardhura vetëm 100 mijë lekë kapital? Ku i gjejnë paratë për të investuar? Nga i marrin të ardhurat e padeklaruara? Është shumë e thjeshtë, janë zyrtarët dhe qeveritarët e korruptuar. Janë para që rrjedhin lumë e pastrohen në Shqipëri, a thua është lavatriçe. Unë mendoj se ky term nuk e shpreh tamam krimin e madh të pastrimit të parave në Shqipëri; është një term që na është mësuar veshi dhe duhet të gjejmë ndonjë term tjetër lidhur me të, se Shqipëria nuk ka të krahasuar.

Lind pyetja: kush është pastruesi më i madh i parave të pista në Shqipëri? Pastruesi më i madh është organizata kriminale e qeverisë. Pse e them këtë? I jam referuar seancës së kaluar, kur folëm për buxhetin, në një raport të CIA-s përmendet se qeveria shqiptare nuk i deklaroi të ardhurat e vërteta të produktit bruto në Shqipëri, por i fsheh ato. Falë kësaj fshehjeje ka evazion fiskal, në bashkëpunim me biznesin kriminal, në një sasi prej 10 bilionë dollarësh. 10 bilionë dollarë janë në Shqipëri, që do të pastrohen. Si do të pastrohen këto? Sigurisht, do të pastrohen me ndërtime, me biznese fiktive, me qëllim që të kanalizohen dhe të hyjnë në rrugën ligjore të bankave. Kjo është e vërteta.

Të mos presin që kjo qeveri, e cila është organizata që bën pastrimin më të madh, të marrë masa e të ketë vullnetin të luftojë pastrimin e parave.

Në fakt, nuk do të merrem me mënyrën se si pastrohen paratë në Shqipëri, por do të merrem me dy argumente, përsëri e kam me qeverinë.

Forma më e përhapur e pastrimit të parave nga qeveria në Shqipëri, të cilën nuk ka *acqui* europiane dhe ligj europian ta kapë, është pastrimi i parave me anë të ligjeve, ligje që janë aprovuar këtu në këtë parlament. Ndaj është i pistë ky parlament. Ligje për oferta të

pakërkua, që pastrojnë miliona, ligje për koncesione, që pastrojnë miliona dhe ligje që favorizojnë biznese me 100 mijë lekë, që i kanë në llogari e marrin miliona nga buxheti i shtetit. Është formë që nuk kapet.

Sa ligje janë aprovuar këtu për të grabitur pronën publike?

Sa ligje janë aprovuar për të shembur mijëra shtëpi, që janë ndërtuar me djersën dhe gjakun e shqiptarëve, për t'i kthyer ato në troje ndërtimi? Sa janë miratuar?

Sa ligje janë miratuar përgjatë viteve që ne nuk kemi qenë dhe përgjatë viteve që kemi qenë? Shumë ligje të tilla.

Forma tjetër, që është shumë origjinale në Shqipëri, nuk ka *aqcu* europiane dhe legjislacion ta përafrojnë, është pastrimi i parave në fushat zgjedhore, sepse këtu nuk ka as ligj për pastrim të saktë, as ligj për financimin e partive. Gjatë fushatave zgjedhore vlojnë thasët me para. Thasët janë mbushur me paratë e krimit, paratë e korrupsionit, që shpërndahen në mënyrë kapilare, pastaj te votuesi. A u pastrua kjo para e pistë prej miliona eurosh, siç u bë më 25 prill? Po, u pastruan. Çfarë sjell kjo para e pistë? Sjell pushtet. Pushteti pastron paratë e investuar në mënyrë kriminale, sepse, pastaj janë favorët me tendera, favorët me koncesione, favorët me dhënien e pronave, favorët me dhënien e shumë lejeve të ndërtimit qoftë në Tiranë, qoftë në vendet e tjera.

Sigurisht, qeverisja ecën me mentalitetin që paraja e pistë duhet, paraja e pistë jep zhvillim ekonomik, se për momentin edhe punëson. Po, është e vërtetë që punëson në një rrjet kriminal, por ama e mbyl biznesin dhe ekonominë.

Është shumë e thjeshtë, nuk ka vullnet, sepse qeverisja suksesin e saj ekonomik e mbështet pikërisht te paraja e pistë, dhe këtë e deklamon. Është si ajo fabula e majmunit, i cili është ulur në këtë degë dhe nuk mund të presë degën e vet, nuk mund të luftojë pastrimin e parave. Edhe ne, sigurisht, nuk duhet të presim që majmuni të presë degën e vet, por së bashku me qytetarët duhet ta zbresim patjetër majmunin nga pema.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** –Faleminderit!

Do të bëjmë 5 minuta pushim për të përfunduar procesin e votimit.

Duhet të respektojmë folësit pa kaluar para foltores!

*(Rifillon seanca)*

**Lindita Nikolla** – Të nderuar kolegë,

Ju lutem, të zëmë vendet për të vijuar me seancën!

Fjala për zotin Deliu.

**Denis Deliu** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”, që po shqyrtojmë sot, është hartuar në përputhje me nenin 116, shkronja “c”, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pasqyron përafrimin e plotë me direktivën e BE-së 2015/849 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës, datë 20.05.2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”, që ndryshon Rregulloren e BE-së nr. 648/2012 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës, që shfuqizon direktivën e Këshillit të Europës dhe të Komisionit 2006/70 të KE-së, ndryshuar nga direktiva 2018/843.

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen e sigurinë, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të fushës. Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet të zvogëlohen rreziqet e pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit; të parandalohet hyrja e produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe e fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë, zbulimi dhe raportimi i tyre; të zbulohen e goditen kërcënimet për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit. Këto synime do të realizohen nëpërmjet përputhshmërisë teknike me standardet ndërkombëtare në fushën kundër pastrimit të parave, që përbëhen nga rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit



Financiar (FATF), si dhe nëpërmjet adresimit të çështjeve të evidentuara nga MONEYVAL-i.

Projektligji është diskutuar gjerësisht nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare dhe ai i Ligjeve, është konsultuar me grupet e interesit dhe disa nga opinionet, propozimet e paraqitura me shkrim në Komisionin e Ligjeve, pas shqyrtimit të hollësishëm janë adresuar dhe janë reflektuar në variantin përfundimtar të projektligjit, nëpërmjet amendamenteve të dakordësuara me nismëtarët.

Ky projektligj përputhet me planin e përbashkët të veprimit për antiterrorizmin për Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Forumin Ministror BE-Ballkan Perëndimor “Për drejtësinë dhe çështjet e brendshme” në Tiranë, në datën 5 tetor 2018 nga përfaqësuesit e BE-së dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor. Sipas objektivit 4 të këtij plani të përbashkët të veprimit, Shqipëria ka marrë përsipër harmonizimin e plotë me direktivat e BE-së kundër pastrimit të parave brenda periudhës 2020-2021. Ligji ngarkon me detyrime specifike një kategori të caktuar profesionesh të lira, duke marrë në konsideratë standardet e FATF-së, por edhe natyrën e punës tyre, të cilat përveçse janë botërisht të pranuar, kanë mekanizma ndëshkimi në rastet e mosndjekjes dhe zbatimit, por për vendin tonë kanë forcë juridike të shtuar, pasi janë detyrim që rrjedh edhe nga neni 13 i konventës së Këshillit të Europës, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara në këtë projektligj do të mundësojë nxjerrjen e Shqipërisë në një kohë sa më të shpejtë nga lista e vendeve “nën monitorim të shtuar”, si dhe plotësimin e standardeve për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor me *acquis*-në e BE-së. Lidhur me personat e ekspozuar politikisht, për lidhjet e tyre familjare apo të biznesit, neni në fjalë u shërben subjekteve raportuese për mënyrën e trajtimit të marrëdhënies së biznesit me ta, ku DPPP-ja nuk synon të gjejë pasuritë specifike, që teorikisht burojnë nga korrupsioni, por kur subjektet raportuese veprojnë me këta persona, duke përfshirë familjarët apo persona me lidhje të ngushta personale apo biznesi, duhet t’i trajtojnë me vigjilencë të zgjeruar dhe të kërkojnë prej tyre më shumë sqarime dhe justifikime.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komision, në kuadër të përmirësimit të tij, janë miratuar edhe disa shtesa e ndryshime të nevojshme, të cilat paraqiten në variantin final, sikundër janë: riformulimi i nenit 1 për sa i takon përkufizimit të fjalës “klient”, me qëllim që të ketë një ndarje më të qartë të marrëdhënies së biznesit dhe transaksioneve rastësore, si dhe për të shmangur edhe ndonjë kërkesë jo proporcionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave apo inspektimet që ajo realizon.

Gjithashtu, disa ndryshime janë bërë për saktësimin e personit të ekspozuar politikisht dhe për shtimin e neneve të reja plotësuese, duke marrë në konsideratë propozimin e shoqatave të bankave, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet financiare jobanka.

Nisur nga këto që parashtrova, unë mendoj se projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar” duhet miratuar.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Flutura Aça.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar shqiptarë kudo që të jeni,

Për 30 vjet keni pyetur shpesh me të drejtë: ku janë paratë tona?

Ngrini sytë rrotull të shurdhuar nga zhurma e betonierëve dhe mendoni: para ka, por para nuk ka.

Më lejoni t’jua vizatoj sipas mënyrës sime vendin se ku fshihen paratë tona!

Në një nga mbrëmjet e fundit, për shkak të rrebeshit të shiut, mbeta e ngujuar në një taksist në trafikun e Tiranës, kështu që taksisti pati kohë të mjaftueshme të shante e të mallkonte ndërtimet që e kishin ngulfatur kryeqytetin tonë dhe të më tregonte një histori taksish, nga ato që e kalojnë edhe fikshënin. Para meje kishte përcjellë njëfarë prokurori, i cili kishte sharë mo Zot më keq trafikun e çmendur të Tiranës. “Pse nuk e dënoni njeriun që shkatërroi Tiranën”, - kishte pyetur taksisti me naivitet, duke nënkuptuar dorëzanin e Bashkisë së Tiranës që ka firmosur plot 3,6 milionë metra katrorë ndërtime në Tiranë vetëm në 3 vjetët e fundit, ndërtime, të cilat rreth 60%

të burimeve të financimit i kanë pasur të pambuluara në momentin kur janë firmosur.

I zënë ngushtë nga pyetja e taksistit, që të mos e ulte imazhin e epërm që populli ka për shtetin e vet, prokurori i tha: “Po si ta dënojmë ne kryeministrin e ardhshëm të Shqipërisë?”. Kjo është historia dhe ky është perceptimi që i keni dhënë ju shtetit për pinjollët tuaj bastardë në politikë.

Vetëm mbrëmë nga një udhëtim deri në Fushë-Krujë, serbatori i makinës sime nga 270 km të mundshme udhëtimi në nisje, shkoi në 560 km në kthim. Pra, plot 160 km udhëtim imagjinar për 60 km udhëtim real. Me një llogari të thjeshtë prej staticieneje, për 100 mijë shqiptarë (ta zëmë se aq lëvizin në ditë), që hyjnë e dalin në Tiranë dhe që udhëtojnë të paktën 100 km në ditë, u duhet të harxhojnë 2,7 orë më shumë, pra 270 mijë orë, ose 11 250 ditë kalendarike, duke i pandehur shqiptarët edhe udhëtarë nate, edhe pse e dimë se ç’ferri është të udhëtosh natën nëpër Shqipëri. Pra, shkurt, shqiptarët në një ditë në trafikun e Tiranës harxhojnë plot 32 vjet jetë, ose më mirë në një vit humbin 11 shekuj. Po marr parasysh edhe marzhin e gabimit tim, po them plot 10 shekuj! Sa për karburantin, bëjini llogarinë vetë fare thjeshtë nga shifrat që sapo ju përmenda. Llogarisni pastaj stresin, smogun e sakatimin mental që kemi pësuar të gjithë ne bashkë.

Pyetja është: kush ua paguan shqiptarëve 10 shekuj humbje në një vit vetëm prej këtij urbanizimi të ethshëm, të frikshëm e në shërbim të mafies së ndërtimit, e cila është tani, në fakt, pushteti i vërtetë në këtë vend dhe e ka kthyer këtë vend në lavatriçen e pastrimit të parave të krimit në Europë e në botë. Përse nuk ua kurseni shqiptarëve këtë humbje? Sepse nuk keni virtyte, se kursimi, sipas Ciceronit, është mëma e të gjitha virtyteve dhe juve ju mungon kryevirtyti që t’ua kurseni kohën shqiptarëve. Hidhni sytë rrotull, të nderuar shqiptarë dhe shikojeni vendin ku janë betonuar paratë tuaja. Ato i qarkullon pushteti, jo mileti. Provoni t’ia merrni ato para! Nuk ia merrni dot, sepse, kur ai jua zë dritaret me një pallat ngjitur, që mbin gjithë natën para syve tuaj, ju jeni duke zapuar televizionet “Basha-Berisha, Basha-Berisha”. Nuk ia merrni dot, sepse, kur ai ju shemb pa gdhirë Teatrin Kombëtar, ju prisni t’jua bëjnë betejën të tjerët, mbase edhe fantazmat. Nuk ia merrni dot, se, kur

një birbo komunist jua jep për mëngjes, ditën e festës kombëtare të pavarësisë portretin e Enverit, ju hutoheni pas videoklipit të radhës që Kryeministri jua hedh si karamelle. Nuk ia merrni dot, sepse, kur e gjithë bota proteston në rrugë kundër regjimeve, ju argëtoheni në rrjetet sociale dhe harroni se beteja bëhet përballë dhe jo pas shpine.

Ja ku e kemi para syve mafien tonë të dashur që na ka kthyer të gjithë në lavatriçe, kush prej heshtjes dhe kush prej flirtit me këta. Nuk është pa aq arsye që në nivelet e *Wikipedia*-s vitet e fundit është pasuruar shumë zëri “*Albanian mafia*” me të gjitha hollësitë se si një Shqipëri e vogël më në fund ia ka dalë të kontrollojë botën e madhe, po, por në pastrimin e parave.

Nuk është pa arsye që është kthyer në humor të salloneve të ambasadave një prej përgjigjeve epike të mikpritësve holandezë ndaj ish-Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili nga dëshira e madhe të dokëndiste holandezët, u tregoi atyre se shqiptarët e kishin mësuar hashashin prej holandezëve dhe se shqiptarët zinin një përqindje shumë të vogël mes kriminelëve në Holandë. Përgjigjja e të zotëve të shtëpisë ishte: “Po, zotëri, por nuk po flasim për sasi, por për cilësi”. Ne, pra, kemi krim me cilësi shumë të lartë, sepse krimin e kemi edhe këtu në parlament me ligjet që kalojnë.

Me shijen e hidhur të këtyre takimeve dhe e dëshpëruar nga vetoja kundër e holandezëve në lidhje me çeljen e negociatave, qeveria shqiptare nuk la gur pa lëvizur me vite të tëra për ta shitur këtë si problem të brendshëm holandez, duke ua pikturuar shqiptarëve Holandën si delja e zezë e Europës, si vendi që ishte kundër shqiptarëve që po i diskriminonte ditën, kur e gjithë Europa mezi priste që ata të hynin. Ju kujtoj se është po ajo Holandë që i kushtoi faqet e para të gazetave duke dënuar me javë të tëra gjenocidin serb në pranverën e vitit 1999.

E vërteta është krejt ndryshe: Holanda ka vetëm një shqetësim: rrjeti i rrezikshëm kriminal që kalon përmes saj apo vepron në zemër të saj, qarkullon aq shumë para, sa ka pushtuar tani tregun e drogave të rënda të Europës dhe e kontrollon atë plotësisht dhe këto para pastrohen në Shqipëri, në mes të Tiranës, te këto fallusët që na zgjohen çdo ditë. Por as kjo nuk është, në fakt, frika më e madhe e këtyre ligjvënësve

holandezë, por mundësia që shuma të tilla parash të blejnë qeveritarë e ligjvënës holandezë, të ndryshojnë ligje dhe t'u helmojnë holandezëve demokracinë e tyre të ngritur me aq mund. Jo vetëm aq, por një pjesë e këtyre parave investohen në terrorizëm, pasi ju e dini se Shqipëria ka vite që është kthyer në rrugë vreshti mes Lindjes dhe Perëndimit.

Me këtë merak të madh në zemër e për ta zbutur këtë fëmijë të pabindur portokalli, qeveria shqiptare u hodh në sulm frontal për t'ia blerë zemrën.

Çfarë ceremonish pompoze pritjeje e përcjelljeje ambasadorësh, çfarë përdëllimi për t'u shërbyer, e kuruar deri në detaje, kërkesave të shpurës ambasadorake në Shqipëri dhe të familjarëve të tyre! Doni shembuj? Asgjë nuk është publike, por, po të kishin gojë muret e të flisnin, do të na e tregonin të vërtetën. Jo vetëm kaq, por keni paguar para edhe për “*Big Brother*”-in holandez. Po jua përsëris. Mos u çudisni fare. Për reklamë këta blejnë edhe Zotin. Të marrë mundimin dikush nga paria këtu e ta bëjë publike për shqiptarët se sa para u kemi paguar ne kompanive të argëtimit në Holandë, njëfarë IDTV-je. Kur të bëjnë transparencë këta, do ta marrin vesh të gjithë..

Prisni, se ka edhe më. Ja, pak ditë më parë mbërriti këtu edhe Kryeministri holandez, i fundit i Mohikanëve të pabindur të Europës. E çfarë nuk u fol për këtë takim të madh historik. E, në fakt, në këtë takim nuk ka asgjë historike, pasi Kryeministri holandez, *Rutte*, pas zgjedhjeve të fundit atje, nuk ka asnjë mandat, vetëm të firmosë ndonjë emergjencë të pandemisë. Mandati i vetëm që kishte ai, ishte të na buzëqeshte, sepse nuk është më i mandatuar. Në fakt, ai buzëqeshi për të qetësuar frustrimin e shqiptarëve të mërzitur me qeverinë holandeze, që nuk po i gjen dot rrugët t'i bindë ligjvënësit për të dhënë një “Po” për Shqipërinë. Në fakt, ligjvënësit holandezë e dhanë “Po”-në, por e dhanë për shqiptarët, jo për qeverinë shqiptare.

*Rutte* e dinte mirë se ku po vinte e me kë po fliste e me çfarë rafinatosh po takohej; e dinte se ishte në mesin e qeverisë më të korruptuar në Europë, dhe të tretës nga fundi në botë, për sa i takon kujdesit ndaj mirëqenies së popullit të vet. Është po ajo qeveri që firmos lejet e ndërtimit ku pastrohen paratë e trafikantëve dhe kriminelëve, të cilët ua kanë prishur prej vitesh gjumin

holandezëve, qysh nga 2016, koha kur u ngrit “instituti shqiptar i kanabizimit”.

Nuk e di nëse *Ruttës* iu dhurua ndonjë çelës Tirane, por në nder të simbolit të kohës që jetojmë, e mira e do që maskota e Tiranës të mos ishte një çelës, por një betoniere. Fundja një betoniere është tani një nga reliket e sallonet mondane të bashkisë së Tiranës, një orendi e zyrtë, që të vetmit që ngazëllehen, janë ideuesit e saj, pasi shqiptarët kanë mbetur në trafik rrugëve të Tiranës, duke bluar ato dhjetë shekujt për të cilët ju fola.

Me këto që flet, do të thoni ju, ti je kundër urbanizimit. Madje, keni mbajtur edhe leksione këtu në parlament se ç'është betoni. Kurse unë po ju them: nuk jam kundër urbanizimit, zhvillimit, gjeneralizmit të Tiranës, por nuk mund të fus dot 1, 5 milion metra katrorë të ndërtuar në vitin 2019 në Tiranë, në 539 mijë metra katrorë ndërtime të nevojshme në raport me numrin e familjeve rishtare në Tiranë të po atij viti. Nuk më del kund llogaria, sepse sipas kësaj logjike, Tirana është ndërtuar si të ishte qytet me 15 milionë banorë, kur në fakt nuk është as 1 milion banorë.

Në këto 3,6 milionë metra katrorë me ndërtime në tre vjet nuk është respektuar asnjë parametër minimal në raportin mes fjetinave betonarme të Tiranës, me qendrat mjekësore, shkollat, kopshtet, gjelbërimin, parqet e lodrave, rrugët, teatrot, trotualet, shatërvanët, muzetë, një krim kombëtar i paretusheshëm. Kështu janë ngurosur paratë e shqiptarëve.

Shqiptarë, hidhini sytë rrotull 360 gradë, siç na këshillonte gjatë fushatës pinjollit mavi që mëton të bëhet shefi i madh mavi, por mbajini mbyllur ose mbani në xhep ndonjë trinitrinë!

Për ta mbyllur, po citoj një shkollat të madh: “Paratë ndonjëherë kushtojnë shumë”, ndërsa paratë e shqiptarëve janë të pavlefshme, sepse janë katër, pesë apo dhjetë milionë euro metri katror, pasi dalin krejt të pastra nga lavatriçja e pushtetit dhe e bashkëpunëtorëve të saj, mafies.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Sorina Koti. Të përgatitet zoti Dashnor Sula.

**Sorina Koti** – Të nderuar qytetarë,

Sa shumë e kemi dëgjuar togfjalëshin “pastrim paraje” dhe kryesimin e Shqipërisë në këtë çështje.

Fenomeni i pastrimit të parave ka shumë vjet që thellohet në Shqipëri, por, në të njëjtën kohë, edhe sofistikohet si proces. Ky projektligj duhet të ashpërsonte kontrollet, parandalimet, por, mbi të gjitha, edhe penalizimet.

Shqipëria konsiderohet një vend i varfër, në tranzicion, por që qarkullon një shumë të madhe parash jashtë sistemit bankar. Për sa kohë që kemi një ekonomi informale 30 - 40%, një nivel korrupsioni dhe evazioni të lartë, edhe qarkullimi i parasë jashtë sistemit bankar do të jetë shumë i lartë.

Pa dyshim që nuk mund të themi se të gjitha paratë, që qarkullojnë jashtë sistemit bankar janë të pista, që vijnë nga aktivitete kriminale, por këtu duhet të ndërhyjë shteti me institucionet e tij për të parandaluar dhe për të ndaluar krimin e organizuar që ka filluar të lulëzojë.

Shumë prej jush mund të thonë që këto para janë fituar me mund e djersë dhe, përderisa investohen në Shqipëri, ne mirë kemi, pasi jemi një vend i varfër.

Po, për fat të keq, ne jemi një vend i varfër, pa një shtet serioz dhe pa rregulla loje, pasi ky shtet po na sjell një projektligj të bazuar në programin politik të vitit 2017. Ne jemi të varfër, sepse nuk funksionon drejtësia dhe shteti ligjor.

Shqipëria renditet në vendin e parë në rajon dhe në Europë për pastrimin e parave. Kjo renditje ndikon drejtpërdrejtë në perceptimin e investitorëve të huaj dhe grupeve të interesit për ekonominë shqiptare, mundësinë për investime, konkurrencën e drejtë dhe të barabartë, si dhe zbatimin unik për të gjithë qytetarët.

Sipas institucioneve të specializuara, sektori më i prekur nga pastrimi i parave është ai i ndërtimit, me bumin e lejeve të miratuara nga bashkitë apo KKRRT-ja, pas premtimeve elektorale për zero kulla dhe më shumë hapësira të gjelbra për qytetarët.

Justifikimet apo shpjegimet zyrtare për rivitalizimin e sektorit të ndërtimit pas goditjes nga pandemia dhe kriza ekonomike apo nevoja për banesa dhe qendra tregtare, ndërkohë që stoku i tyre është ende i lartë, veçanërisht në kryeqytet, janë bajate dhe jo ekonomike.

Janë paratë e pista ato që mbajnë të larta çmimet e banesave të reja në këto zhbancime të mëdha midis ofertës dhe kërkesës, ashtu sikurse mbajnë nën presion edhe vlerën e lekut në raport me monedhat e huaja.

Të dhënat e publikuara nga Banka Botërore për vitin 2020 flasin për një rënie ekonomike të Shqipërisë me 8,4% për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-i. Ndërkohë, prej 3 vjetësh bankat e nivelit të dytë refuzojnë kreditimin e sektorit të ndërtimit për shkak të riskut të lartë që mban ky sektor, por edhe refuzimit të institucioneve ndërkombëtare bankare për të përzierë depozitat e qytetarëve me paratë e pista. Rrjedhimisht, lind pyetja: ku i gjejnë burimet e financimit 141 kompani, të cilat morën leje për të ndërtuar mbi 3,6 milionë metra katrorë në vitet e fundit? Si ia del një kompani e sapothemeluar, me kapital modest të regjistruar, që deklaroi bilancin e saj vjetor me humbje apo pa të ardhura, të ndërtojë një kullë apo një qendër tregtare me kosto disa milionë euro?

Një përgjigje të pyetjes së mësipërme e jep raporti ndërkombëtar për krimin e organizuar, sipas të cilit, nga 141 kompani që fituan leje ndërtimi në Tiranë, 59% e tyre nuk kishin burime financimi të mjaftueshme, ndërsa 60% e tyre mendohet se vijnë nga paratë e pista. Në total, për vitet 2017 - 2019 në Shqipëri janë pastruar mbi 1,6 miliardë euro. Por cilët janë blerësit? Sa janë mundësitë e familjeve apo qytetarëve për të blerë një shtëpi në Tiranë, ku çmimi mesatar për apartament shkon mbi 1 000 euro metri katror dhe niveli i pagës mujore mesatare është 420 euro apo edhe për faktin tjetër, që vetëm 5% e të punësuarve kanë pagë mbi 1 000 euro në muaj? Po blerësit e sipërfaqeve rezidenciale të banimit me çmime mbi 3000 – 4000 euro, cilët janë? Cilat janë burimet e tyre legale të pasurimit dhe sa janë këto investime në raport me fitimet apo pagat e deklaruara?

Ndërkohë, sa u përket procedimeve penale të regjistruara nga prokuroria lidhur me pastrimin e parave, rezulton se ato që janë të deklaruara dhe të paralizuar nuk zënë më shumë se 1% të dosjeve të depozituara. Këto fakte dhe të dhëna tregojnë qartë se sa serioze dhe alarmante është situata ekonomike në Shqipëri, për shkak të pastrimit të parave, por, mbi të

gjitha, edhe të përfshirjes së institucioneve shtetërore në mospenalizimin e tyre.

Ky është alarmi. Si fillim duhet të pastrojmë institucionet ligjzbatuese nga të korruptuarit, të forcojmë ligjet penalizuese mbi pastrimin e parave dhe të rikthejmë ekonominë në shinat e drejta të konkurrencës, mundësinë e barabartë për iniciativa investimi, qoftë për vendasit, qoftë për të huajt, duke besuar dhe punuar për tregun e lirë dhe të hapur, duke sjellë mirëqenie për çdo individ.

Faleminderit!

(Duartrokitje)

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Dashnor Sula.

**Dashnor Sula** - Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Sigurisht, seancën e sotme e konsideroj një seancë jashtëzakonisht të rëndësishme, përgjatë këtyre 3 muajve që jemi në parlament, pas seancës së buxhetit të shtetit. Kjo është seanca më e rëndësishme, pasi do të diskutojmë një projektligj jashtëzakonisht të rëndësishëm, siç e thashë më lart, por, fatkeqësisht, konstatoj se, në qoftë se do të ishin në sallë, qoftë deputetët e majtë, qoftë deputetët e djathtë, aq më shumë qeveria dhe Kryeministri këtu mbrapa, do të kishim një debat politik, pa pasur parasysh ndasitë politike. Qoftë të majtët, qoftë të djathtët duhet të ishin prezente këtu, që të flisnin dhe të jepnin mesazhe për këtë problematikë jashtëzakonisht të madhe që ka Shqipëria sot, atë të pastrimit të parave të pista. Ky nuk është një fenomen dhe një proces që po ndodh këta 8 vjet, që është në pushtet Partia Socialiste, por është një problem që ndodh prej 30 vjetësh. Por cili është ndryshimi? Ndryshimi është se nga viti 2013 e më pas, po jua them me sinqeritetin më të madh, duke ju dhënë të gjitha indikacionet, që të jeni të sigurt, pra gjatë këtyre 8 vjetëve, pastrimi i parave në Shqipëri ka marrë një hov jashtëzakonisht të madh dhe këtë duhet ta pranojmë të gjithë.

Pra, në luftën kundër pastrimit të parave nga organizatat kriminale në Shqipëri, opozita nuk duhet të jetë e vetme, por duhet të jemi të gjithë bashkë, maxhorancë dhe opozitë, nëse duam ta fusim Shqipërinë në binarët e drejtë të investimeve të ndershme, reale, si dhe të triumfojmë biznesi i ndershëm.

Të nderuar kolegë,

Duhet të kemi parasysh që organizatat kriminale janë tepër të interesuara në çdo sekondë, minutë, orë, ditë, javë, muaj, vit, duke bërë të pamundurën që të pastrojnë paratë nëpërmjet investimeve, pra me paratë e fituara nga droga dhe nga prostitucioni në Europë. Ju e dini fort mirë, nuk është sekret, që në portin e Durrësit, në pikat doganore të Kakavijës, të Hanit të Hotit apo edhe në pika të tjera kufitare, kapen mijëra dhe miliona euro, para kesh, të cilat vijnë nga organizatat kriminale dhe që më pas injektohen në ekonomi. Sigurisht, maxhorancës i vjen për mbarë të mbyllë sytë, të mbyllë veshët, aq më tepër që segmente të caktuara të maxhorancës janë të lidhura me këto organizata kriminale, për të bërë të mundur pastrimin e këtyre parave dhe për t'i injektuar më pas në ekonomi, sepse kjo maxhorancë nuk e mban dot ekonominë në mënyrë të ndershme. Ky është problemi kryesor.

Unë dua t'ju them se cilat janë fushat dhe sektorët ku tenton krimi i organizuar të bëjë pastrimin e parave.

Maxhoranca e sotme, në mos gaboj, në vitet 2014- 2015 ndërmori një nismë "Fundit i marrëzisë" për sa u përket lojërave të fatit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Çfarë ndodhi? Ndodhi që kjo maxhorancë i grupoi këto lojëra në katër-pesë duar.

Po ju them që, duke pasur parasysh edhe eksperiencën time kur kam qenë në Prokurorinë e Përgjithshme, në Drejtorinë e Antimafias, shumica e organizatave kriminale, persona të caktuar, të cilët tentojnë të pastrojnë paratë, i bëjnë këto nëpërmjet subjekteve të cilat kanë kazino. Çfarë fenomeni ndodh? Subjekti që tenton të bëjë këtë pastrim parash, me 5% ose me 10%, i fut paratë në injektim në këto kazino dhe pastaj merr pjesën tjetër, rreth 50% apo 100%, që ai do t'i fitojë nga kjo kazino. Ai nëpërmjet kësaj loje bën një pastrim duke i dhënë 10% në dorë pronarit të kazinosë, i cili, gjithashtu, ka përfitimet e veta. Çfarë ndodh? Të gjitha këto para që investohen, që fitohen nga kazinotë, dalin pastaj dhe investohen në ndërtime.

Nuk duhet të mbyllim sytë dhe të bëjmë sikur nuk shohim apo nuk dëgjojmë. A ka logjikë ekonomike, sidomos në qytetin e Tiranës, të Durrësit, të Vlorës, të Sarandës apo edhe në resortet turistike, të cilat investohen dhe

ndërtohen nga persona që kanë të ardhura të dyshimta, në një kohë që 12 banka të nivelit të dytë në Shqipëri, përgjatë dy vjetve të fundit nuk kanë tentuar ose kanë frenuar kreditimin e subjekteve të ndërtimit, për shkak të riskut të madh që ato kanë si banka për t'i rikthyer ato kredi që jepen; që ndërkohë investimi jo vetëm që s'është ulur në ndërtime, por është dhjetëfishuar? Pra, ka vetëm një emër: ka para të pistë të injektuara në ekonomi dhe, sigurisht, kjo bëhet nga ana e maxhorancës, nga deputetë apo funksionarë të lartë të Partisë Socialiste ose të qeverisë, të cilët u krijojnë mundësinë të bashkëpunojnë dhe t'u hapin rrugën këtyre investimeve.

Duhet thënë që ky projektligj i sotëm është shumë i rëndësishëm, madje unë si deputet, por edhe forca jonë politike do ta votojmë pro, pa diskutim, por e keqja nuk është te ky projektligj. Ne, sigurisht, kemi ligje, por ku është problemi? Problemi është zbatimi i këtyre ligjeve.

Pastrimi i parave nuk realizohet vetëm në sajë të punës që mund të bëjë Drejtorja e Parandalimit të Pastrimit të Parave, por janë një sërë strukturash, të cilat do ta realizojnë këtë gjë. Në radhë të parë, në Policinë e Shtetit kemi një sektor të veçantë, që ka të bëjë me krimin ekonomik, i cili heton personat ose subjektet që bëjnë pastrim të parave apo kryejnë transaksione të dyshimta. Inekzistent. Nuk kemi referime nga ana e sektorit të krimit ekonomik në Policinë e Shtetit të veprave penale në prokuroritë e rretheve, kudo që janë ato, në mënyrë që të bëjnë të mundur ndjekjen e këtyre personave. Por mbyllin sytë e veshët, madje janë edhe bashkëpunëtorë.

Kemi fazën e dytë, që është prokuroria, e cila ka për detyrë të fillojë procedimet penale për subjekte të veçanta apo persona fizikë dhe juridikë, të cilët kanë të ardhura të dyshimta, bëjnë investime milionaeuroshe me imobilare apo me objekte të pasurive të paluajtshme. Ku? Si ndodh? Për këtë qoftë noterët e Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë informimin e parë për një transaksion që bëhet për sa u përket pasurive të paluajtshme, por edhe bankat, të cilat rast pas rasti nuk i bëjnë, kanë detyrimin të njoftojnë. Sigurisht, ne e dimë që pjesëtarë bandash të caktuara janë të përfshirë në këtë lloj procesi për të përfutur dhe për të bërë diçka të tillë. Këto raste i pamë, siç ndodhi së fundi me 18 milionë

euro, që tentuan për t'i pastruar nëpërmjet "Ndragheta", mafia e Italisë në Shqipëri, sepse fakti tregon që, përderisa ka tentativa të tilla, ndodh dhe është e sigurt që ka terren ku kjo realizohet, në sajë të mbështetjes së tyre.

E thanë edhe kolegët e tjerë: a ka logjikë biznesi, logjikë ekonomike që një firmë e krijuar nga një 20-vjeçar, nga një 25-vjeçar, me një kapital themeltar 1 milion lekë të vjetër të marrë leje ndërtimi në qendër të Tiranës për ngritjen e kullave?! A ka logjikë ekonomike që pas ndërtimit të mijëra metrave katrorë banesa përgjatë këtyre 2 vjetve në Shqipëri të kemi, sidomos në Tiranë, 10500 banorë të shtuar? Ndërkohë që, po të bësh një llogari, në Tiranë janë rreth 4000 familje. I bie që në Tiranë të jenë shtuar, pra po ta bësh llogari, nga 4 anëtarë secila familje, i bie rreth 16 mijë persona. Domethënë, mund të duheshin rreth 500-600 mijë metra katrorë sipërfaqe ndërtimi, në një kohë kur kemi mijëra dhe miliona metra katrorë sipërfaqe ndërtimi. Absolutisht, unë dhe gjithë forca jonë politike nuk jemi kundër zhvillimit të biznesit, kundër zhvillimit të Tiranës, të qyteteve të tjera apo të industrisë së ndërtimit, por kini parasysh që biznesi ndershëm ai, i cili investon me kredi dhe me para të pastra e ka të pamundur për t'i konkurruar paratë dhe investimet e subjekteve që injektohen nga trafiku i drogës dhe i prostitucionit. Ky është problemi më kryesor. Nëse një person, i cili mund të ketë kursyer mijëra euro përgjatë viteve, do të hapë qoftë edhe një biznes, një bar-kafe, 5, 10 apo 100 metra më tutje, e hap një kriminel, një i ashtuquajtur biznesmen me paratë e drogës, i cili falimenton biznesin e ndershëm. Kjo është problematika.

Të nderuar kolegë, absolutisht nuk i paragjykoj firmat, të cilat kanë ndërtuar në qendër të Tiranës, sepse nuk mund ta paragjykoj se nuk i ka financimet e pastra, por do t'ju bëjë me dije që të shikojmë se ku ndodh bashkëpunimi i Bashkisë së Tiranës me lejet e ndërtimit në Shqipëri. Të gjithë jeni dëshmitarë, të majtë e të djathtë, që ndërtimi i bërë ngjitur me Kullën e Sahatit të Tiranës, është 5 metra larg nga Kulla e Sahatit dhe 5 metra larg nga Bashkia e Tiranës, a ka logjikë? Si mund të ndodhë një gjë e tillë? Shikojeni!

Çfarë është kjo? Mos e dhëntë Zoti që Erion Veliajt dhe Kryeministrit tuaj t'u teket të

heqin edhe xhaminë e Tiranës nga aty dhe ta bëjnë përsëri pallat. Është për të ardhur keq!

Presidencën e zaptuat, teatrin e operës e zaptuat, Kullën e Sahatit e zaptuat, ju dhëntë Zoti rrugë që ju të mos vini ndonjë ditë... Të jeni të sigurt që pas 10 vjetësh ky parlament, ku po flasim sot, nuk do të jetë. Akademinë e Shkencave e kanë privatizuar, po e marrin pronarët; po tentohet të bëhet marrëveshje me pronarët që të ikin edhe Akademia e Shkencave, edhe kjo sallë e parlamentit dhe ta fshini të gjithë memorien që ka ky vend për këta 30 vjet apo për këta 100 vjet.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve.

Fjalën e ka zoti Oerd Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Projektligji i sotëm, që bën ndryshime në ligjin “Për pastrimin e parave”, qartazi është kërkesë e organizatave ndërkombëtare, pra nuk është një nevojë që vjen nga qeveria, e cila do të luftojë krimin e organizuar dhe pastrimin e parave që bën krimi i organizuar në Shqipëri. Na e kërkojnë, dhe kjo është fare e thjeshtë: është një tregues se si na shikojnë këto organizata ndërkombëtare për sa i përket nivelit ku kriminaliteti i organizuar, krimi transnacional, mafia dhe ku roli i krimit të organizuar shqiptar ka arritur; ashtu na shikojnë ne. Pra, na kanë futur në listën gri për sa i përket pastrimit të parave, por ne jemi me pullë të kuqe kur vjen puna për përfshirjen e krimit në të gjitha sferat e qeverisjes dhe të jetës ekonomike.

Diku na fillimi i vitit Kryeministri Rama tha: “Pastrimi i parave ndodh në të gjithë botën, kudo ndodh; edhe në Shqipëri nuk ka ndonjë ndryshim, është njësoj si kudo tjetër”. Gjithmonë, kur gjendet në vështirësi, ai përpiket ta relativizojë, ta zvogëlojë. Kjo ndodhte pikërisht (besoj se e kujtoni) në fillim të vitit kur dolën përgjimet për një çështje të rëndësishme, që është çështja “Galo” në Shqipëri, ku përgjimet e antimafias italiane, në kuadër në një megaoperacioni antimafia, ku goditej mafia më e pasur italiane “*Ndrangheta*”, nxirrnin në përgjime emra ose funksione të larta qeveritare, deri te Kryeministri apo të pushtetit vendor, për kontakte të krimit të organizuar deri në këto nivele apo tentativa për të penetruar deri atje.

Ajo çështje e bëri Kryeministrin të dalë me urgjencë, por edhe të tjerët që të përpiqen ta zvogëlojnë, t’i ulin profilin çështjes. Ky Antonio Galoja i famshëm kishte hapur vetëm një dyqan të vogël në qendër të Tiranës për disa materiale për përdorim veshjeje pune, prandaj u përpoq t’i ulte profilin. Në fakt, në Itali ky rast njihet me termin “*basso profilo*”, profil i ulët, sepse ishte ekzakt motoja e asaj organizate mafioze, të mbanin profilin e ulët, në mënyrë që të mos dukeshin, ndërkohë që pas dyqaneve të thjeshta, siç e thotë zoti Rama, materialeve të veshjeje të punës, bënin operacionet e tyre të paligjshme. Ky është një nga megaproceset antimafie në Itali, i cili është në zhvillim e sipër sot, por në ato përgjime kanë dalë edhe personazhe shqiptare, përfshirë, sipas atyre përgjimeve, edhe zyrtarë të lartë, qeveritarë dhe politikanë.

Po flasim për përgjimet e viteve 2017-2018. Çfarë shohim në ato përgjime?! Po t’i hapni dhe t’i lexoni del që një nga aktivitetet kryesore të organizatës mafioze dhe të mafiozëve, që sot janë në këtë maksiproces në Itali, ishte pastrimi i parave në Itali nëpërmjet shqiptarëve, por edhe në Shqipëri. Përgjimet e nxorën këtë. Dua t’ju citoj diçka nga përgjimet, ku Antonio Galo, modeli i biznesmenit mafioz, pjesa tjetër e ekuacionit, që ishte mafiozi biznesmen, ky personazh me lidhje të forta me politikën, me biznesin, me krimin e organizuar jo vetëm në Itali, por edhe në Shqipëri, i cili kishte hapur kompaninë e tij në Shqipëri, që, sipas përgjimeve italiane, punësonte familjarë personazhesh italianë në biznesin e tij në Shqipëri dhe u jepte rrogën në këmbim të veprimtarisë mafioze, thotë: “Kam folur me Nikun, me mikun tim, Nik, i cili më ka thënë që njërit, që ka marrë tri licenca në Tiranë për ndërtime gradacelash, i duhen 180 milionë euro, por ka vetëm 10 milionë euro”. Ai vazhdon dhe thotë: “Ata kërkojnë financierë, të gjejnë sipërmarrës të besueshëm që bankat mund t’i financojnë”, pra përfshijnë edhe sistemin bankar në lojë, në skemat e tyre mafioze. Pra, sipas përgjimeve, ata kanë arritur të penetrojnë në kontakte deri në nivelet më të larta të politikës dhe të qeverisjes në Shqipëri, por ajo që është shumë e qartë është se Shqipëria për ata është një terren shumë fertil për sa i përket pastrimit të parave. Pra, ne kemi pasur një legjislacion shumë të fortë, i cili na e bllokonte pastrimin e parave, nuk duhet të ishim keq për sa i përket luftës ndaj

pastrimit të parave, por ja që është e nevojshme ta shtrëngojmë, sepse askush nuk na beson. Ne jo vetëm që kemi gropa në legjislacion, por, edhe duhet të godasim faktin që qeveria nuk vepron. Pse?! Sepse është pjesë e të gjithë kësaj historie.

Ju e dëgjoni që Rama thotë se ne i quajmë shqiptarët “budallenj”, por mjafton të shohim ndërtimet në Tiranë, anekënd, por në mënyrë të veçantë gradaçelat që po ndërtohen pa fund në Tiranë, tregon që Rama mendon se shqiptarët janë budallenj. Të gjithë e shohin, askush nuk ka para për të ndërtuar në këtë nivel dhe e gjitha kjo është një histori gjigande pastrimi parash. Pra, plani rregullues i Tiranës dhe i qyteteve të tjera të rëndësishme të mëdha janë tepsia e bakllavasë për krimin e organizuar për të pastruar para. Secili gjen llokmën e tij dhe pastron me dhjetëra dhe qindra miliona euro në këtë kryeqytet, në të gjithë Shqipërinë dhe në qytetet e mëdha kryesore.

Edhe projektet e mëdha, ose PPP-të e mëdha e kanë riskun shumë të madh, sepse një nga mekanizmat kryesorë që ka mafia për të pastruar paratë dhe për të kontrolluar ekonominë e ligjshme është procesi i tenderimit dhe i nënkontraktimit, nuk ka asnjë kontroll për këtë. Kjo është tipike për mafien, kjo po ndodh edhe këtu, sidomos centralizimi në pak duar, ku më pas puna duhet të bëhet me nënkontraktim, pasi një kompani nuk i bën të gjitha tenderët, apo ato 10 kompani nuk i bëjnë të gjitha tenderët, dhe më pas, dalëngadalë, kaskadë, puna shkon në duart e mafies, paratë e buxhetit të shqiptarëve përfundojnë në duart e mafies dhe në këtë proces pastrojnë edhe paratë. Mjafton të shihni çfarë po ndodh në Tiranë dhe e kuptoni shumë mirë që kjo është një ftesë për krimin e organizuar: “Ju japim leje, vazhdoni dhe ricikloni para, po gjetët mjaftueshëm mekanizma, fusim edhe këtë ligj sot, që duket sikur ne kemi bërë barrierat e mjaftueshme dhe ju vazhdoni më tej.

Ky projektligj nuk është asgjë tjetër veçse një shtesë në manualin e lavatriçes së parave. Në fakt, lavatriçja e parave është kjo qeveri dhe i pari sot këtu duhet të ishte Kryeministri, por ka vetëm 2 ministra. Kjo qeveri, me mënyrën se si qeveris, me mekanizmin ekonomik që ka dhe me atë që po bën, në fakt, është lavatriçja më e madhe e parave dhe ky projektligj është vetëm shtesë në këtë manual, se si pastrohen paratë; është indikator që kjo qeveri ka dështuar me

qëllim zbatimin e ligjit ekzistues. Kjo është rruga më e mirë për të bërë diçka tjetër, për të pasur para, për të kthyer në mekanizëm të pastrimit të parave edhe diçka tjetër: procesin zgjedhor; është një nga mekanizmat më të mëdhenj, ku krimi i organizuar së bashku me qeverinë riciklon, pastron paranë me një funksion tjetër: për të kapur pushtetin. Është ekzaktësisht e njëjta gjë që bënte edhe organizata ku është përfshirë Antonio Galo, pra Ndragheta, pjesë e këtij mekanizmi është: “Të jap vota, më kthe tenderë dhe interesa të tjera ekonomike” dhe në të gjithë këtë proces riciklohet paraja kriminale si në Itali, ashtu dhe në Shqipëri. Pra, ne jemi bërë një platformë perfekte për mafien e rrezikshme ndërkombëtare, ku krimi i organizuar është pjesë integrale ndër të tjera edhe për pastrimin e parave.

Nëse ka diçka që e rrënon politikën e një vendi është korrupsioni politik, i cili financohet nga dy drejtime: nga korrupsioni qeveritar, që riciklon paranë, dhe nga krimi i organizuar, që nëpërmjet kanaleve që i krijon qeveria riciklon paranë.

Prandaj ne sot këtë ligj, sigurisht, duhet ta miratojmë, se i shtrëngojmë hapësirat pastrimit të parave, por të mos besojë njeri që një qeveri, që përdor paranë për të blerë vota, do të luftojë pastrimin e parave në këtë vend.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Bushka.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, projektligji që kemi diskutuar deri në këtë moment, paraqet disa shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Është e disata herë që ndërrohet ky projektligj, ku synimi është të forcohen masat për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në fakt, në përfundim të diskutimeve, duhet të them që më vjen mirë që të gjithë anëtarët e Kuvendit që kanë votuar, apo ata që kanë shprehur votën, do të jenë pro këtij projektligji, duke treguar edhe një herë rëndësinë që ai ka për të gjitha masat që ndërmerr Shqipëria në luftën kundër këtyre fenomeneve negative, që, në fakt, janë sfidë jo vetëm për vendin tonë, por edhe për vendet më të zhvilluara.



I dëgjova kolegët e opozitës, të cilët nuk kundërshtuan ligjin, por mënyrën se si ka vepruar Shqipëria me masat kundër këtyre fenomeneve negative, duke u bazuar në fakte që nuk janë të vërteta, ku shumica janë perceptime dhe merr një histori atje, merr një raport OJF-je këtu e trilloje. Fjalët e këtyre raporteve, “mund”, “dysshohet”, kthehen në “janë”, “kështu ndodh”, “kjo është e vërteta”. Kolegë, përpiqeni të bëheni prokurorë, hetues e gjyqtarë. Në fakt, e vërteta nuk është kështu. Unë nuk do të hy në çdo histori, sepse edhe nga ministrja e Financave, edhe gjatë diskutimit të këtij projektligji nëpër komisioneve, për çdo pretendim të ngritur morët përgjigje me fakte e shifra. Shqipëria është pjesë e të gjitha organizmave ndërkombëtare, që rrisin përpjekjet për të luftuar edhe pastrimin e parave të pista, edhe financimin e terrorizimit, sepse bëhet fjalë për krime dhe për veprime, të cilat janë të sofistikuara dhe janë sfidë më vete dhe për organet ligjzbatuese, dhe për organet e drejtësisë jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Ne kemi me vullnet këtë dhe e kemi treguar si vend. Maxhoranca socialiste në gjithë këto vite i ka treguar përpjekjet e veta për të bërë luftë pa kompromis me këto fenomene negative dhe kriminale të shoqërisë.

Ju kujtoj se në vitin 2013, në kohën kur ju sapo e latë pushtetin, Shqipëria u fut në listën gri dhe u nxor në 2015-n nga maxhoranca socialiste, por ne nuk do të rrimë këtu të bëjmë analizën si e bëtë ju atëherë e si e bëmë ne sot, sepse përpjekjet kundër pastrimit të parave të pista janë interes kombëtar. Të gjithë së bashku duhet të bëjmë detyrën tonë. Cila është detyra jonë, si Kuvend? Ne si Kuvend na takon të mbështesim nismat që vijnë për të forcuar mekanizmat kundër këtyre fenomeneve, për të monitoruar zbatimin e ligjeve, në mënyrë që të kenë efekt në praktikë, për të ndihmuar institucionet ligjzbatuese, që të kenë rezultate dhe, nëse mundemi, nëse kemi fakte apo dyshime të arsyeshme, të kontribuojmë, duke i dërguar këto fakte në organet përgjegjëse. Kjo është detyra jonë.

Në fakt, është e vërtetë, ky projektligj është një përafrim i plotë me direktivën e Bashkimit European për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

Nuk është e vërtetë, siç tha zoti Spaho, që nuk ka fare përafrim, këtë e vërteton qartë raporti i Komisionit për Integrimin European, i cili e ka diskutuar dhe miratuar këtë ligj, dhe e ka parë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe në përputhshmëri të plotë me rregulloren e Bashkimit European.

Nga ana tjetër, ky përafrim që bëjmë ne, nëpërmjet këtij projektligji, nuk është e vetmja arsye përse vjen në Kuvend nga qeveria, por ai vjen edhe në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë që në vitin 2013, ku kjo qeveri ka bërë përpjekje konsistente kundër luftës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizimit. Në vazhdim e kësaj, unë do t'ju përmend çfarë është bërë deri më sot dhe ku jemi me këtë ligj, i cili nuk është hapi i fundit që do të ndërmerret në kuadër të këtyre përpjekjeve dhe të kësaj lufte, që është interes kombëtar.

Përveç faktit që forcohen mekanizmat e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, ligji krijon mekanizma për bashkëveprim efektiv mes institucioneve ligjzbatuese dhe organeve të drejtësisë; shton rrethin e subjekteve raportuese; nxit krijimin e mekanizmave shtrëngues që ligji të ketë efekte.

Shqipëria në vitin 2020 është përfshirë në listën e task forcës për veprimet financiare. Kjo quhet lista e vendeve nën monitorim të shtuar. Të gjithë e keni përmendur si lista gri. Po cilat janë arsyet që ne jemi futur në listën gri? A i kanë të qarta shqiptarët këto arsye? Shqipëria u vlerësua për nivelin e ulët të eficiencës në lidhje me numrin e ulët të dënimeve penale për veprat penale të pastrimit të parave, si dhe për numrin e ulët të sekuestimeve dhe konfiskimeve në lidhje me këto vepra penale.

Këtu u theksua, nga ata që na monitorojnë, përfshirë këtu MONEYVAL-in dhe FATF-në, që theks të veçantë në këtë aspekt duhet të ketë vazhdimi i zbatimit dhe i jetësimit të reformës në drejtësi. Në vijim, po këta ekspertë, vlerësuan se na mungonte një regjistër për deklarimin e pronarëve përfitues, mungonte ngritja e një regjistri të centralizuar të llogarive bankare.

Gjithashtu, profesionet e lira, si: noter, avokat, agjent të pasurive të paluajtshme, auditues apo kontabilist, duhet të kishin një proces të mirëfilltë shqyrtimi vetingu, me qëllim parandalimin e çdo të licencuari me histori

kriminale të ushtrisë një nga këto profesione të lira.

Duhet të theksohet se përfshirja në këtë listë është një proces, që e kalojnë shumë vende, e tha ministrja e Financave, unë nuk do ta përsëris, jo vetëm të rajonit, por edhe në nivel ndërkombëtar. Vendet hyjnë dhe dalin në këtë listë për efekt të vigjilencës së shtuar të monitorimit ndërkombëtar dhe të bashkëveprimit të shteteve, që janë pjesë e këtyre mekanizmave, për të shtuar përpjekjet e tyre për ta luftuar këtë fenomen negativ në shoqëri. Futja në një listë apo dalja nga lista nuk mund të quhet as një ditë e zezë, por as një arritje, sepse kjo është një përpjekje e konstitueshme, e vazhdueshme, siç zhvillohet shoqëria.

Ata që janë ekspertë të ligjit penal e dinë shumë mirë që edhe krimi merr forma të tjera dhe sofistikohet, ndaj duhet që organet ligjzbatuese, pra ata që luftojnë krimin dhe fenomenet kriminale në shoqëri, të rrisin metodat e veta të luftës kundër këtyre fenomeneve. Prandaj është sfidë më vete, është sfidë për të gjithë, është sfidë për vendin tonë, për vendet e rajonit dhe të botës. Por ne duhet të jemi me këmbë në tokë dhe t'i kuptojmë ashtu siç janë të vërtetat, jo ashtu siç i perceptojmë apo siç duam t'i themi, ndoshta edhe për qëllime politike apo për rolet që kemi opozitë – maxhorancë. Jo, e vërteta është e vërtetë dhe ne nuk mund ta zbehim atë.

Është e vërtetë që në Shqipëri kemi një planveprimi për të gjitha masat që duhet të marrim kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ne kemi miratuar një kuadër të plotë ligjor, që nga ligji “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, ligji “Për regjistrimin e organizatave jofitimpruese”, kemi bërë 7 analiza risku sot, mbas të cilave kemi çështje penale që ndiqen nga organet tona të prokurorisë.

Po ashtu, është rritur ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese. Sot bankat, noterët, institucionet e tjera apo të pavarurit në shërbime ose profesione të lira, kanë rritur nivelin e tyre të raportimit. Sot është rritur niveli i bashkëpunimit të Drejtërisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave me institucionet e tjera të drejtësisë apo me institucionet e tjera raportuese.

Nga ana tjetër, edhe sistemi i ndërlidhjes me letër-porosi midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka progres.

Kemi një numër të shtuar të çështjeve penale për hetimin e këtyre veprave.

Më 1 shtator 2020 ka filluar funksionimi i plotë i projektit të fiskalizimit, i cili synon reduktimin sa më shumë të përdorimit të parasë kesh dhe uljen e ekonomisë informale. Numri i sekuestrimeve dhe konfiskimeve për veprat penale në fushën e krimit të organizuar nga ato të raportuara në vitin 2020, raportohet në rritje në 6-mujorin e parë të vitit 2021. Këta tregues vlerësojnë nëse një vend ka bërë regres apo progres në këtë sektor.

Mendoj se ne kemi bërë progres, siç kemi ende punë për të bërë dhe është një përpjekje e vazhdueshme e të gjithëve ne, si deputetë të Kuvendit, që pas miratimit të këtij ligji, të jemi bashkë për të monitoruar zbatimin e tij, sikundër edhe për miratimin sa më parë të jetë e mundur të ndryshimeve të ligjit “Për noterinë” dhe ligjit “Për ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme”. Këto hapa duhen ndërmarrë për të përmbyllur pjesën e parë të rekomandimeve për Shqipërinë dhe për të forcuar mekanizmat e kontrollit, të cilat i hapin rrugë një vigjilence më të shtuar në parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

Ky akt përbën një mjet që do të mundësojë nxjerrjen e Shqipërisë nga lista e vendeve nën monitorim të shtuar, por nuk është fokusi dhe qëllimi kryesor. Qëllimi kryesor duhet të jetë plotësimi i standardeve më të mira të vendit tonë, për të qenë pararojë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo është e vetmja rrugë për siguri kombëtare, për ekonomi të pastër dhe më shumë mirëqenie për shqiptarët.

Ju falënderoj të gjithëve ju që kenë votuar, dhe me sa di, kanë votuar të gjithë pro këtij projektligji!

Uroj të jeni po kaq konstruktiv dhe të vërtetë edhe në vijim, duke mos e ndryshuar realitetin!

Besoj se me fjalimin tim mbyllet i gjithë debati parlamentar.

Uroj që ligji “Për noterinë” dhe ligji “Për ndërmjetësimin” të votohen njëzëri nga të gjithë deputetët e Kuvendit, duke përmbyllur një nga pjesët më të rëndësishme të planveprimimit, që i takon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Vijojmë me projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit””.

Nuk ka diskutantë të regjistruar.

Të nderuar kolegë,

Më lejoni t’ju njoftoj me rezultatet e votimit.

Për aktin normativ nr. 32, datë 05.11.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga/dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave” rezultatet e votimit janë: 112 deputetë kanë votuar pro, nuk ka asnjë kundër, 2 deputetë kanë abstenuar.

Miratohet.

Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar” rezultatet e votimit në parim janë: 106 deputetë kanë votuar pro, 6 deputetë kanë votuar kundër, 1 deputet ka abstenuar.

Miratohet në parim.

Rezultatet e votimit në tërësi janë: 106 deputetë kanë votuar pro, 6 deputetë kanë votuar kundër, 1 deputet ka abstenuar.

Miratohet në tërësi.

Për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit”” rezultatet e votimit në parim janë: 111 deputetë kanë votuar pro, 3 deputetë kanë votuar kundër, nuk ka asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Rezultatet e votimit në tërësi janë: 111 deputetë kanë votuar pro, 3 deputetë kanë votuar kundër, nuk ka asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi.

Vijojmë me diskutimet jashtë rendit të ditës.

Janë regjistruar deputetët Arbi Agalliu, Greta Bardeli, Kastriot Piroli dhe Isuf Çelaj.

Koha në dispozicion 5 minuta. Fjala për zotin Arbi Agalliu.

**Arbi Agalliu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Unë sot dua të shpreh shqetësimet për problemin e pronave në Jug të Shqipërisë, konkretisht në Radhimë dhe në Jalë.

Bajpasi i Radhimës, që do të bëhet me një investim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ka muaj që diskutohet, por për të nuk janë pyetur banorët e zonës. Po bëhen shpronësime qesharake me vlerë 1 mijë e 800 lekë deri në 2 mijë lekë të vjetër. Sot që flasim banorët i kanë dërguar kërkesa për ta anuluar këtë projekt Kryeministrit të vendit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë së Vlorës, këshillit bashkiak, Avokatit të Popullit, njësisë administrative të Orikumit dhe kanë marrë premtimin zyrtar se nuk do të zhvillohet ky investim nga ish-drejtuari politik i PS-së i qarkut Vlorë, zoti Damian Gjijnuri, por sot ata gjenden përpara faktit që prona e tyre, bizneset e tyre, jeta e tyre cenohen nga një investim që nuk bën sens. Ata kërkojnë që investimi të zhvillohet në rrugën ekzistuese dhe rruga nuk ka pse të devijojë, duke rritur koston në një terren të rrëshqitshëm, çka bën prishjen e bizneseve të tyre, marrjen e tokës dhe shpronësimin jashtë çdo limitit. Banorët kanë bërë peticione me firmat përkatëse. Janë mbi 46 familje të djathta dhe të majta në atë zonë, të cilat një javë më parë ishin prezent në protestën që filloi dhe do të vijojë.

I bëj thirrje zotit Gjijnuri, si deputet i qarkut të Vlorës, të mbajë premtimin që u ka dhënë atyre banorëve!

Kalojmë te çështja e dytë, që ka të bëjë me problemin në Jalë. Para disa kohësh media ka denoncuar një pronë, e cila, me dokumentacione të gjetura në shtetin grek, ka qenë trashëgimi e shtetit shqiptar para viteve ’90. Ajo që vihet re është se kjo pronë është tjetërsuar, është legalizuar, hipotekuar në kohë rekord, dhe është marrë një leje ndërtimi po në kohë rekord. Kjo pronë ka një sipërfaqe prej rreth 7 mijë e 378 metrash katrorë. Leja është dhënë nga kryetari i Bashkisë së Himarës, zoti Jorgo Goro, i cili nuk gjen kohë të pastrojë, sikurse Kryeministri ia vuri në dukje, por gjen kohë të japë leje ndërtimi për objekte, të cilat kanë sipërfaqe jashtëzakonisht të madhe në bregdet. Problemi nuk ka të bëjë me pjesën e investimit, pasi çdokush është i lirë të investojë brenda rregullave, por me abuzimin apo dritëhijet e këtij investimi.

Si ka mundësi që legalizohet, hipotekohet dhe jepet leja e ndërtimit në një periudhë shumë të shkurtër? Brenda pak ditësh ka ndodhur ky proces dhe disa javë më vonë është mbyllur pjesa e lejes së ndërtimit. Marrëdhënien midis familjeve në atë zonë mund ta zgjidhë procesi gjyqësor, pasi është një marrëdhënie personale midis tyre. Por ajo që të bën të dyshosh është se, pasi ka ndodhur ky proces jashtëzakonisht i shpejtë dhe efektiv i administratës publike, një kompani ndërtimi, pronarët e së cilës janë familjarë të afërm të zotit Gjijnuri, ka marrë për zhvillim këtë pronë.

Unë kam disa pyetje, të cilat ia drejtoj drejtpërdrejt zotit Gjijnuri: cili është qëndrimi juaj në raport me këtë ngjarje? A ka presion nga ana juaj ndaj institucioneve, të cilat kanë legalizuar, hipotekuar dhe dhënë lejen e ndërtimit për këtë firmë ndërtimi, e cila drejtohet dhe është në pronësi të të afërmeve tuaj? Unë mendoj se duhet dhënë një shpjegim nga ana juaj për këtë gjë. Unë nuk besoj se kjo do të ndodhë, sikurse nuk ka ndodhur në të gjithë Shqipërinë nga përfaqësuesit e kësaj maxhorancës, por e inkurajoj fort SPAK-un të hetojë këtë ngjarje. Janë pyetje që unë i ngre mbi fakte, të cilat nuk është se shqiptarëve mund t'u ndodhin në përditshmërinë e tyre që t'u legalizohet objekti për 24 orë, të marrin hipotekë për 24 orë dhe t'u dalë leja e ndërtimit në mënyrë të tillë. Banorët e zonës së Himarës, të cilët janë shekullorë, ende sot e kësaj dite, edhe pas 30 vjetësh, nuk kanë një leje ndërtimi apo certifikata të pronave të tyre që janë shekullore.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Greta Bardeli.

*(Zonja Bardeli nuk ndodhet në sallë.)*

Fjalën e ka zoti Kastriot Piroli.

**Kastriot Piroli** – Zonja Kryetare,

Zotërinj deputetë,

Të nderuara qytetare dhe qytetarë të Republikës së Shqipërisë, uroj të gëzoni shëndet!

Pas disa takimeve në zonën e Mirditës, pjesë e qarkut Lezhë, do të doja të sillja në këtë foltore realitetin që pashë atje, duke ju cituar vetëm një nga vargjet e Migjenit, një rresht që tregon realitetin e mirditorëve më mirë sesa 1 mijë fjalime: në Mirditën e vitit 2021 “kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi.”

Mirdita i ka dhënë shumë Shqipërisë dhe nuk ka marrë asgjë në këmbim, përkundrazi ka 8 vjet që kjo qeveri ka qenë kontributori kryesor në largimin masiv të të rinjve dhe në thellimin e varfërisë me mungesën totale të investimeve, që mund të sillte përmirësimin e jetës së banorëve të zonës. Gjithçka që i keni ofruar Mirditës është një shesh guri dhe një fasadë betoni. Po kujt i shërben ky shesh dhe ai mur?

Paratë e shpërdoruara për ndërtimin e asaj fasade mund t'i kishit kthyer në rrugë për fshatrat e Mirditës në mënyrë që fermerët e zonës të kishin më shumë mundësi për t'i lëvizur prodhimet e tyre drejt tregjeve urbane. Në vendlindjen e dom Nikollë Kaçorrit, Krejllurë, firmëtarit të dytë në Deklaratën e Pavarësisë dhe zëvendëskryeministrit të dalë nga qeveria e parë e shpalljes së pavarësisë, nuk ka ende rrugë për të shkuar. Zero investime në infrastrukturën rrugore, zero politika për të ndihmuar bizneset, fermerët e deri te qytetari më i thjeshtë që ndodhet në fshatin më të largët. Kjo ka sjellë goditjen më të madhe të banorëve atje, humbjen totale të shpresës dhe se në Mirditë nuk mund të jetohej.

Që prej braktisjes suaj fenomeni që e goditi më shumë zonën e Mirditës është migrimi i brendshëm, ku banorët përipiqen të ndërtojnë një jetë të re në Lezhë apo në Tiranë, ndërkohë që të moshuarit, të cilët në këtë stad të jetesës së tyre problem kanë dimrin, kanë mbetur të vetmuar në kullat apo në banesat e tyre në zonat rurale. Me të drejtën e tyre të plotë mirditorët kanë zgjedhur këtë rrugë, pasi fshatrat nuk kanë infrastrukturë rrugore, nuk kanë ujë të pijshëm, edhe pse Mirdita ka burime ujore të pafundme, nuk kanë qendra shëndetësore funksionale, shkollat janë të amortizuara dhe pa sistem ngrohjeje dhe ku banorët ende flenë nëpër çadra, sepse nuk janë akomoduar ende në shtëpitë e tyre, për të cilat shteti shqiptar mori 1,1 miliardë euro borxh për t'i ndërtuar.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, sepse njerëzit punësohen në këmbim të votës, punësohen kushërinjtë, miqtë dhe shokët dhe jo ata që kanë nevojë dhe e meritojnë me të vërtetë. Mirdita ka të rinj të shumtë që janë diplomuar në universitetet më të mira europiane, duke banuar ende në vendlindjen e tyre dhe në vend që të japin kontributin e tyre për zhvillimin e zonës, janë të detyruar të bëjnë rolin e bujkut. Kjo është

groteske, se kush është fermeri dhe kë kemi vendosur në drejtim për atë zonë.

Nuk kam ardhur këtu për të hedhur dhë mbi mosveprimet tuaja ndaj Mirditës, por të bëj publike kërkesat e banorëve. Zhvillimi i infrastrukturës jep shanse për zhvillimin e destinacioneve historike, duke rritur mundësitë për rivitalizimin e tyre, ku një ndër më të rëndësishmit destinacion është burgu i Spaçit, një ndër memoriet më mizore të historisë së diktaturës, sepse në këtë mënyrë do t'u përcjellim brezave të ardhshëm idenë që histori të tilla nuk duhet dhe nuk do të përsëriten më në Shqipëri.

Zhvillimi i infrastrukturës do të sjellë shanse për zhvillimin e sipërmarrjeve që nderojnë vendin tonë edhe përtej kufijve, siç janë kantinat e verës, ku shteti duhet të jetë krah aktiviteteve të tilla, pasi drejtuesit e këtyre kantinave janë punëdhënës të rëndësishëm në atë zonë dhe duhen stimuluar me nisma konkrete për shtimin e sipërfaqeve të vreshtave.

Po ashtu, zhvillimi i infrastrukturës sjell mundësi reale për shtimin e numrit të krerëve në blegtori, por edhe të produkteve bujqësore, si dhe shanse reale për ta kthyer në prioritet zhvillimin e turizmit malor. Përmirësimi i sistemi të vaditjes në zonat e Kthellës, Perlatit, Prosekut, Ndërfushasit, Ndërfanit, zona me një sipërfaqe prej rreth 350 hektarësh tokë, si dhe me një popullsi të konsiderueshme, duhet mbështetur me investime, ku maksimumi i tyre shkon në 3 milionë euro. Kjo është një kërkesë e vazhdueshme e banorëve të kësaj zone, prandaj investoni që të mbani larg grumbullimet masive dhe sillni shpresë për mirditorët.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Isuf Çelaj.

**Isuf Çelaj** – Të nderuar qytetarë të Tropojës,

Të nderuar kolegë,

Sot jam para jush për të ngritur disa probleme dhe shqetësime të banorëve të Tropojës, zonë që përfaqësoj. Hallet e tyre janë të shumta, por sot do të rendis disa më kryesoret, që kanë të bëjnë me kushtet ku ata rrisin fëmijët, pra brezin e ardhshëm.

Problematikë për banorët e qytetit të Bajram Currit është gjendja në të cilën ndodhet e vetmja çerdhe që ka qyteti, banorët e të cilit janë

të detyruar t'i dërgojnë fëmijët e tyre. Gjendja e saj është mjerane dhe lë shumë për të dëshiruar: ambientet i ka plot lagështi, nuk ka ventilim, nuk ka sistem ngrohjeje, krevatet dyshekët, çarçafët dhe batanijet i kanë të vjetruara, ndërsa muret dhe suvatë të dëmtuara. Kjo është e vetmja alternativë e këtyre prindërve për fëmijët e tyre.

Jam shumë i bindur se asnjë nga ministrat e kësaj qeverie, përfshirë edhe Kryeministrin, e asnjë nga ju, kolegë të maxhorancës, nuk do t'i dërgonit fëmijët tuaj në ambiente të tilla, me këto kushte.

Ndaj, thirrja ime shkon për Kryeministrin, për ju qeveritarë, për zonjën ministre të Arsimit, që ta financojnë me fonde ristrukturimin e kësaj godine, si dhe pajisjen e saj me orendi të reja, për t'u mundësuar këtyre fëmijëve një trajtim e qëndrim në një ambient me kushte dhe standarde bashkëkohore.

Jam i bindur, zonja Ministre, se vlera e këtij investimi është simbolike kur e krahason me shpenzimet e luksit për qeveritarët prej 52 milionë eurosh të kësaj qeverie, të planifikuar dhe miratuar nga ju, në buxhetin e vitit të ardhshëm, ose, e thënë në vlerë, ky financim nuk kalon as 0,4% të vlerës së mësipërme. Pra, bëhet fjalë për një investim rreth 200-220 mijë euro.

E njëjta situatë paraqitet edhe në ambientet e kopshtit nr. 2 të lagjes "Partizani", ku lagështia dhe pajisjet e vjetruara dhe të shkatërruara, niveli i ulët i higjienës sanitare në këto ambiente, me gjithë sakrificën e punonjësve që u shërbejnë fëmijëve të këtij kopshti, janë në gjendje mizerabël. Këto problematika janë të bëra publike në medie edhe para një viti e ca, por askush nga zotërinjtë qeveritarë nuk e ka vënë ujin në zjarr për zgjidhjen e këtyre problemeve, për të bërë të mundur financimin dhe ristrukturimin e këtyre ambienteve, që, edhe ata, si bashkëmoshatarët e tyre, të ndiejnë dorën e kujdesit nga shteti, për të cilin prindërit e tyre kontribuojnë me punë e taksa.

Po ashtu në gjendje të mjerueshme janë edhe ambientet e dy shkollave, asaj 9-vjeçare "Besëlidhja e Malësisë" në qytet, dhe të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Oso Dauti" në fshatin Llujaj, për të cilat projektet janë prej vitesh të depozituara pranë Ministrisë së Arsimit, por titullarëve të kësaj ministrie as që u shkon mendja për t'i financuar këto projekte.

Sikurse e theksova edhe më sipër, nëse ekziston dëshira e mirë, mundësia për financimin e këtyre 4 projekteve mund të bëhet realitet, pasi vlera totale për financim nuk kalon as 1,5% të vlerës së planifikuar për shpenzimet e luksit të qeveritarëve.

Fëmijët janë e ardhmja e këtij vendi, aq më tepër kur bëhet fjalë për një investim modest për banorët e një prej rretheve me nivelin më të lartë të varfërisë dhe emigracionit në vend. Jam i bindur se me pak predispozicion dhe dëshirë të mirë nga ana juaj, kjo gjë mund të zgjidhet shumë lehtë nëse nuk i qëndroni linjës suaj të qeverisjes së manifestuar në këta 9 vjet,

asaj të harresës dhe hakmarrjes politike për këta banorë, duke i trajtuar si qytetarë të dorës së tretë, edhe pse këta paguajnë taksat e shtetit dhe kontribuojnë në zhvillimin e vendit si të gjithë bashkëqytetarët e tyre.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu mbyllet seanca për ditën e sotme.

Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

Faleminderit!

*(Seanca u mbyll në orën 15:40)*

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtori i Shërbimit të Redaktorëve  
Krenar Hajdëri**